

JOHN BLANCHARD

AUTOR I A BESON PERËNDIA TE ATEISTËT



A e ka hequr qafe shkenca Perëndinë?

A e ka hequr qafe shkenca Perëndinë?

John Blanchard

Titulli i origjinalit: Has Science got rid of God?

Autori: John Blanchard

Botoi: Evangelical Press

Faverdale North Industrial Estate, Darlington, DL3 OPH, England, U.K

ISBN: 0 85234- 530-5

Titulli në Shqip: A ka hequr qafe shkenca Perëndinë?

Përktheu: Blerina Pano

Redaktoi: Valbona Luzi

E drejta e botuesit AEM-Misioni Ungjillor, Gjirokastër, Albania, 2009.

Boton: AEM-Misioni Ungjillor, në bashkëpunim me Illyrian Gospel Trust.

Të drejtat e rezervuara: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo formë apo mënyrë, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi, apo ndonjë mënyrë tjetër pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

Citimet Biblike janë marrë nga Bibla, “Diodati i Ri,” (1991-1994). E drejta e autorit © SHOQERIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S) TIRANË. E përdorur me leje.

Shtypur: Vernon Publishing,

Tirana, Albania, 2009

Tirazh: 1000 kopje

ISBN: 978-99943-55-65-5

Përmbajtja

	Faqja
Hyrje	7
1. Akordimi i pyetjes	9
2. Shkencizmi: perëndia i paperëndishëm	15
3. Kontroll realiteti: shkenca dhe caqet e saj	28
4. Evolucioni: provë apo paragjykim	48
5. Besim dhe fakte	73
6. Kokëkunguj përtacë?	89
7. Përtej shkencës	106
Shtojcë: Historia e çuditshme e Shkencës së Krishterë	123
Shënime	129
Tregues	147

Hyrje

Shkenca dhe feja janë dy nga ndikimet më të përhapura që bota ka njohur ndonjëherë, prandaj, me sa duket, ato ndikojnë te çdo person që jeton në planetin tonë. Nëse shkruaj fjalën “shkencë” në rrjetin tim të preferuar të internetit, ai më ofron 62,300,000 faqe për të kërkuar; kur provoj “fe”, më vihen në dispozicion 18,500,000 faqe të tjera. Nëse i kërkoj të dyja fjalët njëherësh, përballem përsëri me 3,270,000 faqe të dyndura me fakte dhe shifra, pohime dhe kundërpohime, ide dhe opinione.

Kombinimi i të dyja fjalëve sjell probleme për shumë njerëz, për arsye se ato shpesh janë menduar si diametrikisht të kundërta me njëra-tjetrën. Në vitin 1980, shkencëtari britanik Edgar Andrews, profesor Emeritus i Materies në Universitetin e Londrës, filloi një libër të shkëlqyer mbi këtë temë me fjalët: “Divorci ndërmjet shkencës dhe fesë është një nga aspektet më domethënëse të skenës sonë moderne filozofike”¹. Ka raste kur ky “divorc” e shpreh veten në një lloj “lufte të ftohtë”, ku të dyja palët e shpërfillin njëra-tjetrën. Në raste të tjera, “lufta e nxehtë” shpërthen përmes medias, që, ndonjëherë, e merr shkëndijën nga gjëra të tilla si: një zbulim i ri shkencor, një “gjetje” interesante arkeologjike, një hap përpara në mjekësi që ngre çështje morale dhe etike, apo mënyra e sistemit arsimor që mëson rreth origjinave të botës ose racës njerëzore.

Idėja se shkenca dhe feja janë në kundërshtim ka ekzistuar për një kohë të gjatë, e cila daton të paktën nga pjesa e tretë e shekullit XIX, por a ka ndonjë bazë të qëndrueshme? A jemi të detyruar të mbështesim

njërën apo tjetrën? A duhet të pranojmë që ato do të jenë gjithmonë kundër njëra-tjetrës? A nuk ka ndonjë rast për të thënë se secila ka një pjesë të vlefshme për të luajtur në mënyrën se si e kuptojmë në realitetin dhe në përvojën tonë të përditshme?

I jam mirënjohës profesor Edgar Andrews, Dr. Andrew Blanchard, Dr. Andy Christofides, Steve Layfield, të nderuarit Philip Miller dhe profesorit Colin Runciman për ndihmën e tyre në rishikimin e dorëshkrimit dhe sugjerimet që dhanë për korrigjimin dhe përmirësimin e tij; ata nuk janë aspak përgjegjës për ndonjë dobësi që mbetet. Sekretarja ime, Joy Harling, për një periudhë të gjatë, bëri si zakonisht punën e saj të shkëlqyer në përgatitjen e materialit për botim.

Nëse po kërkonit të bëni një shqyrtim të plotë të këtyre pyetjeve që heton çdo detaj të zbulimit shkencor dhe zgjeron thellësitë e mendimit fetar në shekuj, pa dyshim që do t'ju duhet të kërkonit diku tjetër, duke përfshirë edhe ato miliona faqe të internetit! Libri që keni në dorë nuk është më shumë se një ravijëzim bazë i çështjeve themelore që përfshihen këtu, e megjithatë unë besoj se të çon në një përgjigje të qartë dhe bindëse ndaj pyetjes së dhënë në titull.

John Blanchard
Banstead
Surrey
Prill 2004

I.

Akordimi i pyetjes

Më lejoni të jem i singërtë. Unë nuk jam as shkencëtar dhe as bir shkencëtari. Kam një djalë me dy grada shkencore, një në gjenetikë dhe një në biologjinë molekulare, por, përveç faktit që kam dhënë kontributin tim gjenetik në krijimin e tij rreth njëzet vjet para se ai të arrinte të parin nga këta tituj, nuk kam asnjë meritë për asnjërin prej tyre. Pasi kisha folur në Universitetin e Kembrixhit këto kohët e fundit, një student më pyeti: “Çfarë njohurish ke në shkencë?” Në përgjigje të kësaj unë i thashë se formalisht nuk kisha asnjë dhe se mund të bashkohesha me rrëfimin e kryepeshkopit William Temple: “Paditura ime në shkencë është aq e thellë, sa të dallohet!”¹. Ky mund të duket një fillim i pashpresë, por gjysmë shekulli i tërhequr nga kjo temë, i nxitur nga orë të panumërta leximi, diskutimi dhe mbajtje shënimesh, për të mos folur për hyrje në një kaskadë informacioni në internet, siguron më shumë se informacion dhe analiza të mjaftueshme eksperti për të ofruar një përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj pyetjes së paraqitur në titullin e librit. Unë do të mbështetësja gjithashtu qetësisht në pohimin e lashtë se teologjia është “Mbretëresha e shkencave”!

Së pari, gjërat kryesore: çfarë do të thotë “shkencë”? Rrënja e fjalës vjen nga anglishtja e mesjetës, frëngjishtja e lashtë dhe latinishtja, në të cilat “*scientia*” mbështetet në një folje që do të thotë “të dish”. Deri këtu shumë mirë, por, ashtu siç e vë në dukje edhe shkollari amerikan J. P. Moreland, “pjesa më e madhe e filozofëve të shkencës

nuk bien dakort me asnjë përkufizim të pranuar zakonisht të asaj se çfarë është shkenca... Ka disa raste kur pjesa më e madhe e njerëzve do ta konsideronin si të ishte shkencë, por nuk duket se është një përkufizim i mjaftueshëm që mbulon të gjitha rastet”². “Shkencë” më parë nuk nënkuptonte asgjë më tepër se “njohuri”, por pjesa më e madhe e librave të referimit tani e quajnë këtë përkufizim “arkaik”. *Fjalori i Anglishtes i Oksfordit* e përmirëson kuptimin duke e quajtur atë “aktiviteti intelektual dhe praktik që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike e natyrore përmes vëzhgimit dhe eksperimentit”³.

Kjo na afron pak më shumë në vendin ku duhet të jemi për qëllimet e këtij libri. Shkenca kërkon të zbulojë, të vëzhgojë dhe të kuptojë parimet e ligjet që sundojnë botën natyrore. Nuk është statike, por dinamike; jo një prodhim, por proces; jo një qenie, por një sipërmarrje. Është “punë që ecën përpara”, një kërkim i ndershëm, pa fund, i vazhdueshëm, objektiv dhe i zellshëm njohurie të besueshme rreth botës sonë dhe gjithçkaje në të. I drejtohet një burimi të pafund pyetjesh, duke përdorur atë që ne sot e quajmë “metoda shkencore” — vëzhgimi, formulimi i hipotezave që i përshtaten të dhënave, shqyrtimi i mundësive të tjera dhe eksperimenteve të përsëritura (që mund të kenë sukses ose jo). Pasi t’i kenë kaluar të gjitha ato hallka, shkencëtarët, me të drejtë, mund të pohojnë se kanë ngritur një teori shkencore. Duke folur në televizionin BBC, filozofi Danah Zohar tha: “Shkenca e madhe ka të bëjë me pyetje të mëdha... Shkenca na fton të hetojmë, të shohim më tej, përtej asaj që duket, për të parë atë që gjendet mbrapa”⁴. Richard Bube, profesor Emeritus i Shkencës Ekzakte dhe Inxhinierisë Elektrike në Universitetin Stanford të Amerikës, shton një tjetër të dhënë të rëndësishme: “Shkenca është një mënyrë të dituri e mbështetur në shpjegimin njerëzor të të dhënave të fituara publikisht përmes ndërveprimit me botën fizike”⁵. Për ta shprehur më thjesht, shkenca është procesi i vazhdueshëm i të mësuarit të gjërave për botën natyrore. Që këtë e tutje do ta përdorim këtë si përkufizim funksionues.

Për sa i përket fjalës së dytë kyçe në titullin tonë, qëllimisht nuk kam bërë pyetjen “A e ka hequr qafe shkenca fenë”. Fjalori i Anglishtes i Oksfordit e përkufizon fenë si “besimi dhe adhurimi i një fuqie

kontrolluese mbinjerëzore, veçanërisht një Perëndi ose disa perëndi personale”⁶, dhe shkencëtari i njohur britanik Sër John Houghton vëren se feja ka qenë gjithmonë një fenomen universal: “Ka dëshmi të përgjithshme se pjesa më e madhe e qenieve njerëzore, nga çfarëdo pjese të botës dhe nga kohët më të hershme, kanë shfaqur besim të thellë në një qenie ose qenie hyjnore dhe në ndonjë lloj bote shpirtërore”⁷. Feja sillet në të gjitha format e masat dhe pohimet e saj variojnë nga qesharaket deri te të mahnitshmet. Animizmi nxit adhurimin e shpirtave që thuhet se jetojnë në të gjitha fenomenet natyrore, nga shkëmbinjtë deri te lumenjtë dhe që nga pemët deri te lulet. Panteizmi anon në të njëjtin drejtim duke thënë se Perëndi është çdo gjë dhe çdo gjë është Perëndi. Politeizmi çon në një numër të pakufizuar perëndish. Lëvizja e Epokës së Re pohon se të gjithë anëtarët e saj janë hyjnorë (që, me sa duket, do të thotë se një hyjni më shumë shtohet sa herë që një person bëhet anëtar i saj). Të zellshmit fetarë janë zhytur në të gjitha llojet e ritualeve të çuditshme për t’u kapur pas besimeve të tyre; duke pikturuar ose dëmtuar trupat e tyre, duke sakrifikuar fëmijët e tyre, madje edhe duke u djegur për vdekje. Vetëm në Shtetet e Bashkuara ka mbi 2,600 grupe besimi, 250 prej të cilave janë radhitur së fundmi në *Enciklopedinë e Fesë Amerikane* që nga 1999-a. Adhuresit e Kenedit e kanë deklaruar hyjni ish-presidentin amerikan; “Besimi në një Perëndi” është një kompani sapunësh; dhe Ambasada e Qiellit lëshon numrin e vet të targave për makina, sepse ajo i konsideron të jashtëligjshme të gjitha qeveritë tokësore.

Pjesa e madhe

Në ditët e sotme është e modës t’i bashkosh të gjitha fetë së bashku dhe të thuash se arrijnë tek e njëjta gjë. Duke folur në një takim publik, i mbajtur në Stadiumin Yankee në Nju Jork pak ditë pas sulmeve të tmerrshme terroriste në Shtetet e Bashkuara më 11 shtator 2001, personaliteti televiziv Oprah Winfrey i tha botës se të gjithë njerëzit i luten të njëjtit Perëndi. Pohimi ishte punuar me kujdes për të shmangur përplasjet politike, por ishte marrëzi e plotë. Ashtu siç mund ta tregojmë fare lehtë, ideja se të gjitha fetë janë shtigje njësoj të vlefshme për në një realitet të vetëm shpirtëror nuk qëndron sapo përpiqemi

ta bëjmë tonën. Edhe pse bota jonë moderne është e ngopur me fe dhe kulte të strukturuar, bahaizmi, konfucianizmi, shinto, sikizmi, zoroastrianizmi Hare Krishna, mormonizmi, Dëshmitarët e Jehovahit, Kisha e shkencologjisë, Meditimi transhendental, duke përmendur vetëm pak prej tyre, “fe” për shumë njerëz zakonisht do të thotë hinduizmi, budizmi, islamizmi, judaizmi ose krishterimi. Ne mund të shprehim atë që duam, duke u kufizuar te këto.

Hinduizmi, që daton të paktën 3,000 vjet para Krishtit, është quajtur “familje e feve... e paqëndrueshme dhe e ndryshueshme”⁸. Koleksioni i tij çoroditës i ideve fetare dhe filozofike thuhet se përmban jo më pak se tridhjetë e tre milionë perëndi⁹ dhe një autoritet shkon deri atje sa të thotë se hinduistët mund të jenë panteistë, politeistë, monoteistë, agnostikë, madje edhe ateistë”¹⁰.

Budizmi mbështetet në mësimet e Siddhartha Gautama-s, që ka lindur rreth vitit 563 para Krishtit (edhe pse thuhet se mbërritja e tij të ketë qenë e fundit e të paktën 550 rimishërimeve). Disa budistë modernë Mahayana e adhurojnë atë bashkë me shumë perëndi të tjera të huazuara nga hinduizmi, por budizmi tradicional nuk ka një perëndi personal.

Islamizmi është feja më e re dhe e dyta për nga përhapja në botë. Mësimet e tij ruhen në Kuran, i përbërë nga vizione që thuhet se i janë dhënë Muhametit, i cili lindi në qytetin arab të Mekës, diku mes viteve 570 – 580 pas Krishtit, dhe ligjërimi mbështetur mbi ato që ai tha. Ashtu si Buda, Muhameti nuk pretendonte të ishte hyjnor. Hyji i islamizmit është Allahu, një figurë e ashpër dhe e largët që nuk ndikohet nga veprimet dhe qëndrimet e njerëzve dhe “që nuk mund ta njohësh personalisht”¹¹.

Judaizmi është një fenomen i përhapur në gjithë botën që ka treguar një aftësi të mahnitshme për t’iu përshtatur presionit dhe përndjekjes nga burime fetare dhe jofetare. Mësimi i tij rrjedh nga Dhiata e Vjetër e Biblës, por përqendrohet te Torah. Ky përbëhet nga Mishnah dhe Gemara, shkrime të mbështetura në pesë librat e parë të Biblës dhe që paraqet 613 udhëzime për të jetuar, edhe pse nuk ka nevojë të zbatohen të gjitha në rrethana përjashtuese. Judaizmi thekson vetëqenësinë dhe transhendencën e Perëndisë, por jo ndërveprimin e tij të ngushtë me njerëzimin.

Krishtërimi e konsideron të gjithë Biblën si “fjalën e gjallë dhe të përjetshme të Perëndisë”¹². Kjo e shfaq Perëndinë si krijuesin sovran të të gjithë realitetit jashtë tij, duke përfshirë kohën dhe hapësirën: “bota është krijuar me anë të fjalës së Perëndisë”¹³. Perëndia nuk krijoi sepse duhej ta bënte, por sepse ashtu zgjodhi. Asgjë në krijim nuk ka nevojë për një justifikim përtej faktit se në diturinë e tij të pafund Perëndia e deshi të ishte dhe në fuqinë e tij të pafund bëri që të ishte. Perëndia nuk është thjesht një forcë kozmike apo “fuqi më e lartë”, por është si person, ashtu edhe përjetësisht vetekzistues, “nga përjetësia në përjetësi”¹⁴. Ai ekziston si një trinitet i personave të dallueshëm, të identifikuar në Bibël si Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë¹⁵. Ai është i përsosur në të gjitha rrugët e tij¹⁶, i pandryshueshëm¹⁷ dhe “i madh në mirësi”¹⁸.

Ai është sunduesi i vetëm dhe sovran mbi gjithçka që ai ka bërë: “Mbretërimi i tij sundon mbi gjithçka”¹⁹. Ai mban të gjithë rendin e krijuar dhe sundon botën natyrore, botën shpirtërore, çështjet ndërkombëtare, autoritetet tokësore dhe jetët e qenieve njerëzore: ai “vepron të gjitha sipas këshillës së vullnetit të tij”²⁰. Përfundimisht, fati përfundimtar i çdo qenieje njerëzore është në duart e tij dhe ai do të “gjykojë botën me drejtësi”²¹.

Marrëdhënia e Perëndisë me njerëzimin përqendrohet në faktin që rreth 2,000 vjet më parë ai hyri në histori me personin e Jezu Krishtit, i cili u bë njeri ndërsa ruante akoma hyjninë e tij. Lindja prej një virgjëreshe, jeta e përsosur dhe vdekja në mënyrë vullnetare në vend të të tjerëve, ishin të gjitha shenja të hyjnisë së tij, të vërtetuara nga ringjallja e tij prej së vdekurish²², që tregoi se ai ishte “Perëndia i vërtetë”²³, i cili premton faljen e mëkateve dhe jetë të përjetshme gjithë atyre që i besojnë atij²⁴.

Edhe në bazë të këtij vështrimi në vija të trasha, është plotësisht e dukshme se të gjitha *fetë* nuk janë të njëjta. Madje edhe një ateist i vendosur si filozofi britanik Bertrand Russell vëreu: “Është e dukshme logjikisht se, përderisa ata nuk bien dakord, jo më shumë se një prej tyre mund të jetë i vërtetë”²⁵, ndërsa Janet Daley e “*Daily Telegraph*” e bëri të qartë çështjen: “Nuk mund t’i mbrosh të gjitha besimet, të paktën jo në të njëjtën kohë, sepse secili ka besime që i bëjnë të rreme ato të të tjerëve”²⁶. Kjo është aq e qartë, sa dhe drita e diellit. Shumë

fe të mëdha botërore, duke mos folur për qindra më të vogla, bëjnë pohime që janë diametrikisht kundër njëra-tjetres kur merren me ekzistencën dhe natyrën e Perëndisë dhe mundësinë që ne të kemi një marrëdhënie të gjallë me të. Kur kjo gjë ndodh, thjesht është e pamundur që të gjithë ata të kenë të drejtë. Dhe nuk mund të qëndrojnë ideja e re se një fe e caktuar mund të jetë “e vërtetë për një person, por jo për një tjetër”. Një besim ose është i vërtetë për të gjithë, ose për asnjë, prandaj nuk ka vend për kompromis. Ashtu si ka thënë një shkrimtar modern: “Të thuash se të gjitha rrugët të çojnë te Perëndia është po aq jo e logjikshme, sa të thuash se të shkosh me autobus në dyqane është njësoj si të bësh një udhëtim për në hënë me anije kozmike. Rruga, mënyra e transportit dhe mbërritja janë të gjitha tërësisht të ndryshme!”²⁷.

Është thënë se gjithë studimi që bën feja krahasuese është t'i bëjë njerëzit fetarë! Ashtu si mund të jetë, ideja se të gjitha fetë të çojnë në të njëjtin drejtim ose të drejtojnë në të njëjtën pikëmbërritje, është qartësisht qesharake. Krishterimi mbështetet në një seri të zgjeruar ngjarjesh historike të regjistruara në Bibël, ndërsa të gjitha besimet e tjera, të lashta apo moderne, ndërtohen në moralin subjektiv dhe mësimin etik të themeluesve ose udhëheqësve të tyre. Apologjisti bashkëkohor Joe Boot shpreh këtë dallim kritik: “Bibla nuk është një libër filozofie morali të lartë apo prozë e rrjedhshme, por mbështetet në fakte objektive dhe historike të hapura për verifikim. Bibla nuk na kërkon të pranojmë një mësim etik thjesht sepse thotë kështu. Përkundrazi, na bën thirrje të vëmë në provë përputhshmërinë dhe vlefshmërinë e saj. Bibla tregon atë që Perëndia ka bërë për ne në historinë njerëzore dhe se si ka folur e vepruar në botën tonë, prandaj kjo është arsyeja që ne mund ta vëmë në provë Biblën për të kuptuar nëse është e vërtetë. Të gjitha fetë e tjera nuk i kalojnë të njëjtat prova”²⁸.

Edhe pse një pjesë e asaj që do të pasojë është e vërtetë për marrëdhënien ndërmjet shkencës dhe gjithë besimeve fetare, po shkruaj si një i krishterë i përkushtuar, i bindur intelektualisht, emocionalisht dhe eksperimentalisht se e gjithë Bibla është “e frymëzuar nga Perëndia”²⁹, një zbulim i pastër i natyrës dhe vullnetit të Perëndisë.

2.

Shkencizmi: perëndia i paperëndishëm

Tani që kemi vendosur përkufizimet, mund të merremi drejtpërdrejt me pyetjen. “A e ka hequr qafe shkenca”, kërkimi i vazhdueshëm e i pafund për të vërtetën në botën natyrore, Perëndinë e zbuluar në Bibël si krijuesin transhendent të gjithë realitetit jashtë vetes së tij, i cili kontrollon çdo atom në univers, që ndërhyri në kohë dhe hapësirë në personin e Jezu Krishtit dhe të cilit secili prej nesh do t’i japë llogari moralisht dhe përjetësisht? Shkencëtarët, teologët dhe filozofët janë munduar shumë me pyetjen *ad infinitum*, të cilëve u janë bashkuar me miliona njerëz “të zakonshëm” që i tërheq kjo çështje. Në fillim të librit të tij *“The Search for God: Can Science help?”* (“Kërkimi për Perëndinë: A mund të ndihmojë shkenca?”), sër John Houghton identifikon katër qëndrime të ndryshme që adoptohen kur diskutohet çështja e njeriut për të vërtetën. E para thotë se metoda shkencore është e vetmja mënyrë e vlefshme, e dyta thotë se besimi është e vetmja mënyrë, e treta se shkenca dhe besimi ndërthuren dhe e katërta se ato reciprokisht përjashtojnë njëra-tjetrën¹.

Ne do të prekim tre të fundit ndërsa vazhdojmë, por këtu do të përqendrohemi në të parën, një pikëpamje për të cilën nuk është e vështirë të gjesh një folës të rrjedhshëm. Tani që po shkruaj, Peter

Atkins është Anëtar SmithKline Beecham dhe Tutor në Kiminë Fizike në Kolegjin Lincoln në Oxford. Ai ka shkruar tekste shkollore për kolegje si: *Kimia e përgjithshme*; *Kimia fizike* (libri më i shitur në botë mbi këtë lëndë); *Kimia inorganike*; *Mekanika e Kuantit Molekular*; *Kuantet dhe Konceptet e Kimisë Fizike*, po ashtu edhe vëllime me synim më të gjerë si: *Molekulat*; *Ligji i dytë*; *Atomet, elektronet dhe ndryshimi dhe Mbretëria periodike*. Prandaj mund të mendojmë se Atkins është në gjendje të flasë seriozisht rreth shkencës në përgjithësi dhe me autoritet të konsiderueshëm në disiplinën e tij të veçantë. E megjithatë, ai zë vend në këto faqe jo për shkak të gjurmës që ka lënë në botën e shkencës, por sepse ai është një ateist i apasionuar dhe i rrjedhshëm, i cili pohon me vetëbesim dogmatik se shkenca e ka eliminuar Perëndinë, pikëpamje kjo që përshtatet përsosmërisht me pozitën e tij si Anëtar Nderi i Shoqatës Kombëtare Jofetare. Gjatë një debati në Universitetin e Oksfordit, më 1998-n, ai tha: “Jam në prag të të kuptuarit të gjithçkaje dhe ju rekomandoj të përdorni trurin, sepse truri është instrumenti më i mrekullueshëm në univers, prandaj, përmes trurit tuaj, mund të shihni se mund të bëni pa Perëndinë. Nuk ka nevojë për Perëndinë, sepse *shkenca mund të shpjegojë çdo gjë*”. Në një artikull të botuar në “*Independent*”, katër vite më vonë, ai i përshkruante fetë si “mënyra të çuditshme për të maskuar paditurinë, për të propaganduar ëndrra me sy hapur dhe për të ushtruar pushtet mbi të paditurin dhe të dobëtin”, që, në veçanti, kishte në shënjestër krishterimin, duke e akuzuar atë për përhapje të një “marrëzie të dukshme e cila nuk përputhet aspak me të kuptuarit tonë shkencor për botën”².

Kjo gjuhë të prek, por nuk është shkencë! Përkundrazi, është *shkencizëm*, i cili përdor shumë nga terminologjia e shkencës, por ka pak nga virtytet e saj. Shkencizmi shpesh vepron nën emrat e materializmit, natyralizmit ose reduktizmit, tituj që japin të dhëna të qarta se prej nga vijnë. Materializmi mund të jetë aq i vjetër sa edhe filozofët grekë si Tales (i cili jetoi rreth vitit 585 para Krishtit) dhe Demokriti (c. 460 – 370 para Krishtit). I dyti ndonjëherë quhet “ati i materializmit” dhe mësonte se i gjithë realiteti nuk përbëhet nga asgjë tjetër veç një numri të madh atomesh vetështytës që vijnë vërdallë në hapësirë. Në shek. XIX filozofi gjerman Ludwig Feuerbach bëri të vetën të njëjtën

linjë: “Nuk ka asgjë përtej natyrës dhe njeriut... çdo zgjidhje që kërkon të shkojë përtej cageve të natyrës dhe njeriut është pa vlerë”.³ Një prej bashkëkohësve të tij që u ndikua fuqishëm nga Feuerbach ishte Karl Marks, doktrina e të cilit në Universitetin e Jenas ishte mbi materializmin (dhe ateizmin) e Demokritit dhe mendimtarëve të tjerë grekë që kishin të njëjtin mendim. Megjithatë, larg prej të qenit pjesë e shkencës, materializmi është filozofi rreth shkencës. Ajo thotë se i gjithë realiteti mund të shpjegohet pa patur nevojë të shkosh përtej materies ose natyrës dhe se vetëm ligjet dhe forcat natyrore (në kundërshtim me ato mbinatyrore ose shpirtërore) veprojnë në botë. Për ta shprehur në mënyrë më të saktë, materializmi thotë se çdo gjë në botë mund të katandiset në materie dhe rastësi.

Në librin e tij *“The Clockwork Image”*⁴ fizikani dhe shkencëtari i trurit nga Britania e Madhe profesor Donald Mackay, i cili ishte Profesor Kërkimesh për Komunikimet dhe Neuroshkencën në Universitetin e Keele-it, nxori për herë të parë termin “nothing-buttery” (emërzim i shprehjes në anglisht “nothing but”, që do të thotë “asgjë tjetër veç”) për të përshkruar këtë ide. Ishte zgjedhje e mirë, sepse materializmi pretendon se gjithçka mund të katandiset në *asgjë tjetër veç* atome dhe molekula dhe se shpjegimi i vetëm i vlefshëm për një fenomen natyror është ai shkencor. Një prej përmbledhjeve më të thjeshta me të cilën jam ndeshur u dha nga astronomi shumë i njohur, autor dhe pionier në Eksobiologji, Karl Segan, seria *“Kozmos”* e të cilit u pa nga pesë për qind e popullsisë së botës në televizionin PBS: “Kozmosi është gjithçka që është, ose që ka qenë ndonjëherë, ose që do të jetë ndonjëherë”⁵.

Axhenda

Ashtu si do ta shohim në një kapitull më pas, shkenca moderne mund të thuhet se daton nga koha kur shkencëtarët që besonin te Perëndia si krijues i universit filluan të mbështeteshin shumë në metodën shkencore gjatë hetimit të shkaqeve natyrore. Shkencizmi e ka kthyer përmbys duke e hedhur poshtë Perëndinë, duke pohuar se vetëm shkaqet natyrore ekzistojnë dhe se ato veprojnë kështu në mënyrë të pavarur. Ideja u rrit shumë gjatë 200 viteve të fundit, kështu që, në vend të ishte një pikëpamje që i përkiste një minoriteti të mbetur

nga kohë më pak të sofistikuar, materializmi ka mbërthyer fuqishëm shoqërinë bashkëkohore, sidomos në pjesën më të madhe të qarqeve arsimore.

Në librin e tij të shkëlqyer *“Reason in the Balance”* (“Arsye në baraspeshë”), profesori i Ligjit Phillip Johnson vëren: “Pjesa më e madhe e intelektualëve që kanë ndikim në Amerikë dhe në botë janë kryesisht natyralistë, të cilët hamendësojnë se Perëndia ekziston vetëm si një ide në mendjet e besimtarëve fetarë. Në universitetet tona, natyralizmi, doktrina se natyra është “gjithçka që është”, është hamendësimi i padiskutueshëm që motivon jo vetëm shkencën natyrore, por veprën intelektuale të të gjitha llojeve”⁶. Profesori Kirsten Birkett, drejtor i Qendrës Matthias për Studimin e Besimeve Moderne, bie dakord dhe thotë se materializmi “tani është pikëpamja e përvetësuar në pjesën më të madhe të instituteve dhe botimeve jofetare”⁷.

Vëzhgimet e bëra kohët e fundit në Shtetet e Bashkuara duket se e mbështesin këtë. Ndërsa rreth 90% e të pyeturve thanë se besonin te Perëndia, vetëm 40% e shkencëtarëve thanë kështu, ndërsa mes anëtarëve të Akademisë Kombëtare të Shkencave, që është prestigjioze në Amerikë (ajka e shkencëtarëve të vendit), shifra ra në më pak se 10%. Po kaq me rëndësi është sugjeruar se “...grupi i shkencëtarëve që janë më shumë përgjegjës për t’ia paraqitur “shkencën” komunitetit të gjerë mbizotërohet nga njerëz që kanë pranuar hapur ateizmin dhe një filozofi materialiste të jetës”⁸.

Asnjë prej këtyre nuk e ndryshon faktin që një numër domethënës shkencëtarësh të shquar e hedhin poshtë materializmin, por ndihmon për të shpjeguar se përse ka një ndikim në rritje të miliona njerëz të cilët asnjëherë nuk e kanë mbështetur.

Ashtu siç e shpjegon Phillip Johnson, është e lehtë të thuash se materializmi ka një nënkuptim fetar radikal: “Nëse natyralizmi është i vërtetë, atëherë njerëzimi e krijoi Perëndinë, jo e kundërta. Në këtë rast, racionaliteti kërkon që ne ta njohim Krijuesin si qenie imagjinare që ka qenë gjithmonë dhe se ne mbështetemi vetëm në gjërat që janë të vërteta, si vetja jonë dhe bota materiale e natyrës”⁹. Ky është një faktor themelor në materializëm dhe të çon në faktin që materialistët e dedikuar kanë një axhendë të veçantë. Profesori Stehpen Barr, fizikan i grincës teorike në Institutin Kërkimor Bartol të Universitetit të

Delaware, shprehet kështu: “Për shumë njerëz materializmi shkencor nuk është një filozofi e ftohtë, por një ideologji e mbrojtur me pasion... mbështetësit e tij e shohin shkencën si të ketë një mision që shkon përtej hetimit të thjeshtë të natyrës apo zbulimit të ligjeve fizike. Ky mision është që të lirojë njerëzimin nga bestytia në të gjitha format e saj dhe sidomos në formën e fesë”¹⁰.

Askush nuk siguron një shembull më të mirë sesa Peter Atkins. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, qeveria britanike bëri një lëvizje për të prezantuar një ligj që synonte në parandalimin “e provokimit të zemërimit fetar”. Në përgjigje të kësaj, Peter Atkins i shkroi një letër gazetës “*The Times Higher Education Supplement*”, që kritikonte fenë si mohuese të fuqisë së intelektit njerëzor, që nxiste përtacinë si mënyrë argumenti, që mashtronte kur ofronte përfitime në jetën pas vdekjes, që shkatërronte lirinë individuale dhe nxiste dhunën. Dy fjalitë në hyrje zbulonin synimin që qëndronte pas sulmit: “*Kjo letër synon të jetë një provokim nga zemërimi fetar. Besoj se nuk është krim që të nxitësh njerëzit të përbuzin fenë dhe gjithçka ajo përfaqëson, por, ndërsa koha po mbaron për lirinë e shprehjes, e mendova të përshtatshme të përpiqesha për të shpëtuar botën nga vetvetja para se të jetë shumë vonë*”¹¹.

I cituar në gazetën “*Independent*”, dymbëdhjetë vjet më parë, filozofi britanik dhe materialisti sir Alfred Ayer foli me më shumë pasion (edhe pse përdori një frazë të çuditshme!): “Perëndia im, Perëndia im, do të vdes i lumtur nëse bëj që një person të mos e besojë Perëndinë”¹².

Kjo konfirmon axhendën e materializmit, që është të çlirojë njeriun nga të gjitha format e besimit fetar: së pari, sepse feja këmbëngul se ka një botë shpirtërore përtej natyrës; dhe së dyti, sepse në sytë e materialistit feja është irracionale, që varet në asgjë më shumë se besimi në të mirë dhe bestytia në të keqe, diçka që u zhvillua gjatë fazës primitive në evolucionin e specieve njerëzore.

Richard Dawkins, profesor me titullin Çarls Simonyi i Të Kuptuarit Publik të Shkencës në Universitetin e Oksfordit (dhe ateisti më i njohur i Britanisë), foli hapur për të. Në një intervistë në televizion ai shprehu zemërimin e tij se disa njerëz “harxhojnë shumë kohë duke mësuar mësimet e kishës”, sepse, “për mua, feja është një armik i së vërtetës”¹³.

Diku tjetër është i njohur sulmi i tij ndaj fesë si “virus i mendjes”¹⁴ dhe e quajti besimin fetar “bestytни që të budallalleps”¹⁵.

Dy shkencëtarët britanikë Francis Crick dhe James Watson, të cilët e bënë për vete botën më 1953-shin me zbulimin e tyre të strukturës dyhelikëshe të ADN-së, e kanë sulmuar të dy fenë me entuziazëm të njëjtë. Crick tha se ishte përcmimi për fenë që e shtyu atë te shkenca. Më 1961, Crick hoqi dorë si Anëtar i Kolegjit Churchill në Kembrixh, kur aty u propozua të ndërtohej një kishëz. Kur sër Winston Churchill i shkroi atij se vetëm ata që kishin dëshirë mund të hynin në kishëz, Crick u përgjigj se në ato kushte kolegji duhej të ndërtonte një bordello dhe futi në zarf një çek prej dhjetë gini (lloj monedhe) për çmimin!¹⁶ Watson i quante shpjegimet fetare “mite nga e shkuara” dhe tha në “Daily Telegraph”: “Sa herë që ti kupton diçka, feja ka më pak gjasa të jetë e vërtetë”¹⁷.

Këta njerëz gjuajnë rëndë, prandaj duhet të konsiderohen në fushat e tyre të veçanta të ekspertizës shkencore, por asnjë prej tyre nuk është autoritet në fushën e fesë dhe nuk jam në dijeni se ndonjëri prej tyre ka nxjerrë ndonjë copëz dëshmie për të mbështetur pohimet e tyre ekstravagante.

Për sa i përket besimit të krishterë, nuk është me vend ta sulmosh atë thjesht si bestytни. Stephen Barr vë në dukje se Bibla u ndesh me këtë kritikë shumë kohë para fillimit të shkencës moderne: “Libri i Zanafillës vetë në pjesën më të madhe kishte për synim, na thonë shkollarët, të ishte polemizues kundër bestytнisë pagane. Për shembull, ndërsa dielli dhe hëna ishin objekte adhurimi në fenë pagane, Libri i Zanafillës mësonte se ato nuk ishin gjë tjetër veç llampa të vendosura në qiell për t’i dhënë dritë ditës dhe natës: jo perëndi, por gjëra në kuptimin e plotë, krijesa të një Perëndie të vërtetë. Po ashtu njeriu nuk do t’u përulej as kafshëve dhe forcave të natyrës si në fenë pagane; përkundrazi, njeriu, si qenie racionale i bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, do të ushtronte sundimin mbi ta”¹⁸.

Ajo që duhet të kuptojmë këtu (me rrëfimin e Crick si ilustrim i mirë) është që materialistët nxiten jo nga lloji i fakteve që kërkojnë në shkencën e tyre, por nga pikëpamja e tyre për botën. Kudo që duket se të çon dëshmia, ata nuk pranojnë të shkojnë përtej fizikës në metafizikë.

Do të ishte e vështirë për këdo për të qenë më i hapur për këtë se profesor Richard Lewontin, gjenetist, biolog dhe komentator social në Universitetin e Harvardit: “Gatishmëria jonë për të pranuar pohime shkencore që janë kundër gjykimit të shëndoshë është çelësi për kuptimin e përpjekjes së vërtetë ndërmjet shkencës dhe mbinatyrores. Ne mbajmë anën e shkencës, pavarësisht nga absurditetet e dukshme të disa prej teorive të saj, pavarësisht se ka dështuar të përmbushë shumë nga premtimet e veta ekstravagante për shëndet dhe jetë, pavarësisht nga toleranca e komunitetit shkencor për histori që thonë “kështu ndodh”, për arsye se kemi një përkushtim kryesor ndaj materializmit. Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës na detyrojnë disi të pranojmë një shpjegim material të botës fenomenale, por, përkundrazi, se ne detyrohemi nga një zell prioritar ndaj çështjeve materiale për të krijuar një aparat hetimi dhe një seri konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, pavarësisht sa kundër intuitës mund të jetë, pavarësisht sa mistifikues ndaj të paditurve. Për më tepër se materializmi është absolute, sepse nuk mund të lejojmë një këmbë hyjnore në derë”¹⁹.

Kjo zbulon një sekret të madh të shkencizmit! Në gjuhën e një njeriu jofetar, Lewontin po thotë se, pavarësisht se sa të palogjikshme, të pakënaqshme apo të pamundshme mund të duken hipoteza dhe teori të caktuara materialiste, ato duhet të pranohen thjesht se janë materialiste. Kjo gjë vështirë se kualifikohet si shkencë e ndershme, prandaj duket e çuditshme se materialistë të vendosur duket se nuk e kuptojnë këtë. Richard Dawkins thotë se, po t’i kërkohej një frazë e vetme për të karakterizuar rolin e tij si profesor i Të Kuptuarit Publik të Shkencës, ai do të zgjidhte: “Mbështetës pa përfitim i së vërtetës”²⁰, e megjithatë ai me pasion i është përkushtuar materializmit, saqë nuk do të lejojë t’i japë ndonjë pohimi tjetër mundësinë për t’u dëgjuar!

Ky lloj dogmatizmi vështirë se i bën ndonjë nder materializmit, sepse, ashtu siç e vë në dukje edhe Kirsten Birkett, “është apo nuk është materializmi i vërtetë, nuk mund të vërtetohet nga aktiviteti që në mënyrë pragmatike zgjedh të mos e diskutojë alternativën. Metoda shkencore (ashtu si praktikohet nga komuniteti shkencor) nuk do të “zbulojë” asnjëherë shkaqe mbinatyrore, përderisa nuk i kërkon dhe me përkufizim nuk mund t’i pranojë ato”²¹.

Stephen Barr nënvizon rëndësinë e kësaj, ndërsa përpigemi t'i përgjigjemi pyetjes së paraqitur në këtë libër: “Ajo që shumë njerëz mendojnë se është një konflikt midis fesë dhe shkencës, është me të vërtetë diçka tjetër. Është konflikt midis fesë dhe materializmit. Materializmi e mendon veten si shkencor, dhe me të vërtetë shpesh quhet “materializëm shkencor”, madje edhe nga kundërshtarët e tij, por nuk ka pohim legjitim në mënyrë që të jetë pjesë e shkencës”²².

Pyetje²³

Në librin tij “*Blind Alley Beliefs*” (“Besime të shtigjeve pa krye”), filozofi britanik David Cook imagjionon se çfarë do të ndodhte nëse të gjitha gazetatat kombëtare do të dilnin me titullin: “Materializmi është i vërtetë” dhe me një seri artikujsh për të mbështetur pohimin. Pastaj ai pyet se si kjo gjë mund të ndikojë popullsinë. Po të bindeshim se gazetatat kishin të drejtë dhe se edhe mendimet e ndjenjat tona nuk do të ishin gjë tjetër veç materie, çfarë ndryshimi do të kishte për mënyrën si jetojmë? Cook vazhdon: “Pasi tronditja dhe e reja të kalonin, jeta do të ishte e njëjtë... Ka diçka jashtëzakonisht të çuditshme për një pikëpamje që është e drejtë dhe e vërtetë, por që nuk bën aspak ndonjë ndryshim. Çfarë lloj pikëpamjeje është ajo që është e vërtetë, por që, në fakt, nuk ndikon në asgjë që bëjmë? Duket një lloj e vërtete çuditërisht e largët”²⁴.

Cook ka të drejtë në atë që një pjesë e madhe e shoqërisë moderne është e ngopur me materializëm, që është bërë ndikimi përcaktues në etikën, stilin e jetës dhe marrëdhëniet e njerëzve. Megjithatë, nëse materializmi është i vërtetë, ai ngre një numër të madh pyetjesh, ndaj të cilave nuk mund të japë përgjigje:

- Nëse nuk ka asnjë absolute përtej ekzistencës së materies, si mund të ketë një të vërtetë transhendente që na thotë se kështu është?
- Nëse qeniet njerëzore nuk janë asgjë më tepër se gjëra aksidentale në një masë universale materieje, Atkins thotë se njerëzimi është “lëng veshtullor në një planet”²⁵, si mundet që një person të ketë vlerë individuale ose vlerë personale?

- Nëse ka vetëm materie, çfarë kuptimi mund t'u japim koncepteve si: i mirë, i keq, moral, drejtësi, e vërtetë, dashuri, bukuri, dëshirë ose shpresë?
- Si mund ta shpjegojë materialisti krijimtarinë në botën e muzikës, dramës, artit apo edhe në atë të shkencës?
- Nëse qeniet njerëzore janë materiale të pastra, ku mund të gjejmë një burim për imagjinatë ose besim?
- Nëse një qenie njerëzore është vetëm një masë materieje, si dhe përse e mban mend të shkuarën, vlerëson të tashmen dhe pret të ardhmen?

Këto nuk janë më shumë se shembuj të pyetjeve me të cilat materializmi duhet të përballet, sepse nuk pranon të njohë një dallim të rëndësishëm, përkatësisht që, ndërsa shkenca është një mjet të cilin njeriu mund ta përdorë me efektshmëri të mahnitshme në shumë fusha, përtej arritjes së saj ka shumë fusha të tjera. Ne do ta zhvillojmë këtë në kapitullin tjetër, por nuk duhet të presim më që shkenca t'i përgjigjet çdo pyetjeje që mund të bëjmë, aq sa mund të presim po të përdorim një tub për të lëshuar një sondë kozmike apo një kazmë për të bërë operacion truri.

Zoologu i shquar i lindur në Brazil Peter Medawar, i cili u bë drejtor i Institutit Kombëtar të Londrës për Kërkime Mjekësore, vuri në dukje: “Nuk ka mënyrë më të shpejtë për një shkencëtar të prishë reputacionin dhe profesionin e vet, sesa të deklarojë fuqishëm, sidomos kur nuk kërkohet ndonjë deklaratë e këtij lloji, se shkenca di ose shpejt do të dijë përgjigjet e gjithë pyetjeve që ia vlen të bëhen dhe se pyetjet që nuk pranojnë një përgjigje shkencore janë, në njëfarë mënyre, “jopyetje” ose “pseudopyetje”, që vetëm njerëz të leshtë bëjnë dhe vetëm naivët shpallin se janë në gjendje t'u përgjigjen”²⁶. Shkencizmi sugjeron se metoda shkencore është e vetmja mënyrë për të gjetur përgjigje, por, ashtu si Donald MacKay tregoi me humor, është e qartë se nuk ndodh kështu: “Burri, i cili në emër të integritetit intelektual përpiqet të fitojë një grua në atë mënyrë me të cilën ai do të merrej me një problem në termodinamikë, ka një ide të gabuar të asaj se çfarë do të thotë integritet intelektual dhe ka shumë të ngjarë të ngelet beqar”²⁷.

Njerëz apo makina?

Pyetjet që kemi paraqitur deri tani janë më shumë se të çuditshme për materialistët, por këto nuk janë të vetmet me të cilat duhet të përballen. Kjo për shkak se materializmi ka lidhje të ngushtë me determinizmin, që thotë se çdo gjë që bëjmë kushtëzohet nga trashëgimia dhe mjedisi. Lidhja është e dukshme: nëse nuk ka Perëndi apo ndonjë realitet tjetër transhendent, gjithçka që kemi është një univers i mbyllur e mekanik, me njerëzimin si një prej “pjesëve të tij funksionuese”. Askush nuk mohon seriozisht që disa faktorë kimikë, psikologjikë dhe sociologjikë ndikojnë në mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe veprojnë, por kjo nuk mjafton për determinizmin, i cili thotë se *të gjitha* vendimet tona janë rezultati i pashmangshëm i faktorëve materialistë të cilët nuk i kontrollojmë dot.

Si qenie njerëzore jo vetëm jemi të vetëdijshëm për ndjesitë, por edhe reflektojmë mbi to. Ne përfshihemi në arsyetim kompleks dhe të menduar imagjinar; vlerësojmë të dhëna, zhvillojmë ide, ushtrojmë imagjinatën dhe marrim vendime. Megjithatë, Peter Atkins këmbëngul që “... në nivelin më të thellë vendimet janë ndreqje të dispozitave në molekulat brenda një numri të madh qelizash në tru”²⁸. Richard Dawkins merr të njëjtën linjë dhe argumenton se dashuria është “prodhim i ndonjë pajisjeje shumë të ndërlikuar, pajisjeje nervore ose ndonjë pajisjeje kompjuterike”²⁹. Por a është ky një shpjegim i kënaqshëm për emocionet e fuqishme dhe përvojat jetëndryshuese që shoqërojmë me fjalën “dashuri”? Psikologu eksperimentues Steven Pinker mbështet Atkins e Dawkins dhe pohon hapur: “Në mendje nuk ekziston asgjë që nuk është aktivitet neuronesh”³⁰. Materialistët mbështeten fort në këtë lloj mendimi, por astrofizikani Rodney Holder e vë lehtësisht në dukje të metën e tij radikale dhe fatale: “Nëse nuk jemi asgjë tjetër veç atome dhe molekula të organizuara në një mënyrë të veçantë përmes proceseve të rastësishme të evolucionit, atëherë dashuria, bukuria, e mira, e keqja, vullneti i lirë, arsyeja vetë, me të vërtetë ajo që na bën njerëzor dhe na ngre mbi pjesën tjetër të rendit të krijuar, humbasin objektivitetin e tyre. Përse duhet ta dua fqinjin dhe të lë gjërat e mia për ta ndihmuar atë? Përkundrazi, përse të mos marr çdo gjë që mundem për vete, duke shkelur këdo që më zë rrugën?”³¹

Determinizimi materialist nuk mund të jetë në harmoni me jetesën morale dhe përgjegjëse njerëzore. Dallimi ndërmjet qenieve njerëzore dhe makinave nuk është thjesht relative, por absolut. Gjatë Leksioneve Reith të vitit 1967, antropologu anglez sir Edmund Leach pohoi: “Nuk ka hapësirë të madhe mes asaj që është njerëzore dhe asaj që është mekanike”, por kjo është qesharake. Nëse nuk jemi asgjë, por veç ashtu si ka thënë dikush, “kompjuterat të përbërë nga mishi”, duhet, me sa duket, të zbatojmë të njëjtat koncepte morale në marrëdhëniet tona me kompjuterat ashtu si bëjmë në marrëdhëniet tona me njëritjetrin. Në mënyrë alternative, ashtu si matematikani dhe fizikani Roger Penrose argumenton, nëse nuk jemi gjë tjetër veç kompjuterat, të programuar në një mënyrë të caktuar, atëherë arsyeja jonë, emocionet, dashuria dhe ndjenjat artistike janë pa kuptim³². Fakti i thjeshtë është se determinizmi nuk është i jetueshëm. Për më tepër, filozofi i shquar i shkencës sir Karl Popper mbron mendimin se po të ishte e vërtetë kjo, *as që nuk mund të argumentohet*, përderisa çdo argument i bërë në mbrojtje të saj do t'i duhej të kishte qenë i paravendosur, bashkë me ndonjë argument kundër tij!³³

Shkenca e vërtetë është e ndershme, pa fund, e arsyeshme dhe e përulur. Shkencizmi është krejtësisht e kundërta. Është pseudoshkencë dhe jo vetëm arrogant, irracional dhe i palogjikshëm, por mizor, që na vjedh çdo bazë për dinjitet, kuptim, qëllim ose shpresë. Ashtu si Peter Atkins e pranon hapur në *“Creation Revisited”* (“Krijimi i rivizituar”): “Çdo gjë vihet në lëvizje nga prishje e pamotivuar dhe e paqëllimshme”³⁴.

Besimtarë që nuk besojnë

Shkencizmi nuk është shkencë e vërtetë, por një sistem besimi që bëhet i detyrueshëm në një aktivitet. Gjatë një vizite në Afrikën e Jugut, disa vite më parë, më ftuan të merrja pjesë në një program radiofonik në Keip Taun (Cape Town). Ditë më parë programi ishte shënuar si “Besimtari kundrejt jobesimtarit”. Shfaqja njëorëshe filloi me prezantuesin (një ateist) që më prezantonte mua si besimtar dhe veten si jobesimtar, por në komentet e mia hyrëse vura në pikëpyetje gjithë bazën e programit dhe këmbëngula se ai gjithashtu ishte një

besimtar. Ai e sfidoi fuqishëm këtë, por unë vura në dukje: “Me gëzim e pranoj që jam besimtar, unë besoj në ekzistencën e Perëndisë. Por edhe ti je besimtar, ti beson në mosekzistencën e Perëndisë. Ajo që do të doja t’u tregojë dëgjuesve është dëshmia në të cilën mbështet besimin tënd në mosekzistencën e Perëndisë”. Ai nuk dinte çfarë të thoshte. Kjo gjë ishte befasese, sepse dikush duhet të zotërojë gjithë dëshminë në dizpozicion, para se të jetë i sigurt se asnjë nuk të çon në ekzistencën e Perëndisë.

Njerëzit mund të zgjedhin se *çfarë* të besojnë, por jo *nëse* të besojnë sepse besimi është ndërtuar brenda faktit të të qenit njeri. Ashtu siç e vë në dukje autori Martin Robinson: “Ata që e karakterizojnë veten si “jobesimtarë” nuk është se besojnë në asgjë. Përkundrazi, ata shpesh kanë një seri besimesh të përcaktuara, pas të cilave mbahen me aq pasion, aq sa mbahen te parimet e besimit të tyre të ashtuquajturit “besimtarë”³⁵. Do të merremi me këtë në një kapitull më vonë, por këtu duhet të sqarojmë mirë, sepse kjo pikëpamje e fundos shkencizmin. Shkenca bën pjesën më të madhe të parimit të verifikimit, e cila thotë se në mënyrë që një teori të pranohet si e vërtetë duhet të jetë në gjendje për verifikim ose falsifikim. Por nëse është kështu, si mund të vërtetohet në mënyrë shkencore se i vetmi realitet është ai që mund të vërtetohet në mënyrë shkencore? Shkencizmi thotë: “Atë që shihni, atë merrni”, por si mund ta dimë këtë? Kur shkencizmi thotë se vetëm ajo që mund të njihet dhe vërtetohet nga shkenca është racionale dhe e vërtetë, tregohet *irracional*, sepse vetë pohimi nuk mund të vërtetohet në mënyrë shkencore! Të thuash që “besoj po ta shoh”, vështirë se është e mjaftueshme.

Që materialisti të pohojë se asgjë tjetër nuk është e mundur, ka nevojë për më shumë mbështetje sesa pohimi se nuk ka agjë tjetër që mund të shohë. Ashtu si dikush ka thënë: “Çfarë mund të ketë më shumë kontradiktore, sesa ta kufizosh sistemin e dikujt në fenomen vëzhgues dhe pastaj të flasësh për të pavëzhgueshmen?”. J. P. Moreland me të drejtë thotë: “Dikush mund të kthehet te shkenca për të justifikuar shkencën, po aq sa dikush mund të ngrejë veten nga lllapat e këpucëve”³⁶. Që shkencizmi të thotë se Perëndia nuk ekziston, duhet që të braktisë rregullat me anë të të cilave vepron kur bën pohimet e veta.

Gazetari britanik Bryan Appleyard e quan shkencizmin “propagandë joshëse me rrezik”³⁷, por Bibla shkon më tej se kaq. E gjithë e vërteta, përfundimisht, e ka burimin e vet te Perëndia, i cili krijoi të gjithë realitetin jashtë vetes dhe mban gjithë ç’ka krijuar. Në personin e Birit të tij, Jezu Krishtit, ai i tha Ponc Pilatit: “Kush është për të vërtetën, e dëgjon zërin tim”³⁸. Të ngresh ndonjë ide tërësisht njerëzore në të njëjtën shkallë, nuk është asgjë tjetër veç idhujtari.

3.

Kontroll realiteti: shkenca dhe caqet e saj

Nëse pranojmë se hetimi shkencor zbatohet sa herë që qeniet njerëzore përpiqen të zbulojnë si funksionon bota, është e pamundur që të dimë kur filloi “shkenca”, por, zakonisht, pranohet se, në formën e saj moderne, ajo daton nga pjesa e hershme e shek. XVII. Përparimi u udhëhoq nga aristokrati, politikani, filozofi dhe shkencëtari i shquar anglez sëri Francis Bacon. I lindur më 1561, ai u bë avokat, prokuror, anëtar parlamenti, baron, viskont, këshilltar i mbretit, zëvendëskryeprokuror i përgjithshëm, prokuror i përgjithshëm, këshilltar i kurorës dhe kancelar i madh. Në veprën e tij të famshme “*Novum Organum*”, botuar për herë të parë më 1620-n, ai nxori një ide të re që u bë e njohur si metoda induktive, e cila theksonte rëndësinë e vëzhgimit dhe eksperimentit. Bacon e pa veten si shpikësin e një metode për ndezjen e një drite në natyrë, “që më në fund do të mbyllë dhe do të sjellë në dritë atë që është më e fshehur dhe më e fshehta në univers”. Këto janë pohime ekstravagante, por ndikimi i Bacon-it reflektohet në titujt e shumtë që i janë dhënë, mes tyre “Sekretari i natyrës”, “Ati i arsytimit induktiv” dhe “Profet i shkencës moderne”¹. (Si një shënim interesant, kërkimi i tij këmbëngulës për të vërtetën e çoi në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në

vdekje. Ndërsa udhëtonte me makinë pranë Highgate, më 1626-n, ai vendosi të eksperimentonte me efektin e të ftohtit në prishjen e mishit. Ndërsa mbushte me borë një shpend, mori të ftohtë që u zhvillua në bronshit fatal.)

Pishtari që Bacon dhe të tjerë ndezën ka qenë duke ndriçuar qysh atëherë, prandaj askush nuk mund të mohojë se shkenca dhe e bija, teknologjia, po revolucionarizojnë jetët tona në mënyra që do të ishin përtej besimit njëqind vjet më parë. Më 1899, Çarls H. Duell, komisionar i Zyrës Amerikane të Patentave pohoi: “Çdo gjë që mund të shpiket është shpikur”. Më 1943, kryetari i IBM-së Thomas Watson tha: “Mendoj se ka një treg botëror për ndoshta pesë kompjutera!”. Më 1949, një artikull në *“Popular Scientist”* sugjeroi se kompjuterat mund të peshojnë më në fund 1.5 ton! Thuhet se ka më shumë teknologji dixhitale në telefonin e sotëm celular, sesa kishte në anijen kozmike që në vitin 1969 çoi njeriun e parë në hënë.

Shkenca dhe teknologjia po e mbushin jetën tonë me një rrjedhë të vazhdueshme veglash, mjetesesh dhe pajisjesh që synojnë ta bëjnë jetën tonë më të gjatë, më të mbushur, më të lehtë dhe më të kënaqshme. Po të kisha jetuar në shek. XVII, do të kisha luajtur golf me një qese prej lëkure të mbushur me pendë të ziera. Topi që përdor sot ka një ndërtim molekular të ndërthurur, që kombinon diakrilatë zinku dhe gomë me densitet të lartë. Në një ditë me shumë shi, një lojtar golfi i shek. XVII do të ishte bërë qull (dhe ka mundësi të merrte të ftohtë fatal!). Sot, unë jam i mbrojtur nga një kostum shiu me mbulesë teflon me një shtresë të jashtme të petëzuar hidrofiliqe, një membranë me stil kapilarësh dhe një rrjet teknik “drop line” (çfarëdo kuptimi mund të ketë!), dhe i gjithë triumfi teknologjik peshon më pak se 700 gram.

Bryan Appleyard shkruan: “Kjo efektshmëri spektakolare dhe e padebatueshme është ‘asi’ që shkenca ka në dorë... Jeni të pakënaqur me cilësinë dhe kollajshmërinë e muzikës në shtëpinë tuaj? Ja, një magnetofon. Dëshironi të shmangni linë? Ja, një vaksinë. Dëshironi të shkoni në hënë? Ja, një raketë. Jeni i uritur? Ja, se si të rrisni më shumë ushqim. Jeni shumë i shëndoshë? Ja, se si të humbisni peshë. Ndihehi keq? Ja, një ilaç, ndihu më mirë. S’ka problem, thotë shkenca”².

Ka një tregues këtu për një arsye që shumë njerëz mendojnë se shkenca dhe feja janë divorcuar. Ashtu si do ta shohim në një

kapitull më vonë, metoda shkencore u ndërtua në një pikëpamje për natyrën me Perëndinë në qendër, por anëtarë me influencë filluan të tërhiqen nga kjo ide dhe të sugjerojnë se Perëndia mund të jetë i panevojshëm”. Sot, njohuritë gjithnjë në rritje për universin fizik dhe arritjet fenomenale në teknologji priren ta përshpejtojnë lëvizjen. Kush ka nevojë për Perëndinë kur mund të transplatojmë organe njerëzore, manipulojmë gjenet dhe të prodhojmë një rrip transmisioni të pafund me “ilaje çudibërëse” për të kontrolluar ose eliminuar sëmundje që ishin vdekjeprurëse disa vite më parë? Më 1941, biologu britanik sir Julian Huxley shkroi: “Shkenca natyrore e ka shtyrë Perëndinë në një largësi edhe më të madhe, derisa funksioni i tij si sundues dhe diktator zhduket”³, duke shtuar diku tjetër: “Perëndia thjesht po venitet”⁴. Në botën e sotme shkenca “po shihet si një lopë e shenjtë, e cila, nëse është ushqyer si duhet, do të vazhdojë të japë të mira konkrete për të mirën e të gjithëve”⁵. Materialistë të regjur si sir Edmund Leach shkojnë edhe më tej: “Njerëzit janë bërë si perënditë. A nuk ka ardhur koha të kuptojmë hyjninë tonë? Shkenca na ofron zotërim të plotë mbi mjedisin dhe fatin tonë”⁶.

Përshkrime, korrigjime, kundërshtime

Ka të paktën katër arsye se pse Leach e ka gabim.

I. Përshkrimi shkencor i diçkaje nuk është i vetmi

Po të kishit ardhur për vizitë tek unë dhe t’ju thoja: “Do të fus gjethe *Camellia sinensis* në një lëng të përbërë nga oksigjeni dhe hidrogjeni”, do të pyesnit veten se çfarë kërkoj të them, por kjo është një mënyrë shkencore për të thënë: “Do të bëj çajin”. Po t’i thosha gruas sime: “Le të vëmë pranë e pranë muskujt orbikularë dhe të kemi një transmetim reciprok të dioksidit të karbonit dhe mikrobeve”, ajo do të rrudhte ballin e hutuar, por po të bëja të njëjtin sugjerim në gjuhë joshkencore, “Dua të të puth”, do të shprejoja të merrija një përgjigje më inkurajuese! Po të më ftonit të shihnim dikë që fërkon të brendshmet e një deleje të ngordhur me flokët e një kali të ngordhur, do t’ju prisja ftohtë, por, nëse do ta shprehnit të njëjtën ftesë ndryshe dhe të më kërkonit

të shkoja me ju për të dëgjuar një solo me violinë, mund të doja të shikoja axhendën time⁷. Në të njëjtën mënyrë, të thuash se një koncert për piano nuk është asgjë më tepër se njolla dhe viza të zeza në faqe letre, është vështirë ta tregosh me fjalë!

2. Pohimet shkencore nuk janë të pandryshueshme

Historia e shkencës ka shembuj të shumtë “faktesh” shkencore që më vonë kanë qenë braktisur në dritën e zbulimeve pasuese. Ja, dhjetë shembuj për ta kuptuar:

- Astronomi dhe gjeografi egjiptian i shek. II Claudius Ptolemy duket se ka bindur të gjithë se trupat qiellorë në univers rrotulloheshin rreth tokës, dhe vetëm në shek. XVI astronomi polak Nikolas Koperniku (Nicolaus Copernicus) vërtetoi se ai e kishte gabim.
- Në shek. XVII shkencëtari i njohur universalisht sir Isak Njuton (Isaac Newton) përkufizoi ligjet e lëvizjes dhe forcës së rëndësës universale, por shkencëtarët kanë zbuluar më vonë fusha ku ligjet e Njutonit nuk zbatohen.
- Më 1760, kimisti skocez Joseph Black tha se nxehtësia ishte një lloj substance ekstra (ai e quante atë kalorike), që i shtohet një objekti të nxehtë dhe që merrej nga një i ftohtë. Kjo teori pranohej gjerësisht, por do të ishte qesharake sot me njohurinë që kemi për lëvizjet dhe vibrimet e atomeve dhe molekulave.
- Dikur ishte “fakt” shkencor që një substancë e quajtur “eter” mbushte gjithë hapësirën dhe mbante “fuqinë tërheqëse” ndërmjet planetëve, por eksperimentet më 1887-n nga fizikani amerikan Albert Michelson dhe kolegu i tij Edward Morley çuan në braktisjen e idesë së “eterit” dhe përgatitën rrugën për teorinë e përgjithshme të relativitetit.
- Dikur mendohej se drita përbëhej nga një burim grimcash që lëviznin përmes hapësirës, por në shek. XIX shkencëtarët thanë se nuk ishte ashtu dhe se drita duhej të mendohej në terma valësh. Më vonë, shkencëtarët vendosën se drita i kishte të dyja karakteristikat: si valë dhe si grimcë, në varësi të eksperimentit që përfshihej.

- Mjekësia mbështetej në katër “humoret” që duhet të ishin në baraspeshë për të siguruar shëndet të mirë, por asnjë doktor serioz nuk e beson këtë tani.
- Kur teleskopi hapësinor Hubble bëri një zbulim të ri marramendës disa vite më parë, një shkencëtar i shquar i tha shtypit: “Do të na duhet të rishkruajmë ligjet e fizikës”. Ajo që nënkuptonte ai nuk ishte se bota fizike kishte ndryshuar, por se shkencëtarët duhet të ndryshonin teoritë e tyre rreth saj.
- Kur shkencëtari britanik Richard Roberts dhe kolegu i tij amerikan Phillip Sharp, bashkëfitues të çmimit “Nobel” për mjekësi në vitin 1993, revolucionarizuan kërkimin bazë në biologji duke zbuluar se sekuencat e gjeneve ndërpriten nga pjesë të vogla ADN-je të quajtura introne, Roberts i tha “*Daily Telegraph*”: “Ishte një prej atyre zbulimeve ku dogma bie”⁸.
- Në një konferencë të Shoqatës Amerikane për Përparimin e Shkencës të mbajtur më 2002-shin, një folës i shquar tha: “Jemi shumë afër një pikëpamjeje të re për realitetin. Mënyra se si mendojmë rreth gjërave do të ndryshojë”⁹.
- Një ilustrim i fundit përputhet veçanërisht me temën tonë. Më 1861, Akademia Franceze e Shkencës, e themeluar 200 vjet më parë, atëherë kur shkenca moderne po lindte, botoi një broshurë duke radhitur pesëdhjetë e një “fakte” shkencore që supozonin të tregonin se Biblës nuk mund t’i besohej, por sot as edhe një prej atyre “fakteve” nuk ka ndonjë mbështetje shkencore.

Këta shembuj mjaftojnë për të treguar se shkenca e vërtetë është gjithmonë në gjendje paqëndrueshmërie vetëkorrigjuese. Ashtu si shprehet Carl Segan: “Historia e shkencës është plot raste ku teori dhe hipoteza të pranuara më parë janë rrëzuar për t’u zëvendësuar nga ide të reja, të cilat i shpjegojnë të dhënat në mënyrë më të kënaqshme”¹⁰. Ja, përse profesori Steve Jones, profesor i Gjenetikës në Universitetin e Londrës, mund të thotë: “Shkenca është arti i të pasigurtës”¹¹. Karl Popper nënvizoi këtë formalisht: “Ideja e vjetër shkencore e *episteme*, njohurisë absolutisht të demonstrueshme, është vërtetuar si një idhull. Kërkesa për objektivitet shkencor e bën të pashmangshme që çdo pohim shkencor duhet të mbetet përgjithmonë një tentativë”¹². Diku

tjetër ai kishte një ilustrim të shkëlqyer për të shpjeguar se pohimet shkencore asnjëherë nuk mund të mendohen si absolute: “Struktura e guximshme e teorive të saj ngrihet sikur të ishte mbi një moçal. Është si një ndërtesë e ndërtuar mbi shtylla. Shtyllat shtyhen poshtë nga lart në moçal, por jo deri në ndonjë bazë të dhënë ose natyrore; dhe kur i japim fund përpjekjeve tona për të shtyrë shtyllat në shtresa më të thella, nuk ndodh për shkak se kemi arritur në tokë të sigurt. Ne thjesht ndalojmë kur jemi të kënaqur që ato janë mjaft të qëndrueshme për të mbajtur strukturën, të paktën tani për tani”¹³.

Edhe nëse zbulojmë se mund ta përdorim për avantazhin tonë, më e mira që mund të bëjmë për njohurinë shkencore është ta konsiderojmë atë si sigures. Nuk ka ndonjë libër që përmban të gjithë të vërtetën shkencore në çdo temë dhe kundër së cilës ne mund të kontrollojmë çdo teori shkencore. Ashtu si Del Ratzch, profesor i Filozofisë në kolegjin Calvin, Michigan, shprehet: “Komiteti i çmimit ‘Nobel’ nuk ka një libër përgjigjesh që të kontrollojë teoritë e propozuara”¹⁴. Shkenca është një proces të mësuarit në vazhdimësi, në të cilin nga koha në kohë gjërat që dikur thuhej se ishin të vërteta gjenden të rreme. Një vizatim satirik në “*New Scientist*” e ilustron mirë këtë. Në përgjigje të pohimit të mësuesit një student pyet: “Kjo është përgjigjja?”. “Po”, përgjigjet mësuesi. E hutuar, studentja proteston: “Por ju na thatë të kundërtën dje!”. “Xhenifer”, mësuesi kundërpërgjigjet, “kjo ndodhi dje. Duhet të mos harrojmë që shkenca po bën hapa të mahnitshme!” Në shkencën e vërtetë fjala më e fundit nuk është vendimtare!

3. Pohimet shkencore për një temë të caktuar shpesh janë kontradiktore ose jo të sakta

Kozmologët janë vazhdimisht në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin nëse universi kishte një fillim në kohë dhe nëse do të mbarojë me “Shtypje të madhe” apo një “Kërcim të madh”. Disa shkencëtarë besojnë në relativitetin e përgjithshëm; të tjerë në teorinë e grimcës hapësinore. Ka mosmërraveshje të mëdha mbi natyrën e saktë të elektroneve dhe grimcave të tjera subatomike. Më 1999, në një pasqyrë të një libri mbi evolucionin, “*Sunday Telegraph*” doli në përfundimin: “Evolucionistët modernë darvinianë janë ndër grindavecët më të hidhur”.¹⁵

Ndërkohë që biokimisti i Kembrixhit (Cambridge) Malcolm Dixon jep një shpjegim të rëndësishëm: "... ka më shumë mosmarrëveshje dhe kontradikta të dukshme brenda vetë shkencës, sesa ka mes shkencës dhe fesë"¹⁶.

Po ashtu, asnjë degë e shkencës nuk mund të na japë një tablo të plotë ose shumë të saktë, ashtu siç e ilustron edhe një fabul klasike moderne. Tregimi thotë se një shkencëtar social, një biolog dhe një fizikan dolën shëtitje me këmbë në Skoci. Kur pa një dele në një kodër, shkencëtari social thirri: "Shikoni, delet në Skoci janë të zeza". Biologu u përgjigj: "Jo, ti po kërcen në përfundime. Ajo që do të thuash është: "Në Skoci disa dele janë të zeza". "Aspak", kundërshtoi fizikani, "ajo që mund të themi nga ç'kemi parë është se në Skoci ka të paktën një dele, dhe të paktën njëra anë e së cilës është e zezë"!

4. Një pjesë e madhe njohurie shkon përtej arritjes së shkencës

Duke folur në televizionin BBC, më 1999-n, Richard Dawkins pohoi: "Mendoj se shkenca me të vërtetë e ka plotësuar nevojën që në të shkuarën e plotësonte feja, atë të të shpjeguarit të gjërave, të të shpjeguarit se përse jemi këtu, cila është origjina e jetës, nga erdhi bota dhe me çfarë ka të bëjë jeta"¹⁷, ndërsa më vonë, në po atë vit, ai tha për "*Daily Telegraph, Science Extra*": "Feja nuk është më një kandidat serioz në fushën e shpjegimit. Është zëvendësuar plotësisht nga shkenca"¹⁸. E megjithatë, këto fjalë të trumpetuara nuk përputhen me faktet e pranuar, duke filluar me ato që kanë lidhje me ekzistencën dhe natyrën e universit.

Pikënisje

Shkenca nuk është në gjendje të na tregojë se përse filloi të ekzistonte universi

Në disa kultura të lashta besohej se Toka qëndronte pa lëvizur në qendër të një vendosjeje të qëndrueshme dhe të përjetshme të trupave qiellorë, me trupa të tjerë që ishin të shpërndarë aty-këtu përmes një universi të pafund. Në kapitullin tjetër do të shohim një sfidë të

suksesshme ndaj kësaj ideje. Një tjetër erdhi më 1915-n, kur fizikani i lindur në Gjermani Albert Anjshtajni (Albert Einstein) bëri të njohur teorinë e tij të relativitetit, e cila në mënyrë të papritshme parashikonte se hapësira kozmike zgjerohet. Më 1929, astronomi amerikan Edwin Hubble zbuloi zgjerimin e universit në mënyrë eksperimentale, ndërsa puna e mëvonshme nga shkencëtarë të tjerë e çuan këtë në një hap më tej, që ishte domethënës, duke debatuar se, nëse universi po zgjerohet, do të thotë se dikur në të shkuarën gjithë materia e tij duhej të ketë qenë e mbyllur mirë në një pikë jashtëzakonisht të vogël të quajtur “njëjësi”. Kjo ide prodhoi versionin e parë të asaj që tani njihet universalisht si “teoria e Shpërthimit të Madh”, e cila thotë se universi kishte një pikë fillimi të përcaktuar, që tani mendohet se ka qenë rreth pesëmbëdhjetë miliardë vjet më parë.

Teoria ka fituar një hov të tillë, sa nga një pyetësor i “*Daily Telegraph*”, më 1995-n, afërsisht 40% e të intervistuarve thanë se besonin në një Shpërthim të Madh “që prodhoi materialin bazë të universit të sotëm”¹⁹. Megjithatë, në një artikull që shoqëronte rezultatet e pyetësorit, Steve Jones u kujtoi lexuesve se Shpërthimi i Madh ishte “vetëm një teori” dhe shtoi: “Mund të jetë e drejtë, por shkencëtarët grinden gjatë gjithë kohës për atë... mund të ndodhë që Shpërthimi i Madh të dalë një fluskë”²⁰. Kështu si paraqitet ajo, lë pa përgjigje disa pyetje shumë më interesante: Nga vinte “njëjësi” origjinal? Çfarë nënkuptojmë kur themi “origjinal”? Si e fitonte energjinë e vet? Kur filloi koha? Çfarë kishte para “orës zero”? Nuk na shtohen më shumë njohuritë kur një fizikan modern na thotë: “Universi ynë është thjesht një nga ato gjëra që ndodhin herë pas here”²¹.

Ligji Parë dhe i Dytë i Termodinamikës, që janë pranuar universalisht, thonë se kozmosi nuk mund të fillonte vetë. Duhej të kishte një çast kur energjia, materia, koha dhe hapësira filluan të ekzistonin. Nëse një Perëndi i përjetshëm, i pafund transhendent dhe i gjithëpushtetshëm përjashtohet, ku mund të kthehet shkenca për të shpjeguar origjinën e këtyre, kur nuk mund të shkojë më tej se çasti në të cilin ligjet mbi të cilat mbështetet filluan të vepronin? Edgar Andrews e zbulon problemin: “Pavarësisht se sa shumë mund t’ia afrojmë dikush çastit të origjinës modelin shkencor të kozmosit, mbetet e pamundur për një shpjegim të tillë që të aplikohet në ose para pikës “ora zero”. Kështu

rrjedh se *shkenca, madje edhe në rastin e saj më spekulativ, duhet të mos ofrojë më ndonjë shpjegim ose edhe përshkrim të ngjarjes së vërtetë të origjinës*²².

Materialistët e vendosur përdorin çdo lloj idesh për t'iu shmangur kësaj. Peter Atkins varet pas asaj që njihet si hipoteza e luhatjes së kuantit, në të cilën, për ta cituar atë në *“Creation Revisited”* (“Krijimi i rivizituar”), “hapësira-kohë prodhon pluhurin e vet në procesin e mbledhjes së vet”²³. Çfarëdo që Atkins kishte në mendje, një artikull në *“New Scientist”* ekspozon me kujdes dobësinë e gjithë idesë: “Në fillim nuk kishte asgjë, pastaj ka diçka... një entuziazëm kuantit, një dridhje pasigurie... dhe, para se ta kuptoni, ata kanë hequr njëqind miliardë galaksi nga kapelet e tyre të kuantëve”²⁴.

Edhe ata që shpallin se kuptojnë mekanikën kuantike, arrijnë një pikë në të cilën ligjet e fizikës bien, prandaj ata përballen me nevojën për të shpjeguar se nga erdhën energjia dhe materia së pari, përse një Shpërthim i Madh duhet të ketë ndodhur dhe përse duhej të kishte diçka në vend të asgjësë. Ashtu si Michael Poole, lektor në Edukimin

Shkencor në Kolegjin e Mbretit në Londër, vë në dukje, kjo i çon ata në zona përtej arritjes së shkencës: “Sapo shkencëtarët fillojnë të pyesin se përse ka një univers për ta studiuar ose përse shkenca vepron në një mënyrë të rregullt dhe uniforme apo nëse ka apo jo një mendje përtej ligjeve që ata vëzhgojnë, ata kërkojnë tipe të ndryshme shpjegimesh nga një shpjegim shkencor”²⁵. Në *“Black Holes and Baby Universes”* (“Vrima të Zeza dhe universe foshnje”), kozmologu britanik Stephen Hawking, profesor Lukasian i Matematikës në Universitetin e Kembrixhit, vëren: “Megjithëse shkenca mund të zgjidhë problemin e mënyrës se si filloi universi, ajo nuk mund t’i përgjigjet pyetjes: përse e merr mundimin universi për të ekzistuar? Unë nuk di si t’i përgjigjem kësaj”²⁶.

Shkenca nuk është në gjendje të shpjegojë përse ka ligje shkencore apo natyrore ose përse ata janë kaq në harmoni dhe të varur nga njëri-tjetri.

Shkenca funksionon, sepse shkencëtarët hamendësojnë vlefshmërinë, harmoninë dhe varësinë e ligjeve të fizikës, e megjithatë nuk ka ndonjë shpjegim shkencor se përse këto ligje ekzistojnë, nga vijnë ose përse

veprojnë ashtu si në të vërtetë bëjnë. Keith Ward, profesor Regius i Teologjisë në Universitetin e Oksfordit, përdor një ilustrim dëfryes për të shpjeguar: “Le të supozojmë se ligjet bazë të fizikës filluan të ekzistonin pa asnjë arsye. Një ditë ato nuk ekzistonin. Ditën tjetër, ja ku ishin, duke sunduar sjelljen e elektroneve dhe atomeve. Nëse diçka mund të fillojë papritur të ekzistojë pa asnjë arsye, në të vërtetë nuk ka ndonjë mënyrë të llogaritësh probabilitetin që edhe ligjet e fizikës të veprojnë kështu. Një ditë mund të mos ketë asgjë. Ditën tjetër, mund të ketë një karrotë shumë të madhe. Asgjë tjetër që ekziston, por aty, vetëm dhe më e madhe se jeta, një karrotë e stërmadhe. Nëse çdo gjë është e mundur, me siguri që edhe kjo është. Të nesërmen, karrota mund të zhduket dhe të zëvendësohet nga një gorillë e purpurt me njolla. Përse jo? Jemi në një univers ose jounivers, ku çdo gjë ose asgjë mund të ndodhë pa asnjë arsye. Përse kjo duket e çuditshme, madje qesharake, ndërsa mendimi se disa ligje të fizikës mund të fillojnë papritur të ekzistojnë nuk duket? Logjikisht, ata janë baras”²⁷.

Ka më shumë në botë se sa mund të shpjegojë ose shprehë fizika dhe shkenca nuk e ka idenë se si filloi të shpërndahej energjia në atë mënyrë që universi ynë është kozmos, jo kaos. Edgar Andrews e shpreh mirë: “Nëse pyesim shkencën se përse ligjet janë ashtu si janë, dhe jo ndryshe, nëse ligji i rëndesës është e anasjellta e distancës në katror, shkenca nuk mund të bëjë asgjë, por të mbledhë supet e saj matematikore dhe të përgjigjet: ‘Kjo pyetje qëndron jashtë referencave të mia’”²⁸. Kur Peter Atkins na thotë se për gjithë madhësinë e tij mahnitëse, diversitetin dhe rregullin e ndërlidhur, i gjithë universi është “një rirregullim angazhues dhe i punuar mirë i asgjësë”²⁹, vështirë se po jep një kontribut ndihmues për këtë temë.

Shkenca nuk mund të shpjegojë përse universi është i akorduar në mënyrë aq të mahnitshme, sa të mbështesë jetën inteligjente në planetin tonë

Që Toka të funksionojë ashtu si funksionon në ruajtjen e jetës, duhet të ketë një rregullim kompleks dhe të përsosur të elementëve tokësorë dhe ekstratokësorë. Për të dhënë disa nga elementët më të njohur, masa e Tokës, shpejtësia e saj rrotulluese, pjerrësia e akseve të saj relativë ndaj planit të orbitës së saj, distanca e saj nga dielli dhe raporti

i saj tokë/ujë, të gjitha duhet të jenë të sakta. Ne kemi nevojë për dritë, por jo shumë rreze ultraviolet; për nxehtësi, por jo shumë. Kemi nevojë për fushën magnetike të tokës për të na mbrojtur nga rrezet kozmike, për atmosferën mbi kokat tona që të na mbrojë nga metorët dhe për një mburojë shkëmbi që të parandalojë të mos bëhemi hi. Shkollari i Oksfordit J. L. Mackie, një nga ateistët më ndikues të shek. XX, pranoi në librin e tij *"The Miracle of Theism"* ("Mrekullia e Teizmit"): "Është... e habitshme që elementët e kësaj njësie të papërsëritshme janë të sakta për jetën, kur, fare mirë, mund të kishin qenë të gabuara"³⁰.

Ai nuk po e ekzagjeron. Në vitet e fundit shkenca ka mbledhur një masë komplekse evidencash për të mbështetur të ashtuquajturin "parimi antropik", i cili thotë se universi është përshtatur për të mbështetur jetën inteligjente në planetin tonë. Kjo përfshin marrëdhënien ndërmjet fuqive relative të katër forcave themelore të natyrës (graviteti, elektromagnetizmi, forca e fortë nukleare dhe forca e dobët nukleare), raportin e masës së protonit dhe neutronit, dy nga tre grimcat subatomike që formojnë atomin (protoni është 1,836 herë më i madh se elektroni) dhe pesha pak më e madhe e materies mbi antimaterien. Është thënë se po të kishte qenë pesha më e madhe e materies mbi antimaterien e ndryshme me rreth një grimcë për dhjetë miliardë, bota jonë jetëmbajtëse nuk do të kishte filluar kurrë të ekzistonte³¹. Po të kishte patur sasi të barabarta, do të kishte patur "një ngjarje asgjësimi të jashtëzakonshme", duke lënë "vetëm fare pak grimca materieje dhe antimaterieje në mbetje të shpërndara dhe të izoluara"³². Përveç kësaj, mënyra se si dendësia kritike e universit ndikon tërheqjen e rëndësës ndërmjet strukturave kozmike, duhet të ishte imtësisht e saktë. Edhe pse pranon teorinë e sotme shumë të njohur, Stephen Hawking thotë: "Nëse një sekondë pas Shpërthimit të Madh shpejtësia e zgjerimit do të kishte qenë më e vogël, sikur edhe me një pjesë në njëqind mijë milion milion, universi do të kishte rirënë para se të arrinte masën që ka tani"³³. Baraspesha mes efekteve të shtrirjes dhe tkurrjes është kaq e saktë, sa Paul Davies, profesor i Filozofisë Natyrore në Qendrën Australiane për Astrobiologji në Universitetin Macquaire në Sidnei, e përngjason atë me marrjen e një shënjestre 2.54 cm të gjerë në anën tjetër të universit të vëzhgueshëm dhe ta godasësh shenjë"³⁴.

Kam folur me më shumë hollësi për përshtatjen dhe çështjet që lidhen me të diku tjetër³⁵, por një shembull tjetër do ta plotësojë këtë pjesë. Karboni dhe oksigjeni janë të domosdoshëm për jetën, megjithatë struktura e atomit të karbonit varet në toleranca kaq të ngushta, sa që edhe devijimet më të lehta do ta kishin bërë të pamundur jetën. Duke komentuar mbi nivelet e sakta të energjisë së kërkuar, astronomi mbretëror sër Martin Rees dhe shkrimtari në fushën e shkencës John Gribbin dolën në përfundimin: “Ky kombinim rastësish, i saktë për rezonancë në karbonin 12 dhe i gabuar në oksigjenin 16, është me të vërtetë mbresëlënëse. *Nuk ka evidencë më të mirë për të mbështetur argumentin se universi është skicuar për të mirën tonë, i prerë për njeriun*”³⁶. Si Rees ashtu edhe Gribbin e hedhin poshtë idenë e një Krijuesi personal, por, kur astronomi i shquar sër Fred Hoyle kuptoi domethëniet e atyre që ata kishin zbuluar, rrëfeu: “Asgjë nuk e ka shkundur ateizmin tim sa ky zbulim”³⁷. Stephen Hawking shkon edhe më tej duke thënë: “Do të ishte shumë e vështirë të shpjegoje se përse universi duhej të fillonte pikërisht në këtë mënyrë, *përveçse po ta pranoje si veprimi i një Perëndie i cili kishte si synim të krijonte qenie si ne*”³⁸.

Jeta dhe të jetuarit

Shkenca nuk mund të shpjegojë se përse, si qenie njerëzore, ne jemi persona dhe jo thjesht objekte

Shkenca mund të na tregojë gjëra të mahnitshme për strukturën tonë fizike. Trupat tanë kanë mbi 100 nyje, 200 kocka dhe 600 muskuj, që të gjithë punojnë në harmoni të përsosur; duart tona, mjaft të fuqishme për të përdorur një varë, e përsëri mjaft delikate për të kryer një mikrooperacion, kanë mbi 652,000 funde nerovore; sytë tanë me 130 milionë qeliza receptore të paketuara në retinat e tyre të vogla, mund të merren me 500,000 mesazhe në të njëjtën kohë; zemrat tona rrahin 40,000,000 herë në vit, duke çuar gjak përmes 128,724 km enësh gjaku; truri ynë, edhe pse përbën vetëm 2% të peshës sonë trupore, ka 100 miliardë neurone, secili me deri në 100,000 lidhje me pjesën tjetër të rrjetit të trurit. Për më tepër, e gjithë paketa njerëzore

mbështillet në tri shtresa që nuk përshkohen nga uji, e plotësuar me sistemin e vet të brendandërtuar të ajrit të kondicionuar.

Këto janë statistika të mahnitshme, e megjithatë nuk na japin shpjegim se përse jemi më tepër se fenomen fizik. Në shkurt të vitit 2001, Projekti Ndërkombëtar i Gjenomit Njerëzor botoi raportin e shumëpritur, duke bërë të njohura tri miliardë gërmat që përbëjnë gjenomin njerëzor. Fizikani britanik James Le Fanu tha për *“Sunday Telegraph”* që kjo “arritje mbresëlënëse” ishte gjithashtu “lajm shkatërrues për shkencën, dhe sidomos për ata që, për 20 vjetët e shkuar, na kanë premtuar rregullisht se, sapo gjenomi të çahet, gjithçka që deri tani është e errët do të bëhet e qartë”³⁹. Pasi vuri në dukje se deri ku shkonte mangësia e informacionit, ai vazhdoi: “Kupa e shenjtë, ëndrra se shkenca shpejt do të na tregonte diçka domethënëse rreth asaj se çfarë do të thotë të jesh njeri, na ka rrëshkitur nëpër duar, e ne nuk jemi më të zgjuar se më parë. *Gjenomi njerëzor... nuk mund të na thotë absolutisht asgjë rreth gjërave vërtet të rëndësishme në jetë*”⁴⁰.

Fizikani amerikan dhe laureati për çmimin “Nobel” Stephen Weinberg thotë se jeta njerëzore është “një rezultat pak a shumë i pakuptimtë i një zinxhiri aksidentesh”⁴¹; Richard Dawkins na quan “automjete robotë”⁴², dhe Fred Hoyle pohon se “nuk jemi më shumë se makineri të zgjuara që janë zhvilluar si nënprodukte të çuditshme në një cep të universit”⁴³, megjithatë asnjë nga këto pohime ateiste nuk mund të shpjegojë *qenien tonë si njerëz*: vetëndërgjegjen tonë, aftësinë tonë për të kujtuar të shkuarën, të vlerësojmë të tashmen dhe të mendojmë për të ardhmen, ndjenjën tonë për dinjitet e vlerë dhe vlerësimin tonë të lindur artistik. Vaclav Havel, president i Republikës Çeke, me të drejtë thotë se vlera si këto, “kanë kuptim vetëm në perspektivën e të pafundmes dhe të të përjetshmes”⁴⁴. Madje edhe një evolucionist i patundur si Michael Ruse, profesor i Filozofisë dhe Zoologjisë në Universitetin e Shtetit në Florida, pranon: “Ende nuk ka diçka që vetëm sa ta gërvishë pak shpjegimin se si një majmun i transformuar mund të krijonte madhështinë e *“Simfonisë Korale”* të Bethovenit”⁴⁵. Mendimtari i shquar i shek. XX Francis Schaeffer dha një tablo më të madhe: “Askush nuk ka paraqitur një ide, për të mos thënë se ka treguar se është e mundur, që të shpjegojë se si fillimi

jopersonal, plus koha, plus rastësia, mund të japë personalitet. Ne na tërheqin fjalë të bukura pa fund, dhe ja ku shfaqet personaliteti”⁴⁶.

Shkenca nuk mund të na thotë asgjë për faktin se pse mendja ekziston dhe funksionon

Ashtu siç e pamë në kapitullin e mëparshëm, Peter Atkins e quante trurin njerëzor “instrumentin më të mrekullueshëm në univers”. Diku tjetër, ai ka pohuar se në nivelin më të lartë, “... vendimet janë përshtatje të dispozitave të molekulave brenda numrit të madh të qelizave të trurit”⁴⁷. Por, të heqësh procesin e të menduarit në këtë mënyrë, është tërësisht “nothing buttery” (“asgjë tjetër veç”) dhe i jep nxitje një ushtrie me pyetje jashtëzakonisht të rëndësishme. Nëse truri u programua rastësisht, nga e dimë se do të gjejë të vërtetën më shpesh, nga çdo do të prodhojnë ide kuptimplote gërmat e vendosura në mënyrë të parregullt. Nëse të menduarit njerëzor nuk është gjë tjetër veç kimi komplekse, impulse nervore dhe ndezja e sinapses, si mund të themi se një mendim i caktuar, madje edhe ky mendim që po shprehim tani, është racional ose i vërtetë? Nëse ajo që trajtojmë si të menduar racional nuk është gjë tjetër veç “përshtatje molekulash”, si mund të presim që të prodhojë ndonjë premisë, teori ose përfundim mbi të cilin mund të mbështetemi? Si mund të fitojmë racionalitet nga natyra joracionale? A do t’i besonim një flete të shtypur nga kompjuteri po ta dinim se udhëzimet në makinë do të ishin programuar nga forca të rastësishme joracionale? Si mund ta shpjegojmë qëndrimin tonë të hapur ndaj së vërtetës? Euan Squires, dikur profesor i Matematikës së Aplikuar në Universitetin e Durhamit, vëren: “Nuk duket e mundur që të përkufizosh vetëdijen në ndonjë mënyrë kuptimplote apo ta përshkruash atë duke e shprehur me anë gjërash të tjera”⁴⁸. Ashtu si shprehet autori britanik G. K. Chesterton: “(Materialisti) nuk mund të shpjegojë se përse diçka duhet të shkojë mirë, madje as vëzhgimi dhe deduktimi nuk mund ta bëjnë, përse logjika e shëndoshë të mos çojë në rrugë të gabuar po aq sa edhe logjika e dobët, nëse që të dyja janë lëvizje në trurin e një majmuni të hutuar”⁴⁹. Në “*Possible Worlds*” (“Botë të mundshme”), botuar më 1945-n, gjenetisti britanik (ateist), J. B. S. Haldane e çoi këtë edhe më tej: “Nëse proceset e

mia mendore përcaktohen tërësisht nga lëvizjet në trurin tim, nuk kam arsye të supozoj se besimet e mia janë të vërteta..., prandaj nuk kam arsye të supozoj se truri im është i përbërë nga atome”⁵⁰.

Shkenca me të drejtë mbështetet shumë në të menduarit racional, por, që të thuash me Francis Crick se “mendjet tona mund të shpjegohen nga ndërveprimi i qelizave nervore dhe molekulave”⁵¹, nuk na çon më tej. Biokimisti i Oksfordit dhe fitues i çmimit Templeton Arthur Pacocke, Warden Emeritus në Shoqatën e Shkencëtarëve të Emëruar na jep të vërtetën e thjeshtë të çështjes: “Shkenca mund të hetojë të gjitha aspektet fizike të trurit, por ka akoma diçka rreth mendjes ku nuk mund të arrijë, edhe rreth asaj se kush je në të vërtetë”⁵². Fizikani teorik britanik i lindur në Gjermani sër Rudolf Peierls, i cili dha kontributin e vet në teorinë e hershme të sistemit neutron-proton, e vulos këtë çështje: “Hipoteza se mund të përshkruash me anë të fizikës të gjithë funksionimin e një qenieje njerëzore... duke përfshirë njohurinë dhe vetëdijen e tij, nuk është e qëndrueshme. Përsëri mungon diçka”⁵³.

Shkenca nuk mund t'i shtojë asgjë cilësisë së brendshme të jetës

Tashmë kemi parë disa nga mënyrat në të cilat shkenca dhe teknologjia mund të ndikojnë jetën tonë në mënyrë radikale, po të flasim për gjëra si shëndeti, rehati dhe komunikimi, por këto i lënë cilësitë e brendshme të vetë jetës të paprekura. Më 1991, Këshilli Ndërkombëtar i Unioneve Shkencore mbajti një konferencë në Vjenë për të diskutuar nevojat që mund të ketë shkenca dhe teknologjia në shekullin XXI. Sër John Houghton më vonë i konsideroi rezultatet e një sesiioni në temën “Cilësia e jetës”: “Edhe pse ne mund të biem dakord mbi ata faktorë që në mënyrë ideale përbëjnë cilësinë e jetës, si shkencëtarë ne nuk mund të themi pothuajse asgjë (dhe pati debat të konsiderueshëm mbi çështjen) përreth mënyrës se si ta arrijmë në praktikë. Në veçanti, si mund të mundim egoizmin e trashëguar, lakminë dhe karakteristika të tjera të padëshiruara të shfaqura nga qeniet njerëzore? Problemet mund të përshkruhen nga shkenca, ashtu si mund të përshkruhen faktorët që mund t'i përkeqësojnë ato, *por shkenca nuk mund t'i zgjidhë ato*”⁵⁴.

Shkenca nuk mund të përkufizojë ose shpjegojë parimet etike

Vitet e fundit kanë parë përparime të mëdha në socio-biologji, shkencën bihevioriste dhe lëndë të tjera të lidhura me to, e megjithatë shkenca nuk ka qenë në gjendje të shpjegojë parimet e përfshira në sjelljen njerëzore. Nuk mund të thotë asgjë për dashurinë, drejtësinë, lirinë, bukurinë, mirësinë, gëzimin ose paqen. Çdo njeri i shëndoshë mendërisht pranon ekzistencën dhe autoritetin e ndërgjegjes; qysh nga shek. I para Krishtit, autori romak Publilius Syrus shkroi: “Edhe atje ku nuk ka ligj, ka ndërgjegje”⁵⁵. Megjithatë, shkenca nuk mund të shpjegojë se çfarë është ose përse vepron në atë mënyrë. “*Daily Telegraph*” raportoi se, ndërsa Richard Dawkins pohoi që kishte “një pikëpamje prej qytetari të zakonshëm për mirësinë... të gjitha emocionet e dhura kundër padrejtësisë” dhe “një sens të zhvilluar mirë për të mirën”, ai pranoi se “... si biolog nuk kam një tregim të punuar mirë se nga buron ajo”⁵⁶. Ai vazhdoi të sugjeronte se “e mira” ishte “diçka që shfaqet”, por kjo vështirë se mund të kualifikohet si shpjegim. As pohimi nga dy shkencëtarë të tjerë modernë që “... etika, ashtu siç e kuptojmë ne, është një iluzion me të cilin na kanë mashtruar gjenet tona”⁵⁷ nuk mund të pranohet si shpjegim. Mund të debatohet se evolucioni mund të nxisë instikte të caktuara, por kjo nuk mjafton për të shpjeguar një rregull të qëndrueshëm moral.

Është e pamundur të kërcësh nga atomet tek etika dhe nga molekulat te morali. Nëse jemi thjesht makina të programuara gjenetikisht, ku mund të gjejmë një bazë të besueshme për vlera morale? William Provine, dikur profesor i Shkencave Biologjike në Universitetin Cornell, i cili tha në Konferencën Vjetore të Ateistëve Amerikanë që “të heqësh dorë nga ideja e Perëndisë është mirë për një mendje racionale”, u tregua i sinqertë për pozitën tonë nëse Perëndia përjashtohet: “Nuk ekziston ndonjë ligj moral ose etik i trashëguar, as nuk ka ndonjë parim udhëzues absolut për shoqërinë njerëzore. Universi nuk do t’ia dijë për ne dhe ne nuk kemi kuptim bazë në jetë”⁵⁸. Kjo është recetë për kaos moral dhe social, prandaj shkenca nuk është në gjendje të lëvizë asnjë gisht për të na ndihmuar. Nuk ofron udhëheqje apo vlera morale për të sunduar jetët tona; Karl Popper pohon hapur se “... shkenca nuk mund të japë ndonjë shqiptim për parimet etike”⁵⁹. Shkenca as nuk

mund të na thotë se si të dallojmë të mirën nga e keqja dhe as përse duhet të zgjedhim njëren më shumë se tjetrën. J. B. S. Haldane tha troç: “Shkenca nuk mund të na japë përgjigje për pyetjen ‘Përse duhet të jem i mirë?’”⁶⁰, ndërkohë që gazetarja ateiste Natasha Walter pranoi në programin “*Soul of Britain*” (“Shpirti i Britanisë”) të televizionit BBC: “Nuk besoj se ndonjë shkencëtar do të thoshte se i takonte shkencës të tregonte se çfarë është e drejtë të bësh nga ana etike”⁶¹.

Shkenca nuk është në gjendje t’u japë përgjigje pyetjeve më të thella të jetës

Steve Jones, materialist i betuar, e pranon lirshëm këtë në librin e tij “*The Language of the Genes*” (“Gjuha e gjeneve”): “Shkenca nuk mund t’u përgjigjet pyetjeve që bëjnë filozofët ose fëmijët: përse jemi këtu, çfarë kuptimi ka të jesh gjallë, apo se si duhet të sillemi. Gjenetika nuk ka pothuajse asgjë për të thënë rreth asaj se çfarë na bën ne më shumë se makina të shtyra nga biologjia, çfarë na bën ne njerëzorë. Këto pyetje mund të jenë interesante, por shkencëtarët nuk janë më të kualifikuar se ndonjë tjetër për të komentuar mbi to”⁶². Sër John Eccles, pionier i fitimit të çmimit “Nobel” në kërkimin e trurit, theksoi disa nga këto çështje: “Shkenca nuk mund të shpjegojë ekzistencën e secilit prej nesh si një vetvete e papërsëritshme, as nuk mund t’u përgjigjet pyetjeve të tilla themelore si: kush jam unë; si u ndodha në një vend dhe kohë të caktuar; çfarë ndodh pas vdekjes. Këto janë të gjitha mistere përtej shkencës”⁶³. Psikiatri i shquar Paul Tournier arriti në të njëjtin përfundim: “Sot, kushdo po kërkon përgjigje ndaj atyre problemeve të cilave shkenca nuk u kushton vëmendje, problemi i fatit të tyre, misteri i së keqes, pyetja e vdekjes”⁶⁴.

Këto janë mes pyetjeve më themelore që ne mund të pyesim ndonjëherë dhe, në përgjigje të tyre, shkenca vetëm sa mund të mbledhë supet dhe t’i kalojë ato diku tjetër. Madje edhe filozofi dhe matematikani austriak i njohur botërisht Ludwig Wittgenstein pranoi: “E ndiejmë se, edhe kur gjithë pyetjet e mundshme shkencore kanë marrë përgjigje, problemet e jetës mbeten tërësisht të paprekura”⁶⁵. Eksperti i teorisë së kuantit Erwin Schrödinger tha të njëjtën gjë: “Jam i tronditur që tabloja shkencore e botës rreth meje ka shumë mangësi.

Jep shumë informacion faktik, vendos gjithë eksperiencën tonë në një rend të qëndrueshëm në mënyrë të vazhdueshme, por është tmerrësisht e heshtur për gjithçka, pa përjashtim, që është me të vërtetë pranë zemrës sonë... nuk di asgjë për të bukurën dhe të shëmtuarën, të mirën ose të keqen, Perëndinë dhe përjetësinë. Ndonjëherë shkenca pretendon t'u japë përgjigje pyetjeve të këtyre fushave, por përgjigjet janë shumë shpesh aq qesharake, sa nuk jemi të prirur t'i marrim seriozisht ato”⁶⁶.

Çështja vendimtare

Disa vjet më parë *Encyclopaedia Britannica* (Enciklopedia Britanike) botoi një seri prej pesëdhjetë e katër vëllimesh që kishte bashkuar shkrimet e shumë mendimtarëve të shquar mbi idetë më të rëndësishme që njerëzit kanë studiuar dhe hetuar në shekuj. Temat e zgjedhura përfshinin ligj, shkencë, filozofi dhe histori, por eseja më e gjatë nga të gjitha ishte mbi temën e Perëndisë. Duke iu drejtuar pyetja se përse duhej të ishte kështu, bashkëbotuesi Mortimer Adler, filozof dhe autor amerikan, shkroi: “Rrjedhin më shumë pasoja për mendim dhe veprim nga pohimi ose mohimi i Perëndisë, sesa nga përgjigjja që i jepet ndonjë pyetjeje tjetër”⁶⁷. Adler me siguri që kishte të drejtë, megjithatë shkenca nuk është në gjendje të vendosë për çështjen apo madje dhe të drejtojë pyetjen.

Nuk kemi nevojë të merremi me *shkencizëm* këtu. Ashtu siç e pamë në kapitullin e shkuar, as nuk është e hapur ndaj sugjerimit se Perëndia mund të ekzistojë, ajo “nuk mund të lejojë një këmbë hyjnore te dera”, por t'i afrohesh temës duke e patur tashmë të vendosur përgjigjen ndaj pyetjes, vështirë se kualifikohet si diçka e ndershme, për të mos thënë e arsyeshme. Shqetësimi ynë është me shkencën e vërtetë, e cila varet nga përdorimi i vëzhgimeve apo eksperimenteve të përsëritshme me rezultate të vazhdueshme, të *pamanipuluar në ndonjë mënyrë nga pikëpamja e atyre që i bëjnë ose i drejtojnë ato*. Shkenca po nxjerr në dritë një sasi të mrekullueshme informacioni mahnitës rreth *habisë e madhësisë* së krijimit të Perëndisë dhe mënyrat në të cilat ligjet natyrore funksionojnë, megjithatë ka tri arsye të dukshme se përse biologu

molekular Andrew Miller ka të drejtë të thotë: “Me siguri që nuk është një çështje shkencore të vendosësh nëse ka apo jo një Perëndi”⁶⁸.

Perëndia i zbuluar në Bibël nuk ka përmasa apo karakteristika fizike ose materiale

Me fjalë të tjera, ai nuk ka asnjë nga gjërat që i përkasin materies. Me fjalët e vetë Biblës “Perëndia është Frymë”⁶⁹, domethënë ai nuk ka “pjesë”. Ai është i thjeshtë, në kundërshtim me të qenit i ndërlikuar; i pandashëm aq sa i padukshëm. Kjo do të thotë se, ndërsa shkenca mund të shqyrtojë krijimin, nuk mund të shqyrtojë Krijuesin. Sër Gabriel Horn, kryetar i Zoologjisë në Universitetin e Kembrixhit, nxjerr një përfundim të qartë: “Shkencëtarët kërkojnë të kuptojnë universin... përmes vëzhgimit dhe eksperimentit. Shkenca është një disiplinë empirike. Për aq sa jam në dijeni, asnjë provë empirike nuk është shpikur që të sigurojë evidencë bindëse të refuzojë ekzistencën e Perëndisë”⁷⁰.

Perëndia e tejkalon zonën në të cilën shkenca vepron

Një arsye e dytë dhe që ka lidhje përse shkenca nuk është në gjendje të mos provojë ekzistencën e Perëndisë është se, edhe pse ai depërton në çdo cep të universit, ai është në mënyrë të papërsëritshme transhendent në, mbi dhe përtej kohës, hapësirës e gjithë realitetit të kufizuar. Po e shkruaj këtë ndërsa Rover-at e Eksplorimit të Marsit të NASA-s, Opportunity and Spirit (Mundësi dhe Frymë), po dërgojnë të dhëna të mahnitshme në tokë pas udhëtimesh epike prej 402 325 000 km në “planetin e kuq”. Megjithatë, Perëndia nuk mund të “arrihet” në këtë mënyrë, sado e sofistikuar të jetë teknologjia. Ai është i dallueshëm dhe i ndarë nga i gjithë universi e çdo gjë në të, dhe nuk mund të kufizohet as në hapësirë dhe as mund të matet nga koha. Ai në mënyrë thelbësore është “tjetër” nga krijimi, jashtë realitetit që është i hapur ndaj hetimit shkencor. Bibla ka të regjistruar fjalët e Perëndisë:

Duke qenë se mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja,
dhe as rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia...

Ashtu si qiejt janë më të lartë se toka,
 kështu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja
 dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja⁷¹.

Është e pamundur për ndonjë shkencëtar që vepron plotësisht brenda botës natyrore të bëjë ndonjë zbulim në fushën e mbinatyrores. Sipas fjalëve të Michael Poole: “Nuk mund të matësh bukurinë e një perëndimi dielli me një multimeter. Po kështu nuk ka ndonjë vlerë të pyesësh shkencën nëse ka Perëndi. Shkenca është studimi i botës fizike. *Pyetjet për Perëndinë janë jashtë referimeve të saj*”⁷².

Është e pamundur të vërtetosh një negative universale

Që dikush të vërtetojë mosekzistencën e Perëndisë, do të thotë që ai person ka në zotërim çdo fakt në gjithë realitetin. Edhe sikur një fakt të mos dihej, ekzistenca e Perëndisë nuk mund të përjashtohet, siç mund të jetë edhe fakti në fjalë. Perëndia është qartësisht një fakt i mundshëm, dhe të thuash se shkenca është në gjendje ta përjashtojë atë, atëherë kësaj thënieje do t'i duhet të ndeshet me gjykimin e shëndoshë. Peter Atkins tha për revistën ateiste (me një emër të çuditshëm!) “*Free Inquiry Magazine*”: “Shkenca po përparon drejt njohurisë së plotë duke i lënë pas fetë e tjera”⁷³, por, të sugjerosh se “njohuria e plotë” është e mundur, është diçka naive, ndërsa pjesa tjetër e fjalisë është pa kuptim.

Gjithçka që është shkruar në këtë kapitull nuk duhet të merret si kritikë ndaj shkencës. Ashtu siç e pamë në paragrafët në fillim të tij, shkenca është tregim suksesi dhe që po bëhet më e suksesshme çdo ditë. Është një ushtrim emocionues dhe pasurues, në të cilin mund të gjejmë kënaqësi dhe prej të cilit mund të marrim përfitim të madh. Duhet të falënderojmë Perëndinë për shkencëtarët, edhe për ata që e mohojnë ekzistencën e tij por nuk e nderojmë shkencën, duke shpërfillur kufizimet e saj të vërteta dhe duke pretenduar se mund të shpjegojë çdo gjë.

4.

Evolucioni: provë apo paragjykim?

Në luftën e supozuar mes shkencës dhe krishterimit në 400 vitet e fundit, emrat e dy njerëzve, një italian dhe një anglez, shpesh janë përdorur si artileri e rëndë nga ata në anën e shkencës. Emri i parë tani është katandisur në diçka më tepër se një eko në largësi, prandaj për qëllimet tona të tanishme do të merremi shkurtimisht me çështjen në të cilën ai u përfshi; i dyti ende dëgjohet qartë sa herë që shkenca dhe feja thuhet se janë në konflikt.

Italiani

Galileo Galilei (tani i njohur thjesht si Galileo) u lind në Piza më 1564-ën. Ai fitoi reputacion si filozof dhe fizika, por kontributi i tij në shkencë dhe fe ishte si një astronom, madje disa kanë sugjeruar se ishte “Ati i astronomisë”. Filozofë të Greqisë së Lashtë si Aristoteli dhe Plato-ja mësonin se Toka qëndronte pa lëvizur në qendër të gjithë universit, me gjithë trupat e tjerë qiellorë që rrotulloheshin rreth saj. Kjo ide u mbështet nga astronomi dhe gjeografi egjiptian me influencë i shek. II Claudius Ptolemy dhe nuk u vu në pikëpyetje për 1,400 vjet të tjerë, kur astronomi dhe matematikani polak Nikola Koperniku (Nicolaus

Copernicus) tronditi botën duke këmbëngulur që, brenda një universi edhe më të madh, dielli ishte në qendër të një sistemi planetar masiv, brenda të cilit Toka ishte thjesht një pjesë.

Hyn Galileo. Duke përdorur një teleskop modern që kishte ndërtuar, Galileo vendosi që Koperniku kishte të drejtë dhe, në veprën e tij *“Dialog i dy sistemeve të mëdha të universit”*, i botuar më 1616-n, deklaroi se Toka rrotullohej në akset e saj dhe rreth diellit. Kjo e futi atë në telash të madh me kishën (katolike romake), e cila besonte se kishte monopol mbi gjithë të vërtetën dhe e akuzoi atë se kundërshtonte atë që mësonte Bibla. Edhe pse Galileo protestoi se Bibla kishte për synim “të na mësojë se si shkohet në qiell, jo se si shkon qielli”, dhe se “dy të vërteta nuk mund të kundërshtojnë njëra-tjetrën”, kisha e rriti presionin mbi të. Një prift domenikan predikoi se “gjeometria vjen nga djalli” dhe se “matematika duhet të ndalohet si autore e gjithë herezive”, dhe menjëherë u përhap! Udhëheqës të tjerë fetarë thanë se idetë e Galileos prishnin “gjithë bazën e teologjisë, duke përfshirë planin e Perëndisë për shpëtim. Rasti u ngatërrua me disa politika fetare të pakëndshme dhe, më 1633-shin, Galileon e çuan zvarrë para Inkuizicionit famëkeq, që ishte krijuar për t’u marrë me heretikët. Botimet e gjithë punës së tij u ndaluan dhe vetëm shëndeti i keq bëri që dënimi me vdekje të ndryshonte në burgim të përjetshëm.

Këto janë të vërtetat e një historie që disa njerëz akoma e përdorin si një nxitës se shkenca e ka hequr qafe Perëndinë; se kisha refuzoi të pranonte progres shkencor, por Galileo kishte të drejtë; se shkenca e mundi lehtë krishterimin dhe ka qenë një burim i madh i së vërtetës që atëherë. Megjithatë, që të nxjerrësh këtë përfundim është të luash shpejt dhe të humbasësh me faktet. Së pari, argumenti i Galileos nuk kishte të bënte shumë me kishën sesa me shkencën e shek. XVII në tërësi. Me fjalë të tjera, debati nuk ishte mes Galileos dhe fesë, por ndërmjet shkencëtarëve të cilët nuk pranuan të lëviznin me kohën dhe që besonin se dielli (dhe gjithë trupat e tjerë qiellorë) lëviznin rreth Tokës në njërën anë, dhe nga ana tjetër ata që besonin se brenda një universi më të madh Toka lëvizte rreth diellit. Së dyti, edhe pasi kishte arritur në përfundimet e tij shkencore, Galileo nuk kishte ndonjë përplasje me Biblën ose ekzistencën e Perëndisë. Së treti, të vendosësh se Perëndia nuk ekziston për shkak se teologë të shek. XVII pohonin

në mënyrë të gabuar se Bibla mbështeste një model të metë shkencor të ëndërruar nga filozofë të Greqisë së Lashtë, nuk është as shkencë e mirë, as sens i mirë.

Anglezi

Në vitin 2002, televizioni BBC zhvilloi një pyetësor për të gjetur “Britanikun më të madh nga të gjithë”. Pretendentët përfshinin Uilliam Shekspir (William Shakespeare), sër Uinston Çërcill (Winston Churchill), sër Isak Njuton (Isaac Newton), Oliver Kromuell (Oliver Cromwell) dhe Mbretëreshën Elizabeta I (Elisabeth I), por gazetari televiziv Andrew Marr nuk kishte asnjë dyshim se si duhej të shkonte votimi: “Në gjithë historinë e saj Britania ka vetëm një botëndryshues. Ai quhet Çarls Darvin (Çarls Darwin)”¹. Para se të bëhej votimi, Richard Dawkins shkroi se Darvini radhitej bashkë me Njutonin dhe Shekspirin si “Dhurata më e madhe që Britania i ka dhënë botës” dhe se “... gjenia e tij udhëheqëse qëndron mbi gjithë historinë moderne”².

Heroi i tyre pati një fillim të belbët në jetën e tij si i rritur. Ngaqë nuk arriti të merrte diplomën si student mjekësie dhe duke patur rezultate të ulëta kur kaloi në Letërsi Klasike dhe Matematikë, më në fund u diplomua nga Kembrixhi me një diplomë në teologji. Babai i tij shpresonte se Çarlsi do të hynte në shërbesën e Kishës Anglikane, por djaloshit të ri nuk ia mbante ta bënte këtë dhe, pak a shumë, ishte pa punë kur, më 1831-shin, edhe pse nuk kishte studiuar për këtë, atij iu ofrua një vend si natyralist në anijen vëzhguese HMS Beagle, që do të nisej për lundrim në një ekspeditë pesëvjeçare.

Para se të bëhej pjesë e Beagle-it, duket se edhe Darvini ka patur besimin e pranuar pothuajse universalisht se, si Krijues i gjithë universit, Perëndia kishte bërë të ekzistonin gjithë speciet e ndryshme të gjalla të botës, me karakteristika të pavarura të përshtatura ambientit të tyre.

Por, ndërsa udhëtimi vazhdonte, Darvini vinte në pikëpyetje gjithnjë e më shumë qëndrueshmërinë e specieve dhe, më në fund, u bind se specie krejtësisht të reja mund të ngriheshin nëpërmjet pasardhësve natyrorë nga ato që kishin ekzistuar më parë. Për më tepër se njëzet e pesë vjet pasi Beagle u kthye në Angli, ai punoi mbi dorëshkrimin që do të ishte një vëllim masiv mbi këtë temë. Ky dorëshkrim nuk e

pa asnjëherë dritën e botimit, por, më 1859-n, i shqetësuar nga lajmi se natyralisti dhe biologu britanik Alfred Wallace do të botonte të njëjtat gjëra, ai nxitoi të nxirrte një version kompakt të shënimeve të tij nën titullin “*Origjina e Specieve me anë të përzgjedhjes natyrore*” ose “*Ruajtja e specieve të favorizuara*”, që tani zakonisht i referohet si “*Origjina e specieve*” ose thjesht “*Origjina*”. Të dhënat e para nuk dhanë ndonjë ide se mund të ishte ndonjë gjë tjetër veç një përmbledhje idesh interesante nga një natyralist amator. “*Daily News*” mendonte se Darvini thjesht po përsëriste atë që ishte thënë nga botuesi dhe filozofi natyror skocez Robert Chambers në një libër të botuar pesëmbëdhjetë vjet më parë dhe që në atë kohë ishte botuar për të njëmbëdhjetën herë. Redaktori i “*Quarterly Review*” sugjeroi se, nëse Darvini kërkonte të bëhej i shenjtë, ai duhej ta braktiste “*Originën*” dhe të shkruante një libër mbi pëllumbat! Edhe botuesi i tij John Murray, një gjeolog amator, kishte dyshime serioze nëse duhej të vazhdonte me të, për shkak se ai e konsideronte teorinë kryesore të Darvinit “aq absurde sa të imagjinosh një bashkim të frutshëm midis një mashe dhe një lepu”³.

Një nga kritikët më të kualifikuar të librit ishte Adam Sedgwick, profesor “Woodwardian” i Gjeologjisë në Kolegjin Trinity, Kembrixh, dhe një prej themeluesve të Gjeologjisë si shkencë në Angli. Në një letër drejtuar Darvinit ai shkruante: “E kam lexuar librin tënd më shumë me dhimbje se kënaqësi. Disa pjesë i admirova shumë, pjesë me të cilat qesha sa më dhembën brinjët; pjesët e tjera i lexova me dhimbje absolute, sepse për to mendoj se janë tërësisht të rreme dhe shumë të prapa”⁴.

Një bombë

Dyshuesit shpejt kaluan në radhë të dytë dhe, brenda njëzet vitesh, teza kryesore e librit, edhe pse e përshkruar si asgjë më shumë se “një hipotezë shumë spekulative”⁵, ishte bërë moda e fundit, prandaj, në një përmbledhje të shekullit të njëzetë, revista “*Time*” thoshte: “Darvinizmi mbetet një nga teoritë më të suksesshme shkencore që është shpallur ndonjëherë”⁶. Asnjë teori tjetër rreth jetës në tokë nuk ka bërë më shumë për të ndikuar në mënyrën se si njerëzit mendojnë

për veten dhe për marrëdhëniet e tyre me njerëzit e tjerë dhe me botën rreth tyre. Biologu britanik sër Julian Huxley e quajti atë “idenë më të fuqishme dhe më të plotë që është ngritur ndonjëherë mbi tokë”⁷. Në biografinë e përsosur moderne të Darvinit, James Moore shkruan: “Më shumë se ndonjë mendimtar modern, madje më shumë se Frojdi ose Marksi, (Darvini)... ka transformuar mënyrën se si e shohim veten në këtë planet”⁸. Darwinizmi, në një formë ose në një tjetër, është bërë një filozofi e plotë, e cila pohon të shpjegojë origjinën dhe zhvillimin e gjithçkaje në botë, dhe është kaq e kudondodhur, sa fizikani H. S. Lipton e quan “*Originën*” “ndoshta librin më ndikues që është botuar ndonjëherë”⁹.

Ironikisht, fjala që përdoret më shumë për ta angazhuar teorinë e Darvinit si armë kundër Perëndisë, as që nuk shfaqet në botimin e parë të “*Originës*”. Ajo fjalë është “evolucion”. Biologjia i klasifikon gjallesat sipas ngjashmërive të tyre. Grupimi më i madh bëhet sipas fushës (për shembull eukariotët); ndahen në mbretëri (për shembull kafshët); mbretëritë në tipe (për shembull kordatët); tipet në klasa (për shembull gjitarët); klasat në rende (për shembull primatët) e kështu me radhë deri te familjet, gjinitë dhe, së fundi, speciet, edhe pse për ndarjet e sakta nuk ka një marrëveshje universale. Nga ç’shihet, nuk ka asgjë rreth idesë së evolucionit që duhej të kishte shkaktuar një tronditje në qarqet fetare, filozofike apo shkencore. Tashmë ishte pranuar gjerësisht se variacione të mëdha shfaqeshin *brenda* specieve dhe familjeve ekzistuese me anë të proceseve përsosmërisht natyrore. Edhe pse Darvini e quante këtë model (mikroevolucion) “teorinë e tij të veçantë”, i shtoi pak ose aspak asaj që deri në atë kohë njihej dhe pranohej. Ajo që e ktheu librin e tij në një bombë ishte ajo që tani quhet “teoria e tij e përgjithshme”, *makroevolucioni*.

I shprehur thjesht, makroevolucioni thotë se të gjitha format jetësore të botës janë të lidhura mirë së bashku në një proces natyror evolucion, një specie që del nga një tjetër nëpërmjet mjeteve spontane, të rastësishme, natyrore, pa ndonjë fuqi apo drejtim të jashtëm në një zinxhir të pashkëputur që shkon prapa deri te shkëndija e vetme e jetës që u shfaq në planetin tonë dikur në parahistori. Shkrimtari dhe kërkuesi britanik Ian Taylor e bën të qartë këtë: “Ideja se jeta në tokë e kishte origjinën nga një organizëm njëqelizor dhe pastaj përparoi

më tej në një kompleksitet gjithnjë në rritje për të arritur kulmin të vetë njeriu është gjithçka për të cilën bën fjalë teoria e evolucionit”¹⁰. Tek “*Origjina*” njeriu, në fakt, nuk ishte përfshirë në model, por te “*Prejardhja e njeriut*”, e botuar më 1871-shin, Darvini e pranoi dhe shkroi: “Përfundimi kryesor në të cilin kam mbërritur... është se njeriu ka prejardhje nga ndonjë formë më pak e organizuar”¹¹. Për të nënvizuar atë që donte të thoshte, ai shtoi se njerëzimi ka mbijetuar “jo sipas ndonjë plani të përcaktuar, por si rezultat i rastësisë që vepron mes krijesave të panumërta nëpërmjet tendencës pa kufi të natyrës drejt ndryshueshmërisë”¹².

E gjithë paketa merret si e mirëqenë nga miliona të panumërta njerëzish dhe një pjesë e madhe e mendimit akademik sundohet nga hipoteza se i gjithë fenomeni i gjallë duhet të shihet në terma evolucionarë. Më 1996, gjenetisti i shquar H. J. Muller hodhi në qarkullim një manifest të firmosur nga 177 biologë amerikanë që pohonin se evolucioni organik i gjithë gjallesave, përfshirë edhe njeriun, nga format jetësore primitive, madje edhe nga materialet jo të gjalla, është fakt i shkencës po aq i vërtetuar sa edhe fakti që toka është e rumbullakët”¹³. Biologu Ernst Mayr, profesor Emeritus në Universitetin e Harvardit shkruan: “Qysh nga Darvini, çdo njeri është dakord se njeriu vjen nga majmuni. Sot, nuk ka asgjë të tillë si teoria e evolucionit. Është fakt i evolucionit”¹⁴. Richard Dawkins e mbështet këtë verdikt me një gjest tipik agresiv: “Është e sigurt të thuash se, nëse takon dikë që nuk beson në evolucion, ai njeri është i paditur, i marrë ose i çmendur (ose i poshtër, por më mirë të mos e mendoj kështu)”¹⁵.

Sot, ideja e Darvinit mbizotëron gjithë sfondin filozofik, shkencor dhe kulturor, e megjithatë një prej efekteve të saj më të mëdha dhe më radikale është fetar. Tek “*Origjina*”, Darvini e përmendi pak Perëndinë, por Adam Sedgwick pa përtej këtyre dhe parashikoi se ku të drejtonte libri: “Që nga fillimi deri në fund është një gjellë materializmi absolut e gatuar me zgjuarsia dhe e servirur... dhe përse bëhet kjo? Për asnjë arsye tjetër të fortë, jam i sigurt, përveçse të na bëjë të pavarur nga një Krijues”¹⁶. Në një konferencë të mbajtur më 1959-n, për të kujtuar 100 vjetorin e botimit të parë të “*Origjinës*”, sër Julian Huxley tha: “Arritja e vërtetë e Darvinit ishte të hiqte idenë e Perëndisë si Krijues i

organizmave nga sfera e diskutimit racional”¹⁷. Kohët e fundit, e njëjta pikë ka dalë edhe nga ata që kanë studiuar veprën e Darvinit. Biologu molekular dhe fizikani australian Michael Denton shkroi: “Rënia e besimit fetar i atribuohet më shumë përhapjes dhe mbështetjes së versionit darvinian të evolucionit nga komuniteti intelektual dhe shkencor, sesa ndonjë faktori tjetër”¹⁸. Që atëherë, Richard Dawkins ka thënë: “Edhe pse ateizmi mund të ketë qenë logjikisht i pranueshëm para Darvinit, ai (Darvini) e bëri të mundur të ishte ateist intelektualisht i plotësuar”¹⁹, ndërsa në ditën e fundit të vitit 1999 revista “*TIME*” bëri këtë pohim dramatik: “Çarls Darvini nuk donte ta vriste Perëndinë. Por e vrau”²⁰.

Nga kopshti zoologjik te ty?

Këto pohime që tingëllojnë mbresëlënëse duhet të ballafaqohen, sepse shumë varen nga vërtetësia apo falsiteti i tyre. Ashtu siç e kemi parë, modeli darvinian i evolucionit, duke përfshirë gjithë organizmat e gjallë, fillon me shkëndijën e parë të jetës, por do të përpiqemi ta shpaketojmë atë “nga jashtë brenda”, duke filluar me qeniet njerëzore. Si u bëmë ne këta që jemi? Ideja se paraardhësit tanë të afërt ishin gjitarë të ngjashëm me majmunët është kaq e përhapur, saqë merret si e mirëqenë. Më 1994, Rrjeti i Arteve dhe Dëfrimit dha një program televiziv në Shtetet e Bashkuara me titullin “*Njeriu majmun: historia e evolucionit njerëzor*”. Programi drejtohej nga prezantuesi i njohur Walter Cronkite, i cili e shprehu këtë nocion të njohur në një mënyrë reale: “Po të ktheheni mbrapa në kohë, ne dhe shimpazetë kemi një paraardhës të përbashkët. Babai i babait të babait të babait të babait tim, duke shkuar mbrapa ndoshta gjysmë milion breza, rreth pesë milionë vjet, ishte një majmun”²¹. Me siguri mund të supozojmë se miliona shikues i pranuan fjalët e Cronkite me të njëjtin besim si besuan njoftimin dramatik tridhjetë e një vjet më parë se presidenti John F. Kennedy ishte vrarë në Dallas, por, në këtë rast, ai nuk ishte në gjendje të jepte as një copë evidence për ta mbështetur pohimin.

Askush nuk e mohon se majmunët dhe njerëzit kanë disa karakteristika fizike të ngjashme dhe kanë ADN të njëjtë, por kjo qëndron larg të vërtetuarit të një lidhjeje të drejtpërdrejtë mes dy specieve. Ka

një hendek të madh ndërmjet ngjashmërive dhe marrëdhënies së drejtpërdrejtë. Hemoglobina, molekula që bart oksigjenin në qelizat e kuqe të gjakut, gjendet jo vetëm te njerëzit, por gjithashtu te krimbat e tokës, peshqit yje, molusqet, në disa insekte dhe bimë, madje edhe në disa bakterie. A do të thotë edhe kjo se ata janë paraardhësit tanë të drejtpërdrejtë? Disa nga të dhënat në këtë fushë më shumë të çorientojnë sesa të sigurojnë. Kur shkencëtarët studiuin hemoglobinën e krokodilëve, nepërkave dhe pulave, zbuluan se krokodilët kishin lidhje më të ngushta me pulat sesa me bashkëzvarranikët e tyre¹, ndërkohë që në një provë tjetër një proteinë identike u gjet në muret qelizore si të gamiljeve ashtu edhe të peshkaqenëve mëndeshë³.

Modeli që e shikon *Homo Sapiens*-in si lavdinë kurorëzuese të evolucionit, shpesh mbështetet nga diagrame dhe skica që tregojnë se si ne dolëm nga një zinxhir krijesash të përkuluara dhe me lesh. Këto impresione të artistëve shpesh bëhen në mënyrë të shkëlqyer dhe në mënyrë sipërfaqësore të besueshme, por ato janë kryesisht rezultat i punës imagjinare të mbështetur në hamendësime evolucionare dhe herë pas here mesazhi i tyre është diskretituar nga zbulimet shkencore. Kjo ka qenë veçanërisht e vërtetë në fushën e paleontologjisë, studimi i fosileve, që e ka bërë të paqëndrueshëm skenarin “nga majmuni te njeriu”. Këtu po japim pesë nga shumë shembuj të njohur që mund të citohen:

1. Më 1857, disa punëtorë guroreje gjetën një skelet të pjesshëm në një guvë afër Dusseldorfit në Gjermani. Dukej se kockat i përkisnin një njeriu, por, kur mbetje të ngjashme u gjendën në Evropë, Afrikë dhe Azi, atyre iu dha emri i përbashkët Neandertal dhe u tha se ishte paranjerëzor. Artistë dhe të tjerë iu futën punës dhe prodhuan modele gjysmë të ngritura, me kraharor të rumbullakët, me këmbë të shkurtra, me kreshta të mëdha vetullash dhe nofullat e poshtme të forta. Paketa e përfunduar u paraqit atëherë si evidencë e një lidhjeje ndërmjet njerëzve dhe një krijese të drejtpërdrejtë primitive.

Megjithatë, ideja pësoi një goditje vdekjeprurëse kur një skelet neandertali, i varrosur në një armaturë relativisht moderne, u gjend në një varr në Poloni më 1908-n²⁴. Sot, evidenda e ADN-

së tregon se Neandertali ishte mbi të gjitha “anëtar i mirëfilltë i familjes njerëzore”²⁵, dhe një libër i kohëve të fundit sugjeron: “Nëse një Neandertal do të vishej me xhinse, një bluzë dhe të shkonte në një ndeshje, do të kishte të ngjarë që unë dhe ti të mos e vinim re”²⁶. Ideja se Neandertali është një “lidhje që mungon” ka kohë që pothuajse është hequr nga tekstet e librave.

2. Më 1912, Çarls Dawson, një gjuajtës amator fosilesh, i çoi një koleksion kockash, dhëmbësh dhe veglash primitive një shoku në Muzeun Britanik, duke pretenduar se i kishte gjetur në një zallishte afër Piltdown në Sussex. Shkencëtarët i deklaruan mbetjet si të ishin 500,000-vjeçare dhe i ashtuquajtur i njeriu Piltdown u reklamua si “lidhja sensacionale që mungonte”²⁷, dhe tre shkencëtarët përgjegjës që e mbështetën vërtetësinë e tij morën titullin kalorës për punën e tyre. Por, më 1953-shin, heroi i tyre doli të ishte një mashtim i përbërë nga kafkë njerëzore, nofulla e poshtme e një orangutangu dhe dhëmbët e një shimpazeje.

3. Më 1922, një dhëmb i vetëm i nxjerrë nga toka në Nebraska në mënyrë entuziaste u pohua se ishte nga një tip i hershëm i Pitekanthrop (njeri-majmun) që jetoi ndërmjet 1.7 dhe 5.5 milionë vjet më parë. “*Illustrated London News*” botoi një artikull dyfaqësh duke trumpetuar njeriun Nebraska si një lidhje e rëndësishme në zinxhirin “nga majmuni te njeriu”, por gjashtë vjet më vonë u zbulua se dhëmbi kishte ardhur nga një derr i egër. Pretendimi për njeriun Nebraska po zhduket ashtu siç edhe derri i egër, por së bashku janë një ilustrim i mirë për komentin e bërë nga profesor Bolton Davidheiser i Universitetit Johns Hopkins: “Publiku joshkencor ka besim të madh në atë që një paleontolog mund të bëjë me një kockë të vetme”²⁸.

4. Më 1959, paleontologu i njohur Louis Leakey dhe gruaja e tij Mary nxorën një kafkë interesante nga toka në Afrikën Lindore. I quajtur “njeriu arrëthyes”, për shkak të nofullës jashtëzakonisht të madhe, në fillim u datua 1.75 milionë vjeçare, duke e bërë atë fosilin njerëzor më të vjetrin që është gjetur ndonjëherë, por ky pohim u përmbys kur kocka të tjera të gjetura akoma më poshtë u datuan vetëm mbi 10,000-vjeçare. Më në fund, Leakey

e tërhoqi pohimin e tij ekstravagant dhe pranoi që zbulimi i tij ishte një prej shumë *Australopithecus africanus*, që tani besohet se janë majmunë afrikanë të zhdukur.

5. Më 1974, antropologu Donald Johanson gjeti një skelet të vogël në Luginën Great Rift (E Çara e Madhe) në Etiopi. I njohur me nofkën “Lusi”, u datua tre milionë vjeçare dhe u bë një sensacion kur u njoftua në Simpoziumin Nobel mbi Njeriun e Hershëm më 1978-n. Lusi u mbajt si njeriu i parë që ecte drejt dhe si një lidhje e padyshimtë midis njerëzve dhe majmunëve, por, në një sesion pyetje-përgjigje në Universitetin e Misurit, më 1996-n, Johanson pranoi se kyçi i gjurit, i cituar si provë që Lusi ecte drejt, ishte gjetur më shumë se 3 km larg dhe 70 m më thellë në shtresën e tokës! Richard Leakey, drejtor i Muzeut Kombëtar të Kenias vendosi që “... evidenca për transformimin e pohuar nga majmuni te njeriu nuk është aspak bindëse” dhe që “... ka shumë të ngjarë që Lusi nuk ishte më shumë se një varietet i shimpazeve pigmé”²⁹. Më në fund, Johanson e tërhoqi pohimin e tij original dhe doli në përfundimin që Lusi, mbi të gjitha, nuk kishte lidhje me njerëzit³⁰.

Këto janë vetëm disa nga rastet e profilit të lartë të dhëna si evidenca që *Homo Sapiens* u zhvillua nga paraardhës të ngjashëm me majmunët, e megjithatë, bashkë me qindra përpjekje të tjera, nuk ia kanë arritur qëllimit. Dr. D. V. Ager, president i Shoqatës Gjeologjike Britanike jep këtë sqarim të rëndësishëm: “Duhet të jetë domethënëse që pothuajse të gjitha historitë që mësova kur isha student tani janë zbuluar... Ajo që del në sipërfaqe është që, nëse i shqyrtojmë të dhënat e fosileve me imtësi, sipas rendit ose sipas specieve, zbulojmë, gjithnjë e më shumë, jo evolucion gradual, por shpërthimin e menjëhershëm të një grupi në kurriz të tjetrit”³¹.

Evolucioni njerëzor nga paraardhës të ngjashëm me majmunin jepet mësim nëpër shkolla në mënyrë kaq këmbëngulëse, saqë është bërë një siguri në shoqërinë e gjerë. Me sa duket, çdo program radioje e televizioni që merret me shkencat natyrore e merr si të vërtetë dhe, nëse ndokush e ngre zërin kundër tij, ka të ngjarë që më e pakta të trajtohet si një i çmendur. Megjithatë, çdo protestues shoqërohet nga

autoritete në këtë fushë. Paleontologu i shquar David Pilbeam, profesor i Antropologjisë në Universitetin e Harvardit, pranon hapur: “Ndoshta breza studentësh të evolucionit njerëzor, duke përfshirë edhe veten time, janë endur nëpër errësirë... të dhënat tona janë shumë të rralla, të paqëndrueshme për të, që të jetë në gjendje t’i japë formë teorive tona. Përkundrazi, teoritë janë më shumë pohime rreth nesh dhe ideologjisë (sonë), sesa për të shkuarën”³². Diku tjetër, ai flet më specifikisht: “Nuk ka ndonjë shteg të qartë dhe të pashmangshëm që të çon nga majmuni te njeriu”³³. Pasi kishte kaluar njëzet e pesë vjet duke kërkuar të dhënat e fosileve, shkollari amerikan Marvin Lubenow e hapte librin e tij *“Bones of Contention”* (“Molla e sherrit”) me fjalët: “Të dhënat për fosilet njerëzore e mbështetin shumë konceptin e Krijimit të Veçantë. Nga ana tjetër, të dhënat e fosileve janë kaq në kundërshtim me evolucionin njerëzor, sa e nxjerrin efektivisht të gënjeshtërt idenë se njerëzit evoluuan”³⁴. Më vonë, ai shtoi: “Evolucioni njerëzor, në mënyrë të supozuar, ndodhi në të shkuarën gjatë periudhave të mëdha kohore. Evolucionistët janë të gatshëm të pranojnë që proceset evolucionare veprojnë kaq ngadalë, saqë nuk janë të vëzhgueshme gjatë jetës së individit apo madje edhe gjatë jetëve të njëpasnjëshme të qindra brezave. Me fjalë të tjera, *nuk ka vëzhgime ose eksperimente të drejtëpërdrejta që mund të konfirmojnë evolucionin njerëzor*”³⁵.

Në gjithë këtë që thamë, duhet të kuptojmë se çështja nuk qëndron te vetë fosilet, por tek interpretimi që u bëhet atyre. Evolucionisti i vendosur e vendos teorinë e tij para fakteve dhe shkon te të dhënat e fosileve i sunduar nga teoria e tij duke kërkuar që ta konfirmojë atë nëpërmjet atyre që gjen. Më 1991, një zëdhënës për Shoqatën Amerikane për Përparimin e Shkencës shkoi deri atje sa të thoshte se 100 milionë fosile, të identifikuara dhe të datuara, “përbëjnë 100 milionë fakte që e vërtetojnë evolucionin përtej çdo dyshimi çfarëdo”³⁶. Problemi me këtë pohim është se të dhënat e fosileve janë vlerësuar mbi supozimin se makroevolucioni është një fakt i qëndrueshëm. Por ky është një shembull i qartë i arsyetimit rrethor që e bën një profesor të antropologjisë të thotë: “Problemi me shumë antropologë është se ata kërkojnë kaq shumë të gjejnë një kockë njerëzore, saqë çdo mbetje kockore bëhet një kockë njerëzore”³⁷. David Pilbeam rrëfen: “Unë di që, të paktën në paleoantropologji, të dhënat janë ende

kaq të pakta, sa teoria ndikon shumë në interpretime. Teoritë, në të shkuarën, kanë reflektuar qartë ideologjitë tona të kohës në vend të të dhënave aktuale”³⁸. Po t’iu mbahemi fakteve, paleontologjia na tregon se, kurdoherë që gjejmë fosile njerëzore, dhe me mijëra janë gjetur, ato janë plotësisht njerëzore, pa ndonjë shenjë tranzicioni nga një krijesë më primitive. Pas shumë vitesh kërkimi në këtë fushë të veçantë, anatomisti i shquar Lord Zuckeman, kryekëshilltari shkencor për qeverinë britanike, doli në përfundimin që, “... nëse njeriu evoluoi nga një krijesë e ngjashme me majmunin, ai e bëri këtë pa lënë ndonjë gjurmë të atij evolucioni në të dhënat e fosileve”³⁹. Nuk ka majmunë në historinë njerëzore.

Larg prej asaj që evidenca e fosileve na tregon, ata që këmbëngulin se ne e kemi prejardhjen nga paraardhës të ngjashëm me majmunin përplasen me një bombardim pyetjesh. Nëse jemi produkt i rastësisë së verbër e të pamend, si mund të pohojmë se kemi dinjitet më të lartë se gjarpërinjtë ose leshterikët, bimësia apo viruset? Përse jemi në mënyrë të pashmangshme të vetëndërgjegjshëm? Përse duhet të mendojmë se jetët tona kanë ndonjë kuptim ose qëllim? Përse presim që gjërat të kenë kuptim? Çfarë i motivon synimet dhe aspiratat tona? Si mund të kërkojmë të drejta më të mëdha se një dem apo bakterie? Përse këmbëngulim që të jetojmë brenda një kornize morali, madje edhe atëherë kur ndonjëherë e modifikojmë atë në avantazhin tonë? Nëse nuk jemi asgjë më tepër se qeska mbështjellëse elementesh biologjike të sunduar nga ligjet e fizikës, si mund të shpjegojmë ekzistencën dhe autoritetin e ndërgjegjes? Nga e dimë se ka një dallim radikal ndërmjet së mirës dhe së keqes? Si e fituam sensin e humorit ose interesin për estetikë? Përse duket se kemi një dimension të pashkatërrueshëm shpirtëror? Përse mendojmë (më shpesh sesa e pranojmë) për vdekjen? A ka ndonjë përgjigje evolucionare për këto pyetje, ndonjë aksident kimik apo biologjik që mund të shpjegojë ekzistencën e tyre?

Në një kapitull më parë vërejtëm se shkollari humanist Edmund Leach shkoi deri atje sa të pohonte: “Nuk ka ndarje të prerë midis asaj që është njerëzore dhe asaj që është mekanike”, por ky ishte një rast i qartë i shtrembërimit të fakteve për t’iu përshtatur filozofisë. Ndarja midis njeriut dhe gjithë realitetit tjetër material është jashtëzakonisht i madh. Nuk kemi paraardhës evolucionarë.

Të meta fatale

Teoria e përgjithshme e evolucionit thotë se jemi produktet më të fundit të një “Zinxhiri të Madh të të Qenit”, me materie të pajetë, pastaj protozoarët (organizma njëqelizore mikroskopike), jovetëbrorët metazoarë (organizma shumëqelizore pa shtyllë kurrizore), peshqit vetëbrorë, amfibët, zvarranikët, zogjtë, katërkëmbëshit me gëzof dhe majmunët që formojnë “pemën tonë familjare”. Nuk ka hapësirë këtu që të shohim me radhë secilin prej tyre, por ka të paktën pesë faktorë që zbulojnë të meta të mëdha në këtë skenar të pranuar gjerësisht.

I. Lidhjet që mungojnë

E para është fakti që, ashtu si në rastin e idesë “nga majmuni te njeriu”, *“lidhjet që mungojnë” ende mungojnë!* I shqetësuar për mungesën e lidhjeve të ngushta ndërmjet specieve, Darvini e pranoi se ky ishte “kundërshtimi më i dukshëm dhe serioz që mund të nxitet kundër teorisë së tij”, por vendosi që kjo mund të shpjegohej me anë të “jopërsosmërisë ekstreme të të dhënave gjeologjike”⁴⁰. Tani jemi në një pozicion shumë të ndryshëm, me një numër shumë më të madh fosilesh në dispozicionin tonë, megjithatë David Raup, kurator i Gjeologjisë në Muzeun e Historisë Natyrore në Çikago, pohon: “Situata nuk ka ndryshuar shumë. Të dhënat e evolucionit janë ende në mënyrë të habitshme të ndryshueshme dhe është ironike që tani kemi edhe më pak shembuj të tranzicionit evolucionar, sesa kishim në kohën e Darvinit... Problemi i Darvinit është thelluar më shumë”⁴¹. Stephen J. Gould, profesor i Gjeologjisë dhe Paleontologjisë në Universitetin e Harvardit, nuk heziton kur thotë se gjendja jashtëzakonisht e rrallë e formave tranzicionale në të dhënat e fosileve “vazhdon të jetë sekreti tregtar i paleontologjisë”⁴². Niles Eldrege, moderator i Muzeut Amerikan të Historisë Natyrore, pohon komplotin: “Ne, paleontologët, kemi thënë se historia e jetës mbështet... historinë e ndryshimit gradual adaptues... edhe duke e ditur që nuk e mbështet atë”⁴³. Përderisa evidenca nga paleontologjia është e vetmja që pohon se paraqet provën për historinë e evolucionit, në vend të rezultateve dhe mekanizmave të tij, pranimi i Raup-it është veçanërisht i rëndësishëm,

ndërkohë që Darvini shpresonte që zbulimi i fosileve të mëtejshme do të zbulonte lidhjet që mungonin, të nevojshme për të pohuar teorinë e tij. Edhe pse tani kemi një numër të mahnitshëm fosileshe për të shqyrtuar, përfundimi i vetë Darvinit, që “asnjë ndryshim i specieve në një tjetër nuk ndodhet në të dhënat... nuk mund të vërtetojmë që një specie e veçantë ka ndryshuar”⁴⁴, mbetet i drejtë, edhe pse në kontekstin modern ndoshta duhet ta zëvendësojmë fjalën e tij “specie” me një grupim disi më të gjerë.

2. “Gabime shtypi”

E meta e dytë ka të bëjë me mekanizmin që thuhet se vë në lëvizje evolucionin. Darvini mbështetej shumë në atë që e quante “përzgjedhja natyrore”, e cila, në fillim fare, thoshte se organizmat janë pre e njëra-tjetrës, në mënyrë që të mbijetojnë dhe në të njëjtën kohë zhvillojnë karakteristika të reja që të përshtaten me ambientin. Kur këto karakteristika bëhen tipare të përhershme, një specie e re shfaqet në atë që Darvini e quante “progres drejt përsosmërisë”. Kjo të çon në konceptin e “mbijetesës së më të fortit”, shprehje që Darvini e mori nga “*Principles of Biology*” (“Parimet e Biologjisë”) të filozofit britanik Herbert Spencer, i botuar më 1865-n dhe i përfshirë tek “*Origjina*” që nga botimi i gjashtë e në vazhdim.

Por aty nga vitet 1930 u bë e qartë për biologët se vetëm përzgjedhja natyrore nuk mund të prodhonte kurrë makroevolucion organik. Mund të sigurojë një model të mirë për ndryshime *brenda* specieve dhe familjeve, por jo për krijimin e të rejave. Makroevolucioni kishte nevojë për një përbërës të ri; biologët propozuan “teorinë sintetike”, e quajtur kështu sepse kombinonte darvinizmin klasik dhe idetë gjenetike moderne. Teoria përqendrohej te gjenet dhe propozonte se, nëse gjatë një periudhe kohore të madhe këto i nënshtroheshin ndryshimeve radikale të trashëgueshme, mutacioneve, natyra mund të përdorte ato më të përshtatshmet për zhvillim të ardhshëm, duke çuar më në fund në krijimin e rendeve të reja të kafshëve. *Të tilla transformime nuk janë vëzhguar asnjëherë*. Përkundrazi, ato nënkuptohen në bazë të argumentit qarkullues se sipas teorisë së evolucionit në këtë mënyrë linden rende të reja.

Megjithatë, ky model i ri, nën emrin e përgjithshëm të neodarvinizmit, ka pushtuar tërësisht botën, saqë Sylvia Baker, një shkrintare e respektuar në këtë fushë, shkon deri atje sa të thojë: “Teoria moderne e evolucionit... ose qëndron, ose bie në çështjen e mutacioneve”⁴⁵.

Nëse puna qëndron kështu, teoria është e paqëndrueshme! Në radhë të parë, mutacionet natyrale ndodhin *jashtëzakonisht* rrallë, diçka e tillë si njëherë në dhjetë milionë shumëfishime të një molekule ADN-je⁴⁶. Edhe një evolucionist besnik si sir Julian Huxley thotë se gjasat që mutacione të favorshme të ndodhin në një lloj, përmes rastësisë së pastër, janë kaq të pakta, saqë do të duheshin tri volume me format të madh me rreth 500 faqe për t’i shtypur. S’ka dyshim që ai shton: “Askush nuk do të vinte bast mbi diçka që është kaq e pamundur të ndodhë”⁴⁷.

Së dyti, 999 nga 1,000 mutacione janë të dëmshme, të cilat më shumë e dobësojnë ose shkatërrojnë organizmin në fjalë, sesa krijojnë ndryshimet që japin avantazh të nevojshëm për evolucion. Në fakt, organizmat nga bakteriet deri te njerëzit kanë sisteme rregulluese për ADN jopërkuese, që përbëhen nga më shumë se një duzinë proteinash të veçuara, të cilat skanojnë gjenomin (sasinë e plotë të materialit gjenetik në një palë kromozomesh individuale) për “gabime” (mutacione) ose dëmtim të shkaktuar nga faktorë mjedisorë që ose i riparojnë ato, ose vënë në shënjestër qelizën për ta lëvizur. Të tilla mekanizma nuk kanë mjete për të qenë përzgjedhës, prandaj do të veprojnë me efikasitet të barabartë për të nxjerrë jashtë loje si mutacionet e dëmshme ashtu edhe ato që shumë rrallë janë “të dobishme”. Të ngjall kureshtjen që një proces kaq kritik për evolucionin duhet të prodhojë në masë të madhe ndryshime të dëmshme e pastaj të ketë rolin e vet në një mekanizëm parandalues biologjik kompleks.

Duke vënë re që një mutacion është një ndryshim rastësor në një mesazh molekular (ADN), profesori kanadez i mjekësisë Magnus Verbrugge e përngjason atë me një gabim shtypi dhe shton: “Gabimet e shtypit rrallë e përmirësojnë cilësinë e një mesazhi të shkruar; nëse ka shumë, ato edhe mund ta shkatërrojnë mesazhin që përmbahet në të”⁴⁸.

Phillip Johnson përdor një ilustrim tjetër për të dhënë të njëjtin shpjegim: “Të supozosh se një ngjarje kaq e rastësishme mund të

rindërtojë sikur edhe një organ të vetëm kompleks si mëlçia ose veshka, është po aq e arsyeshme sa të supozosh se një orë e përmirësuar mund të skicohet duke e përplasur të vjetrën në mur”⁴⁹.

Së treti, koha e cila nevojitet që mutacionet të nisin një specie të re thjesht nuk është e disponueshme. Biologu francez Rémy Chauvin, profesor në Laboratorin e Sociologjisë së Kafshëve në Universitetin René Descartes në Paris, thotë: “Përderisa ato forma të jetës së kafshëve, të cilat pësojnë mutacione shumë shpejt, kanë mbetur të njëjta gjatë dhjetë milionë brezash, *mutacionet nuk mund të konsiderohen motori i evolucionit*”. Në mënyrë domethënëse, ai vazhdon: “Kjo ka të bëjë me gjykimin e shëndoshë, por, nëse fuqia e paragjykimit futet brenda shkencës si kudo, gjykimi i shëndoshë e humbet rastin në gjyq”⁵⁰.

Biokimisti Ernest Chain, bashkëfitues i çmimit “Nobel” të vitit 1945 për zhvillimin e penicilinës, e hodhi poshtë po njësoj këtë: “Të pohosh se zhvillimi dhe mbijetesja e më të fortit është tërësisht një rrjedhojë e mutacioneve të rastësishme, më duket një hipotezë e pambështetur në ndonjë evidencë dhe e papajtueshme me faktet. Këto teori klasike evolucionare janë një thjeshtësim i tepruar i një mase pafundësisht komplekse dhe të ndërlikuar faktesh, prandaj habitem që janë kapërdirë pa u kritikuar në mënyrë kaq të gatshme dhe për një kohë kaq të gjatë nga shumë shkencëtarë pa asnjë murmurimë proteste”⁵¹.

3. E paplotë do të thotë e padobishme

Një e metë e tretë në modelin e makroevolucionit është se çdo organ i ri funksionues duhet të jetë një njësi e plotë operuese para se t'i sjellë ndonjë përfitim organizmit në fjalë. Kjo përplaslet drejtpërdrejt me pohimin e evolucionit se mutacioni ndodh në rritje të vogla për një periudhë të madhe kohe. Syri njerëzor siguron një ilustrim të mirë. Ai shoqërohet nga shënjestrim automatik, fokusim e përshtatje hapjeje dhe retina e tij e vogël ka 130 milionë qeliza receptore, 124 milionë prej të cilave kanë formën e një shkopi dhe bëjnë dallim ndërmjet dritës dhe errësirës dhe 6 milionë prej të cilave kanë formën e konit dhe mund të identifikojnë deri në tetë milionë variacione ngjyrash. A është e mundur që të gjitha këto tipare filluan të ekzistonin nëpërmjet ekuivalentit gjenetik me gabimet e shtypit gjatë miliona vjetëve? Ata

që këmbëngulin se kështu është (dhe Darvini kështu mendonte, pavarësisht se pranonte se që përzgjedhja natyrore të formonte syrin ishte “absurde sa më s’ka”)⁵², me siguri që kanë humbur faktin që një sy i pjesshëm është i padobishëm. Pesë për qindshi i një syri nuk do të japë pesë për qind shikim, nuk do të jepte aspak shikim. Për më tepër, edhe sikur të ishin të gjithë përbërësit fizikë të një syri, ata nuk do të arrinin asgjë, nëse nuk do të “lidheshin” në mënyrë të saktë me një kompleks të mahnitshëm qelizash nervore në tru. Nuk ka dyshim pse dikush ka sugjeruar: “Shqyrtimi i syrit është kurë për ateizmin”⁵³.

4. Kompleksitet i pareduktueshëm

Një e metë e katërt ka lidhje me të tretën dhe ka të bëjë me kompleksitet të pareduktueshëm. Darvini shkroi dikur: “Po të demonstrohej se ekzistonte ndonjë organ kompleks i cili nuk mund të formohej me anë të modifikimeve të shumta, të njëpasnjëshme dhe të lehta, *teoria ime me siguri do të binte. Por nuk mund ta gjej një rast të tillë*”⁵⁴. Ai e tha këtë duke mos ditur asgjë për mrekullitë e zbuluara nga mikrobiologjia moderne. Për Darwinin dhe bashkëkohësit e tij qeliza biologjike nuk ishte asgjë veç një “pikëz” e mistershme protoplazme, për të cilën ata nuk kishin instrumenta që ta shqyrtonin me hollësi. Mikrobiologjia e ka hapur tani këtë “kuti të zezë” paditurie dhe ka zbuluar një botë kompleksiteti që të lë pa mend; ne dimë, për shembull, se edhe qelizat më të thjeshta të bakterieve mund të sintetizojnë deri në 6 000 përbërës në një shkallë prej një milionë reagimesh në sekondë⁵⁵.

Në librin e tij më të shitur “*Darwin’s Black Box*” (“Kutia e zezë e Darvinit”), i botuar për herë të parë më 1996-n, Michael Behe, profesor i Shkencave Biologjike në Universitetin Lehigh, në Pensilvani, në mënyrë domethënëse shkon më tej dhe identifikon shembuj të shumtë kompleksiteti të pareduktueshëm që nuk mund të kenë evoluar. Ashtu siç e shpjegon Behe, diçka është komplekse në mënyrë të pareduktueshme “nëse përbëhet nga disa pjesë dhe secila pjesë është jashtëzakonisht e domosdoshme në mënyrë që struktura të funksionojë”⁵⁶. Si një shembull të shkëlqyer ai citon mpiksjen e gjakut, e cila përfshin një sistem shumë kompleks dhe të ndërthurur në mënyrë të ndërlikuar, të përbërë nga një numër pjesësh të pavarura proteine.

Ai tregon se në rastin e një ndërhyrjeje (një prerjeje) një proteinë që gjendet vetëm në pjesën e jashtme të qelizave që nuk kanë kontakt me gjakun sillet lokalisht në rrjedhjen e gjakut dhe shkakton një kaskadë ngjarjesh të renditura, duke përfshirë njëzet e tetë proteina dhe enzima të veçuara, që rezultojnë në mpiksje të lokalizuar dhe vulosjen e plagës.

Çështja më e rëndësishme në gjithë procesin, të cilin Behe e përshkruan në hollësi, është që kaskada formohet në mënyrë të veçantë me një numër të përcaktuar molekulash ndërvepruese të njohura. Me fjalë të tjera, është një sistem kompleks në mënyrë të pareduktueshëm, pikërisht ajo lloj gjëje që Darvini pranoi se do të shkatërronte gjithë sistemin e tij evolucionar. Nëse përzgjedhja natyrore do të prodhonte një sistem kompleks në mënyrë të pareduktueshme plotësisht funksionues, duhet ta bëjë njëherësh. Megjithatë, Behe thotë se, edhe një pjesë shumë e vogël e një sistemi të tillë që bashkohet nga mutacioni gjenetik “nuk do të pritej të ndodhte, edhe sikur jeta prej dhjetë miliardë vjetësh e universit të ngjeshej në një sekondë të vetme dhe të rijetonte çdo sekondë për dhjetë miliardë vjet”⁵⁷.

5. Gjëgjëza kambriane

Një e metë e pestë është që evolucionizmi nuk ka përgjigje për të ashtuquajturin “Shpërthimi Kambrian”. Gjatë 150 vjetëve të fundit, pjesa më e madhe e shkencëtarëve kanë riparë moshën e supozuar të planetit tonë nga pak mijëra vjet në rreth 4,600 milionë vjet. Nga përdorimi i kësaj peshoreje kohore është gjetur se një mungesë evidencash për format jetësore para 600 milionë vjetësh më parë, papritur i hap rrugë një numri të madh fosilesh që përfaqësojnë afërsisht çdo grup organizmash të gjallë sot dhe pa ndonjë shenjë të paraardhësve evolucionarë. Përt’i përkeqësuar gjërat për evolucionistët, fosile të formave jetësore shumë komplekse ua kalojnë atyre më të thjeshtëve dhe përfshijnë secilin nga jovertebrorët kryesorë. Duke përdorur kornizën e tyre kohore, evolucionistët vlerësojnë se krijesave kaq komplekse do t’u jetë dashur të paktën 1.5 miliardë vjet për t’u evoluar, e megjithatë nuk ka ndonjë evidencë parakambriane që të mbështesë se ka ndodhur ndonjë evolucion i tillë. Ashtu siç e pranon edhe Richard Dawkins: “Është sikur ato të ishin mbjellë atje, pa ndonjë

histori evolucionare”⁵⁸. Phillip Johnson nuk mund të jetë shumë larg së vërtetës kur përshkruan Shpërthimin Kembrian si “i vetmi problem më i madh që të dhënat e fosileve i shkaktojnë Darvinizmit”⁵⁹.

Këto janë mes goditjeve më shkatërruese për hipotezat e makroevolucionit. Matematikani dhe fizikani amerikan Wolfgang Smith përmbloodhi domethënien e tyre: “Në mënyrë dogmatike na është thënë se evolucioni është një fakt i themeluar; por kurrë nuk na kanë thënë se kush e themeloi dhe me anë të kujt. Na është thënë, mjaft shpesh, që doktrina themelohet mbi evidencën..., por na kanë lënë tërësisht në errësirë për sa i takon çështjes kryesore se ku konsiston saktësisht kjo evidencë”⁶⁰. Më vonë, ai shton: “Nëse me anë të evolucionit nënkuptojmë makroevolucionin... mund të thuhet me rreptësinë më të madhe se doktrina është tërësisht pa miratim shkencor... nuk ekziston sot as edhe një fije evidence shkencore *bona fide* që të mbështesë tezat se transformimet makroevolucionare kanë ndodhur ndonjëherë”⁶¹.

Dr. Marcel P. Schutzenberger, profesor i Fakultetit të Shkencave në Universitetin e Parisit, u tregua po aq i ashpër. Në “*Mathematical Challenges to the neo-Darwinian Theory*” (“Sfida matematikore ndaj teorisë neodarviniane”), ai doli në përfundimin se probabiliteti i evolucionit i mbështetur në mutacione dhe përzgjedhje natyrore ishte “i pamundur, për arsye se nuk ka “asnjë shans... për të parë këtë mekanizëm të duket në mënyrë spontane dhe, nëse e bëri, ka akoma edhe më pak shans që të mbetet... Ne besojmë se ka një hendek të konsiderueshëm në teorinë neodarviniane të evolucionit dhe besojmë se ky hendek të jetë i asaj natyre që nuk mund të kalohet me konceptin e tanishëm të biologjisë”⁶².

Më 1980, 150 nga teoricienët më të shquar evolucionarë të botës u takuan në Universitetin e Çikagos për një konferencë “për të konsideruar mekanizmat që qëndrojnë mbrapa origjinës së specieve”. Një raport vijues pohonte: “Çështja qendrore e konferencës së Çikagos ishte: nëse mekanizmat që shkaktojnë mikroevolucion mund të vlerësohen për të shpjeguar fenomenin e makroevolucionit... përgjigjja mund të jepet si një “jo” e qartë”⁶³.

Duhet të shpjegohet një çështje tjetër, që është se makroevolucioni pretendon se shpjegon karakteristikat aktuale të gjërave të gjalla,

*çfarëdo që ato karakteristika mund të jenë, por nuk është në gjendje të na japë një shpjegim themelor se si ndodhën këto karakteristika. Shkollari nga Kembrixhi R. E. D. Clark e shpjegon kështu: “Shpjegimet evolucionare janë pothuajse tërësisht të llojit “pasi-ngjarja-kanododhur”. Deveja ka një gungë dhe kjo, ashtu si çdo gjë tjetër, është falë përzgjedhjes natyrore për të cilën na është thënë se ofron “shpjegim shkencor, racional dhe mekanik”. Ndoshta, por, nëse deveja nuk do të kishte një gungë, shpjegimi do të ishte i njëjtë. Macja ka një bisht dhe përzgjedhja natyrore na tregon përse. Por, nëse macja nuk do të kishte bisht, përzgjedhja natyrore do të jepte një shpjegim edhe për të. Nëse një kafshë ka një tipar i cili duket se nuk i jep ndonjë avantazh të dukshëm, na thuhet se duhet të ketë një avantazh, përndryshe nuk do të ishte atje. Nëse ngrihen vështirësi, na thuhet se avantazhi qëndron në ndonjë faktor tjetër me të cilin i pari lidhet gjenetikisht, prandaj *oleogjene* janë shpikur për këtë qëllim... Nëse një tipar që do të ishte i dobishëm për një kafshë nuk është, atëherë sigurisht që përzgjedhja natyrore e shpjegon edhe këtë. E kështu vazhdon, pavarësisht nga faktet që duhen shpjeguar... Megjithatë, kjo nuk na çon shumë larg. Mbi të gjitha, përzgjedhja natyrore përcakton gjithashtu cilat makina mbeten në rrugë pas një periudhe kohore dhe cilat zhduken, por kjo nuk na tregon se si janë prodhuar modelet e tyre”⁶⁴.*

Shkëndija e parë

Ndërsa shkojmë mbrapa, përmes modelit evolucionar, në mënyrë të pashmangshme arrijmë në pikën në të cilën duhet të gjejmë një shpjegim për origjinën e vetë jetës. Që të bëhet një pikënisje për një proces të vazhdueshëm evolucionar, një forme jetësore të tillë do t'i duhej të ruante informacion gjenetik, energji procesi dhe kopje, tri gjëra që sisteme jo të gjalla nuk janë në gjendje ta bëjnë. Prandaj problemi i dukshëm është si ta nisësh jetën; ata që e kanë përjashtuar Perëndinë nga ekuacioni i janë kthyer alternativës së vetme — riprodhimit spontan.

Ndërsa Darvini lodhej me problemin, ai fantazoi për “një pellg të vogël të ngrohtë, ku ishin gjithë llojet e amoniakut dhe kripërave fosforike, dritë, nxehtësi, elektricitet etj.”, në të cilin “u formua kimikisht

një përbërje proteine, gati për t'iu nënshtruar ndryshimeve akoma edhe më komplekse”⁶⁵. Qysh atëherë, eksperimente të shumta janë kryer për të parë nëse jeta mund të niste spontanisht në një lloj “supe” të kryehershme, por më e shumta që ata kanë arritur ka qenë vetëm prodhimi i disa aminoacideve bazë, blloqet ndërtuese të proteinave. Megjithatë, edhe një furnizim i pakufizuar proteinash as nuk do t'i afrohej prodhimit të një qelize të gjallë.

Në *“The Intelligent Universe”* (“Universi inteligjent”), sër Fred Hoyle shprehet kështu: “Po të kishte një parim bazë për materien e cila në njëfarë mënyre çoi sistemet organike drejt jetës, ekzistenca e tij duhej të demonstrohej lehtësisht në laborator. Dikush mund të marrë për shembull një pishinë për të përfaqësuar supën e kryehershme. Mbushe me çfarëdo kimikatesh të një natyre jobiologjike që dëshiron. Pomponi ndonjë gaz në të, ose përmes tij, çfarëdo të dëshironi, dhe bëni të shkëlqejë ndonjë lloj rrezatimi që ju pëlqen juve. Lëreni eksperimentin të vazhdojë për një vit dhe shikoni se sa shumë prej atyre 2,000 enzimave [proteinat “punëtore” që gjenden në qelizat e gjalla] janë shfaqur në pishinë. Unë do t'ju jap përgjigjen në mënyrë që të kurseni kohën, mundimin dhe shpenzimet për të bërë eksperimentin. Nuk do të gjeni asgjë, përveç ndoshta një llumi të katranuar të përbërë nga aminoacide dhe kimikate organike të tjera të thjeshta. Si mund të jem kaq i sigurt për këtë pohim? Epo, po të ishte ndryshe, eksperimenti do të zgjaste qysh kur filloi të bëhej dhe do të ishte i njohur e i famshëm në gjithë botën. Çmimi i tij do të ishte i papërfillshëm krahasuar me atë të zbritjes së njeriut në Hënë... shkurt, nuk ka asnjë fije evidence objektive për të mbështetur hipotezat se jeta filloi në një supë organike këtu në Tokë”⁶⁶.

Kjo nuk të habit shumë kur konsideron ndryshimin e madh mes jetës dhe mosjetës dhe kapacitetin krijues që qelizat më primitive duhej të kishin për të mbijetuar dhe për t'u riprodhuar. Michael Denton i bie pikës kur thotë: “Tani nuk dimë vetëm ekzistencën e një hapësire midis botës së gjallë dhe asaj jo të gjallë, por gjithashtu se ajo përfaqëson mosvazhdimësitë më dramatike dhe më thelbësore të natyrës. Mes një qelize të gjallë dhe sistemit jobiologjik më të organizuar, siç është një kristal apo një flokë bore, ka një hendek aq të madh dhe absolut, saqë mund të imagjinohet lehtësisht”⁶⁷. Më pas, ai shton: “Edhe pse qelizat

më të vogla bakteriale janë në mënyrë të pabesueshme të vogla, me peshë më pak se 1012 gram, secila është një fabrikë e vërtetë në mikrominiaturë që përmban me mijëra copa të skicuara në mënyrë të kujdesshme të makinerisë molekulare të ndërlikuar, të përbëra nga njëqind mijë milionë atome, shumë më tepër e ndërlikuar nga ndonjë makinë e ndërtuar nga njeriu, prandaj nuk i gjendet një paralele në botën jo të gjallë”⁶⁸.

Sër Julian Huxley, i cili pohoi se evolucioni shkonte “nga pluhuri yjor kozmik te shoqëria njerëzore”⁶⁹, shkujdesshëm i tha “*News Chronicle*” më 1950-n: “Ka shumë arsye për të besuar se materia e gjallë u zhvillua automatikisht nga materia jo e gjallë në kushte të caktuara të veçanta të historisë së hershme të tokës”⁷⁰, por, në vend që të kemi “shumë arsye”, nuk kemi asnjë. Nuk kemi evidenca që rrjedhja e rastësishme e energjisë përmes “supës” kimike mund të çojë në kompleksitetin mahnitës edhe të një organizmi të gjallë më të thjeshtë dhe nuk kemi asnjë njohuri të ndonjë mekanizmi me anë të të cilit kjo mund të jetë arritur.

Biokimisti i shquar profesor Kause Dose, president i Institutit të Biokimisë në Universitetin Johannes Gutenberg të Gjermanisë, e zëvendëson fantazinë me faktin: “Më shumë se tridhjetë vjet eksperimentimi mbi origjinën e jetës në fushat e evolucionit kimik dhe molekular kanë çuar në një perceptim më të mirë të madhështisë së problemit të origjinës së jetës në tokë sesa në zgjidhjet e tij. Tani për tani, të gjitha diskutimet mbi teoritë kryesore dhe eksperimentet në këtë fushë ose përfundojnë në remi, ose në një rrëfim paditurie”⁷¹.

Evolucionistë ekstremistë shpesh thonë se problemi mund të zgjidhet duke llogaritur një sasi kohe të mjaftueshme. Ashtu si një shkencëtar pohoi: “Koha është heroi i subjektit. Me kohë të mjaftueshme mund të ndodhë çdo gjë – e pamundura bëhet e mundshme, e mundshmja bëhet e sigurt”⁷². Por kjo rrugë shpëtimi del të jetë fundi. Duke shkruar në revistën “*Nature*”, shkollari Frank Salisbury në Universitetin Shtetëror në Utah diskutoi gjasat kundër prodhimit spontan të një gjeni të vetëm. Ai u kërkoi lexuesve të tij të imagjinonin njëqind milionë trilionë planetë, secili me një oqean të thellë dy kilometra dhe mjaft i pasur në fragmente ADN-je në masën e një gjeni, i cili riprodhon një milion herë për sekondë, me një mutacion që ndodh në secilin

riprodhim. Nën të tilla kushte të favorshme, Salisbury llogariti se do të duheshin trilionë universe për të patur shumë shans të prodhimit të një gjeni të vetëm në katër miliardë vjet, edhe sikur 10^{100} molekula të ndryshme ADN-je mund t'i shërbenin të njëjtin funksion gjeni!⁷³

Problemi i të shpjeguarit të origjinës së jetës u bë edhe më i madh në vitin 1953, kur biofizikani britanik Francis Crick dhe kolegu i tij James Watson zbuluan strukturën e dyfishtë tashmë të njohur të ADN-së. Edhe pse është një molekulë relativisht e thjeshtë, vetëm me katër përbërës bazë, ajo sundon gjithë riprodhimin biologjik dhe transmetimin e gjithë karakteristikave të trashëgueshme. Problemi për evolucionistin është se, edhe pse ADN-ja e bën këtë duke *përpunuar* një sasi të jashtëzakonshme informacioni gjenetik, ajo nuk e *prodhon* atë: “Molekula e ADN-së është mjeti; nuk është mesazhi”⁷⁴. Kjo do të thotë se makroevolucioni duhet të shpjegojë jo vetëm origjinën e materies, por origjinën e pavarur të informacionit, *pa qenë inteligjenca pjesë e ekuacionit*. Phillip Johnson e ilustron këtë duke thënë se, po të shkatërroheshin të gjitha dramat e Shekspirit, asgjë nuk do të humbiste përgjithmonë, sepse aktorët që i kishin mësuar rolet mund t'i rikrijonin tekstet nga kujtesa. Ashtu si Johnson vazhdon të thotë: “Kjo na tregon se informacioni është tërësisht një lloj i ndryshëm gjëje nga mjeti fizik në të cilin mund të regjistrohet përkohësisht”⁷⁵. Ka shumë nga kjo “gjë”! Udhëzimet kimike për ndërtimin e një qenieje të plotë njerëzore ekzistojnë në çdo vezë të pllenuar njerëzore, dhe një kromozom i vetëm mund të përmbajë informacion të barabartë me 500 milionë fjalë⁷⁶. Me një faqe prej 400 fjalësh do të duheshin afërsisht 5,000 libra prej 230 faqesh për ta regjistruar të gjithë dhe një bibliotekë prej 250,000 librash të tillë për të ruajtur gjithë informacionin e fshehur në 46 kromozomet në një vezë të vetme njerëzore të pllenuar. Sikur kjo të mos ishte kaq e mahnitshme, i gjithë ky informacion është koduar në një “gjuhë” që ka vetëm katër “gërma” dhe që fjalori i së cilës përmban vetëm gjashtëdhjetë e katër fjalë trigërmëshe. Nga vjen kjo masë e mahnitshme informacioni? Nuk ka ligj të njohur fizike që mund të krijojë spontanisht informacion dhe as nuk ka shembull informacioni që lind si rezultat i një procesi natyror të pamend. Dr. Werner Gitt, kryetar i Departamentit të Teknologjisë në Institutin Federal të Fizikës dhe Teknologjisë në Gjermani, konfirmon këtë: “Nuk

ka asnjë ligj të njohur natyror përmes të cilit materia mund të shkaktojë informacion, as nuk ka ndonjë proces fizik apo fenomen material të njohur që mund ta bëjë këtë”⁷⁷. Ashtu si përvoja jonë e përbashkët na thotë se informacioni ka gjithmonë një burim inteligjent, nuk është e habitshme që Stephen Grocott, anëtar i Institutit Kimik Mbretëror Australian, të dalë në përfundimin: “Druaj se si shkencëtar thjesht nuk mund ta them me forcë se riprodhimi spontan i jetës është një marrëzi kimike dhe prandaj nuk më mbetet alternativë tjetër veç të besoj se jeta u krijua”⁷⁸.

E megjithatë, evolucionistët vazhdojnë të kërkojnë për këtë që është nga më të mistershmet e “lidhjeve që mungojnë”, të inkurajuar nga njohuria që molekulat e gjalla dhe ato jo të gjalla përbëhen nga të njëjtat atome (oksigen, hidrogjen, karbon, sulfur etj.) dhe se nën kushtet e duhura molekula të vogla mund të kombinohen për të formuar më të mëdha dhe më komplekse. Ajo që i shpëton shkencës është se si, edhe sikur në miliona vjet pa fund, molekula të thjeshta jo të gjalla mund të jenë kombinuar aksidentalisht për të prodhuar ato që bartnin shkëndijën e parë të jetës. Dr. Arthur Wilder-Smith, i cili fitoi tri doktorata në kiminë organike dhe shkencat farmaceutike dhe ka të drejtën të japë mësim në universitete në Shtetet e Bashkuara, Norvegji dhe Turqi (dhe që po ashtu është bërë gjeneral me tri yje në NATO), nuk pati hezitim kur përjashtoi një skenar të tillë: “Modeli evolucionar thotë se nuk është e nevojshme të hamendësosh ekzistencën e ndonjë gjëje veç materies dhe energjisë për të prodhuar jetë. Kjo propozitë është joshkencore. Ne e dimë shumë mirë se po t’ia lësh materies veten e vet nuk e organizon veten, pavarësisht nga të gjitha përpjekjet në vitet e fundit për të vërtetuar se ajo e bën këtë”⁷⁹.

Prej asgjëje?

Ky ka qenë një kapitull domosdoshmërisht i gjatë, por ka një pikë të fundit që duhet futur këtu: nga erdhi realiteti material në fund të fundit? Kemi gjurmuar evolucionizmin që nga një version i përditësuar i “pellgut të vogël të ngrohtë” të Darvinit, por nga erdhi “pellgu”? Është e pamundur të ndjekësh ndonjë program shkencor që do të na tregojë

si filloi universi, por duket se ka vetëm tri mundësi: është i përjetshëm; u vetëkrijua; ose filloi të ekzistonte nga një realitet transhendent.

Për sa i përket mundësisë së parë, teoria e përgjithshme e relativitetit të Anjstani, Ligji i Parë e i Dytë i Termodinamikës dhe shumë vëzhgime astronomike, të gjitha çojnë te një univers që nuk është i përjetshëm dhe i palëvizshëm, por te një që kishte një fillim të përcaktuar dhe po ndryshon me kalimin e kohës. Sipas Paul Davies: “Zbulimi më i rëndësishëm i epokës sonë është se universi nuk ka ekzistuar gjithmonë”⁸⁰.

Mundësia e dytë, se universi është i vetëkrijuar, përplasat gjithashtu me Ligjet e Termodinamikës. Po të shprehemi me një gjuhë të thjeshtë, Ligji i Parë thotë se asnjë energji apo materie e re nuk mund të fillojë të ekzistojë dhe se asnjë nuk mund të zhduket; i zbatuar në terma të drejtpërdrejta, Ligji i Dytë thotë se universi është si një orë që është kurdisur dhe se tani po i afrohet koha, duke u bërë gjithnjë e më shumë i rastësishëm (i çorganizuar) në proces.

Kjo lë vetëm një alternativë, që universi filloi të ekzistonte nga një realitet përtej tij dhe më i madh se ai. Atje ku nuk ka asnjë shpjegim natyror për ekzistencën e një realiteti të tillë, a nuk duhet të kërkojmë një tjetër? Isak Njutoni ishte i bindur se kozmosi “mund të vazhdojë vetëm prej këshillës dhe sundimit të një Qenieje inteligjente dhe të fuqishme”⁸¹, prandaj Edgar Andrews e quan këtë argument “aq afër provës për ekzistencën e Perëndisë, sa është e mundur”⁸². Është thënë se në mënyrë që të kemi universin ashtu siç e njohim, nevojiten pesë gjëra bazë: hapësirë, energji, materie, kohë dhe inteligjencë. Të pesta konceptet gjenden në fjalët hyrëse të Biblës: “Në fillim,

Perëndia krijoi qiejt dhe tokën”⁸³. Nuk ka dyshim që shkollari i respektuar universalisht C. S. Lewis tha se nuk ishte ndeshur asnjëherë me ndonjë teori filozofike rreth fillimeve, që të ishte “një përmirësim radikal” i këtyre fjalëve⁸⁴.

5.

Besim dhe fakte

Paraqitu njerëzve fjalët “besim”, “shkencë”, “fakte” dhe “fe” dhe kërkoju atyre t’i vendosin fjalët që kanë lidhje në çifte; shumë nuk do të hezitojnë të lidhin “shkencë” me “fakte” dhe “fe” me “besim”. Disa e kanë bërë këtë me pasion. Biologu britanik T. H. Huxley, i cili shpiku fjalën “agnostik” dhe u bë i njohur si “Bulldogu i Darvinit” për shkak të mbështetjes pasionante që i bënte Darwinizmit, dikur shkroi se besimi nuk ishte më në kontakt me fakte të çfarëdo lloji. Duke folur në Festivalin e Shkencës të vitit 1992, në Edinburg, Richard Dawkins tha: “Besimi u bënë bisht gjërave, është justifikimi i madh për të shmangur nevojën për të menduar dhe vlerësuar shkencën... besimi nuk lejohet të justifikojë veten përmes argumentit”. Kur pranoi çmimin “Humanisti i vitit”, më 1996-n” nga Shoqata Amerikane Humaniste, ai e shprehu idenë e tij në mënyrë më të drejtpërdrejtë: “Mendoj se besimi është një prej të këqijave të mëdha të botës, i krahasueshëm me virusin e lisë, por më i vështirë për t’u shfarosur. Besimi, duke qenë se nuk mbështetet në evidencë, është vesi kryesor i çdo feje”¹.

Kjo linjë është përhapur kaq shumë, sa, kur kërkojnë zgjidhje për problemet e jetës, shumë njerëz shikojnë instiktivisht më shumë te shkenca sesa te Perëndia. Tregohet një histori për një kapiten avioni, në një fluturim të gjatë, që njoftonte pasagjerët: “Zonja dhe zotërinj, më duhet t’ju them se një prej motorëve është fikur, por, ju lutem, mos u shqetësoni, sepse ende kemi edhe tre të tjerë dhe ata mund

të na shpien pa ndonjë vështirësi. Nëse ndonjë prej jush është ende i shqetësuar, më lejoni t'ju them një lajm të mirë. Kemi katër peshkopë në bord, prandaj do të jemi mirë”. Kur dëgjoi këtë, një pasagjer thirri një prej stafit dhe i tha: “Ju lutem, i thoni kapitenit se do të isha shumë më i lumtur po të kishim tre peshkopë dhe katër motorë!”.

Shkenca: faktori besim

Ne pothuajse nuk kemi nevojë të harxhojmë kohë për të vërtetuar se faktet janë lënda e parë që furnizojnë gjithë shkencën. Ato janë elementet që shkenca zbulon dhe studion dhe pastaj i përdor për të ecur më tej në kërkimin e pafund për të vërtetën në botën natyrore. Çështja që kemi nevojë të diskutojmë është nëse shkenca është një disiplinë që përfshin besim. Në fjalimin që bëri për pranimin e titullit të cituar më sipër, Richard Dawkins vazhdoi të thoshte se, në pikëpamjen e tij, “shkenca është e lirë nga vesi kryesor i fesë që është besimi”. Megjithatë, ka shkencëtarë shumë të kualifikuar që do të thoshin se kjo kombinon një supozim të gabuar (që besimi është një ves) dhe një përfundim të gabuar (që shkenca nuk ka besim). I përqendruar në temën e evolucionit, shkencëtari Amerikan Harold Urey, i cili zbuloi hidrogjenin e rëndë dhe ky zbulim i dha atij çmimin “Nobel” të vitit 1934 në kimi, ishte i përkushtuar ndaj një botëkuptimi materialistik që nuk kishte vend për Perëndinë, e megjithatë ai pranoi: “Të gjithë ne që studiojmë origjinën e jetës zbulojmë se, sa më shumë të shohim në të, aq më tepër ndiejmë se është shumë komplekse që të ketë evoluar diku. Ne të gjithë besojmë si *një çështje besimi* se jeta evoloi nga materia e vdekur në këtë planet”². Filozofja amerikane Marjorie Grene, një historiane e njohur e shkencës, shkroi: “Darvinizmi vepron si *një fe e shkencës* që kryesisht kapi dhe kap mendjet e njerëzve... i predikuar nga fanatikët e vet me zell fetar”³.

Ashtu siç e pamë në kapitullin 2, askush nuk është “jobesimtar”. Pozicioni i shkencëtarëve që pohojnë se nuk kanë besim te Perëndia i shfaqur në Bibël (apo në ndonjë perëndi tjetër), nuk është ai pa besim, por ai që sundohet nga vetë parimi që pohojnë se e përbuzin. Ateistët mund të pohojnë se pikëpamja e tyre për origjinën, ekzistencën dhe natyrën e universit mbështetet veçanërisht në fakte shkencore, por e

vërteta është se ata mbështeten fort në parimin e besimit. Ashtu si mund ta tregojmë lehtësisht, çdo shkencëtar vepron mbi supozime bazë që nuk mund të vërtetohen logjikisht ose shkencërisht.

Supozime

Në radhë të parë, është e qartë që shkencëtarët supozojnë realitetin dhe integritetin e ekzistencës së tyre. Në shek. XVII, matematikani francez Rëne Dekarti (René Descartes) ishte thellësisht i shqetësuar se sisteme besimi të themeluara po sfidoheshin nga zbulime të reja shkencore. Në një përpjekje për t'i mbajtur bashkë, ai u përpoq të sillte siguri në filozofi, duke lënë mënjanë çdo gjë që mund të vihej në dyshim, në mënyrë që të gjente diçka përtej *gjithë* dyshimit. Mirë që shkenca pohonte se ne duhet të mbështetemi në shqisat tona, por nga ta dinim se ato ishin të besueshme? Pas një përpjekje të madhe mendore e torturorese, ai krijoi për herë të parë shprehjen për të cilën është më i famshmi: “*Cogito, ergo sum*” (“Unë mendoj, prandaj dhe ekzistoj”). Dekarti i përdori dyshimet e tij për të konfirmuar se ai duhet të ekzistonte si një qenie menduese e dyshuese. Ai i çoi idetë e tij aq larg, sa u bë i njohur si një prej etërve të racionalizmit modern, që thotë se vetëm arsyeja është burimi kryesor i gjithë njohurisë njerëzore dhe mjafton për të zgjidhur gjithë problemet e natyrës dhe fatit të njeriut. Nuk është e vështirë ta rrëzosh këtë, por asnjë shkencëtar nuk do të përparojë fare, derisa ai ose ajo të pranojë thënien më të famshme të Dekartit.

Në radhë të dytë, shkencëtarët supozojnë se *universi ekziston si një realitet objektiv e i pavarur jashtë tyre*. Ky supozim vjen që nga mendimtarët e lashtë grekë, si: Plato, Aristoteli e Sokrati (edhe pse disa prej tyre nuk mendonin që universin ia vlente ta studioje) dhe është kaq i rëndësishëm, sa që pa të shkenca do të ngecte në vend; pa të, as nuk do të mund të fillonte. Megjithatë, ashtu si Del Ratzch vë në dukje, ekzistenca e universit është pikërisht ajo që mund të pritej “nëse natyra që studion shkenca do të ishte krijim”⁴.

Së treti, shkencëtarët supozojnë se *natyra është e njëtrajtshme*, se ajo që kemi rreth nesh është kozmos dhe jo kaos. Ne kemi parë vetëm një pjesë mikroskopike të gjithë realitetit natyror dhe këtë e kemi bërë

vetëm për një pjesë shumë të vogël kohe, por ne supozojmë se realiteti rreth nesh është i rregullt në sjelljen e tij, në mënyrë që të mund të regjistrojmë detajet dhe punën e tij për të kuptuar diçka nga ajo që nënkupton ai. Po të mos supozonim se proceset dhe modelet në natyrë ishin të qëndrueshme, mund të mos ishim asnjëherë të sigurt se ligjet e natyrës do të funksiononin në të njëjtën mënyrë nesër, ashtu si bëjnë edhe sot. Megjithatë, nuk ka ndonjë arsye logjike se përse ato duhet të funksionojnë në të njëjtën mënyrë. Fakti që dielli ka lindur çdo ditë të jetës tënde nuk është garanci logjike që do të lindë edhe nesër. Në shprehjen e njohur të Albert Ansjhtajnit: “Fakti më i mistershëm i natyrës është që është i kuptueshëm”⁵.

Shkenca mund të vazhdojë vetëm mbi supozimin se bota është e organizuar dhe e parashikueshme. Nëse ligji i rëndësës papritur ndryshonte drejtimin, në mënyrë që mollët e shkundura nga era të shkojnë lart në vend që të bien poshtë, jo vetëm shkencëtarët do ta kishin të vështirë jetën dhe të rishikonin mënyrën se si veprojnë! Paul Davies nuk heziton të pranojë se çdo të thotë kjo: “Duhet të pranoni si vepër besimi që ka një rend ekzistues në natyrë i cili është i kuptueshëm për ne. Kjo është një vepër e madhe besimi”⁶.

Së katërti, shkencëtarët në çdo disiplinë supozojnë se shqisat e tyre i bëjnë ata të jenë në gjendje të zbulojnë të dhëna të sakta rreth natyrës dhe t’u komunikojnë informacion të vërtetë të tjerëve. Me fjalë të tjera, ata besojnë se shqisat u tregojnë atyre të vërtetën, për arsye se ato, në njëfarë mënyre, janë “fatur” në botën rreth tyre. Ashtu si shprehen dy profesorë modernë të shkencës: “Është një fakt mbresëlënës dhe jo i parëndësishëm që modeli i matematikës realizohet në strukturën fizike të botës dhe se mendjet tona janë në gjendje të zgjidhin probleme që paraqet bota fizike”⁷.

Së pesti, shkencëtarët supozojnë *ligjin e shkakut dhe efektit*. I gjithë aktiviteti shkencor ndërtohet mbi parimin që brenda një bote të organizuar efektet duhet të kenë lidhje me shkaqet. Entomologu i shquar Stanley Beck, edhe pse e kundërshtoi fort konceptin e krijimit hyjnor, pranoi: “Postulati më i njohur që mbështet strukturën e njohurisë shkencore është ai i shkakut dhe efektit”⁸. Shkencëtarët kanë një bindje të brendshme se çdo ngjarje mund të shpjegohet si produkt i ndonjë ngjarjeje të mëparshme.

Së gjashti, shkencëtarët besojnë se *gjërat që mund të shohin u japin të dhëna për gjërat që nuk mund t'i shohin*. Del Ratzch jep një shembull të qartë: “Ne nuk mund t'i shohim drejtpërdrejt atomet dhe mikronjësi të tjera të tilla, megjithatë pjesa më e madhe e shkencëtarëve janë të sigurt për ekzistencën e tyre në bazë të gjërave të një shkalle të gjerë që sytë njerëzorë mund të shohin gjurmët e reve etj. Në anën tjetër, ka fenomene për të cilat shkencëtarët janë të sigurt, por që thjesht janë tepër të mëdhaja që njerëzit t'i shohin. Shkencëtarët flasin me vetëbesim për strukturën e një shkalle të gjerë të universit dhe për historinë apo të ardhmen e gjatë të universit. Ne nuk mund t'i ndjekim drejtpërdrejt të tilla procese në shkallën tonë të përkohshme dhe hapësinore të vëzhgimit, por ajo që mund të shohim merret si evidencë për procese të tilla”⁹.

Këto gjashtë supozime thelbësore i japin goditje të mëdha dogmës së Dawkins se shkenca është e lirë nga “vesi” i besimit. Pa besim (në kuptimin e të supozuarit të gjërave që nuk mund të vërtetohen logjikisht), shkenca nuk do të përparonte dot. Të gjithë shkencëtarët i janë përkushtuar thellësisht parimit të besimit: ata supozojnë integritetin e tyre, ekzistencën e botës si një realitet objektiv, gjendjen uniforme të natyrës, varësinë e shqisave të tyre, ligjin e shkakut dhe efektit dhe ekzistencën e realitetit përtej të parit të tyre fizik. Për ta shprehur më thjesht, çdo shkencëtar ushtron besim ndërsa kërkon fakte.

Është interesante që të gjitha këto supozime përputhen përsosmërisht në një botëkuptim biblik teist. Dy të parat mbulohen përsosmërisht nga pohimi që Perëndia “bëri qiellin, tokën, detin dhe gjithçka në ta”¹⁰. Një pamje biblike e natyrës me Perëndinë si krijuesin e vet, ofron një shpjegim të besueshëm të supozimit të tretë, që merret me ekuilibrin dhe elegancën e ligjit të natyrës. Teologu Elaine Storkey, Kryeanëtar Kërkimi në Wycliffe Hall, në Oksford, me të drejtë tha në “*Soul of Britain*”: “Arsyeja që shkenca është e mundur, është se jetojmë në një kozmos të organizuar sipas ligjeve, të cilin Perëndia e ka krijuar”¹¹. Del Ratzch nënvizon këtë çështje: “Gjendja uniforme është ajo që duhet të presim nga një krijim që është vendosur nga një Perëndi i cili është besnik dhe që sundohet nga urdhrat e tij”¹². Pohimi biblik se ka një Krijues të përbashkët si për materien edhe për mendjen, përputhet

mirë me supozimin e katërt që shqisat tona na bëjnë në gjendje të “futemi” në botën rreth nesh. E pesta, një lidhje elegante ndërmjet shkaktit dhe efektit është ajo që do të prisnim nga një Krijues, karakteri i të cilit është i rregullt dhe i qëndrueshëm. Së fundi, një kozmos i mahnitshëm, pjesa më e madhe e të cilit është përtej kufijve të të parit tonë fizik, është tërësisht në harmoni me të qenit vepër e një krijuesi transhendent, madhështinë e të cilit “asnjë nuk mund ta njohë”¹³ dhe që rrugët e tij janë “të pashtershme”¹⁴.

Në fund të fundit, shkenca e çdo lloji është një disiplinë domosdoshmërisht e mbështetur në besim. Pa supozimin e organizimit në univers, shkenca nuk do të mund të fillonte kurrë, për të mos folur për të arritur në ndonjë përfundim të qëndrueshëm përreth diçkaje. Edhe pse nuk kishte rrëfyer se ishte i krishterë, Albert Anjashtajni shkroi: “Sferës së fesë i përket besimi se rregullat e vlefshme për botën e ekzistencës janë racionale, që është e kuptueshme për arsyen. Nuk mund të imagjinoj një shkencëtar të vërtetë pa atë besim të thellë”¹⁵. Shkencëtari i njohur botërisht sir John Polkinghorne bie dakord: “Në çdo kërkues të vërtetë të natyrës ka një lloj adhurimi fetar; sepse ai e ka të pamundur të imagjinojë se është i pari që ka menduar fijet gjerësisht delikate që lidhin perceptimet e tij. Aspekti i njohurisë që nuk është bërë ende i njohur, i jep atij që heton një ndjenjë të njëjtë me atë të një fëmije i cili kërkon të kapë mënyrën mjeshtrërore me të cilën njerëzit manipulojnë gjërat”¹⁶. Nuk është për t’u habitur që fizikani gjerman Max Planck, që fitoi çmimin “Nobel” për Fizikën më 1918-n dhe që e konsideronte kërkimin për ligjet universale të fizikës “kërkimin shkencor më sublim në jetë”, bëri këtë deklaratë kategorike: “Kushdo që është përfshirë seriozisht në çfarëdo pune shkencore, e kupton që mbi portat e tempullit të shkencës janë shkruar fjalët: “Duhet të kesh besim”. Është një cilësi pa të cilën shkencëtarët nuk mund të bëjnë”¹⁷.

Stephen Barr e përmbledh këtë shumë mirë: “Kështu ne shohim të shkenca diçka të ngjashme me besimin fetar. Shkencëtari ka besim në aftësinë inteligjente të botës. Ai ka pyetje për natyrën. Dhe ai pret, më shumë sesa pret, është tërësisht i bindur se këto pyetje kanë përgjigje të kuptueshme. Fakti që ai duhet t’i kërkojë këto përgjigje vërteton se ato nuk shihen. Fakti që ai vazhdon t’i kërkojë ato, pavarësisht nga

gjithë vështirësitë, i dëshmon bindjes së tij të papushtueshme se ato përgjigje, edhe pse tani për tani nuk duken, në të vërtetë ekzistojnë. Në të vërtetë, edhe shkencëtari ecën me anë të besimit dhe jo me anë të të parit”¹⁸.

Shkencëtarët që pranojnë të vërtetën e këtyre supozimeve, por që e hedhin poshtë idenë se ato janë shenja të shkencës që të çojnë përtej vetes së tyre në një Perëndi transhendent, bien kokë e këmbë në një koriqe misteresh edhe më të mëdha. Autori britanik bashkëkohor, dikur ateist, dr. Rob Frost vë në dukje disa prej tyre: “Nëse shkencëtari parapëlqen të sugjerojë se nuk ka “Perëndi”, nuk ka “Krijues” dhe nuk ka “Shkak të Parë”, çfarë i ofron ateizmi nga ana intelektuale? Ateisti duhet, prej domosdoshmërisë, të besojë se materia pa mendjen krijuan logjikën dhe arsyen. Materia pa inteligjencën krijuan të kuptuarit dhe kuptimin. Materia pa moralin krijoi kode etike komplekse dhe sisteme ligjore. Materia pa ndërgjegjen krijoi një kuptim të së mirës dhe së gabuarës. Materia pa emocion krijoi aftësi dhe art, muzikë, dramë, arkitekturë, komedi, letërsi dhe vallëzim. Materia pa skicim krijoi te njeriu një uri të pangopshme për kuptim dhe qëllim”¹⁹.

Bazat e besimit

Asgjë që kam shkruar në këtë kapitull (apo në pjesën tjetër të librit) nuk ka për qëllim të sugjerojë se nuk ka shkencëtarë të shkëlqyer apo të klasit botëror që janë ateistë apo agnostikë. Përveç kësaj, pa dyshim që ka po ashtu shkencëtarë të shquar që janë judenj, myslimanë, hindu a budistë, apo që regjistrohen në një prej shumicës së sistemeve të besimeve të tjera. Madje një organizatë fetare ka një titull Shkenca e Krishterë, që duket se sugjeron se është mënyra përfundimtare e shkrirjes së shkencës dhe besimit të krishterë. Por në këtë titull ka më shumë (ose më pak) sesa të sheh syri, prandaj, në vend që ta ndërpres rrjedhën e këtij kapitulli, e kam shqyrtuar Shkencën e Krishterë në një shtojcë. Fokusi ynë këtu është te krishterimi tradicional dhe marrëdhënia ndërmjet fakteve dhe besimit.

Kur u përqendruam te shkenca, vumë re se ajo furnizohej nga fakte dhe se pika që diskutohej ishte nëse përfshihej besimi. Kur përqendrohemi te krishterimi, mund ta kthejmë monedhën nga ana

tjetër dhe ta marrim si të mirëqenë çështjen e besimit. Çështja të cilën kemi nevojë të shqyrtojmë është nëse besimi biblik mund të justifikohet në ndonjë bazë faktike.

Mund të arrijmë pikërisht në zemër të çështjes duke vështruar atë që nga shumë njerëz shihet si një prej dobësive më të mëdha të krishterimit: të dhënat biblike për mrekullitë. Mendimtari skocez i shek. XVIII Davide Hume ishte kaq skeptik për këtë temë, saqë mendonte se mrekullia e vetme e vërtetë ishte se njerëzit u besonin mrekullive! Megjithatë, çfarëdo arsye që mund të paraqitet për të hedhur poshtë mundësinë e mrekullive, është e pamundur t'i hedhësh poshtë ato nga ana shkencore. Në "*Quarks, Chaos and Christianity*" ("Kuarkë, kaos dhe krishterimi") së John Polkinghorne shkruan: "Çështja e mrekullive nuk është kryesisht shkencore, por teologjike. Shkenca thjesht na tregon se këto ngjarje janë kundër pritshmërisë normale. Këtë e dimë që nga fillimi. *Shkenca nuk mund të përjashtojë mundësinë që, në raste të veçanta, Perëndia bën gjëra të veçanta dhe të padëgjua.* Pastaj, është ai që cakton ligjet e natyrës dhe jo ai që u nënshtrohet atyre"²⁰.

Ligjet e natyrës janë thjesht vlerësimi ynë i mënyrës se si Perëndia normalisht bën që të ndodhin gjërat. Por ai nuk u nënshtrohet atyre ligjeve dhe ka liri të përsosur për t'i pezulluar ose ndryshuar ato në bazë lokale apo më gjerë, kurdo dhe për çfarëdo arsye që ai zgjedh; edhe po të vepronte kështu, nuk do të thyente ndonjë ligj të njohur. Në qoftë se gjatë kohës që gruaja ime shtron tryezën i bie një thikë, normalisht që do të bjerë në dysheme, por nëse unë do të isha aq i shpejtë me duart e mia sa ta kapja para se të godiste dyshemenë, nuk do të thyeja ndonjë ligj të fizikës, thjesht do të ndërhyja. Nëse kjo është e vërtetë në shkallë njerëzore, me siguri që është e vërtetë në shkallë hyjnore, prandaj shkenca nuk është në gjendje të vërtetojë se një gjë e tillë nuk ndodhi asnjëherë. Në një letër drejtuar "*The Times*", më 1984-ën, trembëdhjetë shkencëtarë të shquar, pjesa më e madhe e tyre profesorë universitetesh, e mbyllën në mënyrë klinike këtë derë të veçantë: "Nuk është e vlefshme logjikisht ta përdorësh shkencën si argument kundër mrekullive. Të besosh se mrekullitë nuk mund të ndodhin, është po aq akt besimi sa edhe po të besosh se ato mund të ndodhin... mrekullitë janë ngjarje të padëgjua. Çfarëdo që mund të sugjerojnë moda e kohës në filozofi apo zbulimet nga pyetësorët, është

*e rëndësishme të pohojmë se shkenca... nuk mund të ketë asgjë për të thënë mbi këtë temë*²¹.

E vetmja mënyrë për ta trajtuar çështjen është ta bësh këtë hapur dhe ndershmerisht. Ashtu si thotë edhe historiani Philip Schaff: “Qëllimi i historianit nuk është të ndërtojë një histori nga nocione të imagjinuara më parë dhe ta përshtasë atë sipas dëshirës së tij, por ta riprodhojë atë nga evidenca më e mirë dhe ta lërë që të flasë vetë për veten”²². Kushdo që i hedh poshtë mrekullitë jo në baza të forta shkencore, por për arsye se ato përplasen me pikëpamjen e tij ose të saj, më mirë ta shmangë çështjen në vend që ta shqyrtojë atë. Qëndrimi i duhur është të shikosh të dhënat me mendje të hapur, të bësh pyetjet e duhura, të shqyrtojë të gjitha evidencat sa më afër që të jetë e mundur dhe pastaj të arrish në një përfundim të qartë se ku të çojnë ato. Ky qëndrim duhet të fillojë duke pranuar se, nëse Perëndia është person dhe kërkon të komunikojë me ne, të paktën është e mundur që herë pas here ai mund të zgjedhë të veprojë kështu në mënyra të pazakonta, madje edhe unike. Ta përjashtosh Perëndinë që nga fillimi, është të futësh kritere të rreme në gjithë kërkimin; të mohosh mrekullitë për shkak se janë përtej shpjegimit njerëzor, është diçka si arrogante ashtu edhe e marrë. Ashtu siç u shpreh me shpoti autori britanik i shekullit XIX Charles Caleb Colson: “Ai që beson vetëm atë që mund të kuptojë, duhet të ketë një kokë shumë të gjatë ose një kredo shumë të shkurtër”²³. E vetmja mënyrë për të ditur nëse mrekullitë mund të ndodhin, është të shohësh nëse ka ndodhur ndonjë. Bibla na jep një mundësi të përsosur për ta ndjekur këtë çështje.

Rast prove

Gjatë një fjalimi në Universitetin e Cape Town, një militant ateist më ndërpriste me pyetje dhe pas takimit bisedova gjatë me të rreth ekzistencës së Perëndisë. Duke qenë se më duhej të largohesha për një takim tjetër, i bëra një pyetje të fundit: “Çfarë mendon për Jezuin?”. Përgjigjja e tij e menjëhershme ishte: “Nuk e di, por e kuptoj se çdo gjë vërtitet rreth faktit nëse ai u ringjall prej së vdekurish”. Kishte shumë të drejtë! Krishterimi qëndron ose bie nga kjo ngjarje, sepse i gozhdon gjithë të tjerat. Bibla thotë se në ringjalljen prej së vdekurish Jezui “u

deklarua Biri i Perëndisë në fuqi”²⁴, dhe një version i shtjelluar i tekstit origjinal në greqisht sjell forcën e asaj që është thënë: “Ai ishte caktuar hapur Biri i Perëndisë në fuqi, në një mënyrë goditëse, triumfuese dhe të mrekullueshme”²⁵. Me fjalë të thjeshta, ringjallja thuhet se është një deklaratë e hyjnisë së tij.

Sfondi mund të skicohet shumë shpejt. Pasi u tradhtua nga Juda Iskarioti dhe u torturua nga ata që e kishin zënë rob, Jezui e çuan sa në një gjykim në tjetrin para se të dënohej me vdekje me kryqëzim jashtë Jerusalemit. Një ndjekës i pasur fitoi lejen për ta hequr trupin dhe për ta varrosur në varrin e tij privat, të gdhendur në një shkëmb në një kopsht aty afër. Kishte disa dëshmitarë gjatë varrimit. Për shkak të polemikave që rrethonin gjykimin dhe ekzekutimin e Jezuit, një njësi ushtarësh u vendos në varr dhe një guri të stërmadh të vendosur në hyrje iu shtua edhe vula zyrtare e guvernatorit romak.

Tri ditë më vonë ndodhi ngjarja e shekullit të parë që do të barazohej me një furi moderne mediatike: trupi ishte zhdukur! Kjo u konfirmua të paktën nga pesë njerëz që shkuan te vendi ditën që ndodhi historia, dhe askush nuk e kundërshtoi ndonjëherë dëshminë e tyre. Një varr bosh nuk arrin të vërtetojë se Jezui ishte kthyer prej së vdekurish, por shpejt pas kësaj (dhe për pjesën tjetër të jetës së tyre) pasuesit e tij e predikuan hapur se ai ishte kthyer. Gjithçka që mund të bënin autoritetet që të vërtetonin se ata ishin të çmendur ose gënjeshtarë, ishte të hapnin varrin për hetim publik, po fakti që ata nuk e bënë një gjë të tillë është shumë domethënëse. Ashtu si thotë me të drejtë teologu gjerman Paul Althaus: “Nuk do të ishte e mundur që shpallja e ringjalljes të ruhej në Jerusalem vetëm për një ditë, vetëm për një orë, nëse zbrazëtia e varrit nuk do të vendosej si fakt për të gjithë ata që kishin të bënin me të”²⁶.

Përgjigje ndaj disa kundërshtimeve

Skeptikët e kanë ditur gjithmonë domethënien e ringjalljes, prandaj, gjatë shekujve, ata kanë gjetur një seri shpjegimesh alternative për trupin e zhdukur. Ja, disa prej tyre:

Jezui nuk vdiq. E ashtuquajtura “teoria e vilanosjes” u bë popullore në shek. XVIII, por është një teori e dështuar. Edhe para kryqëzimit të tij, Jezuin e kishin rrahur dhe e kishin fshikulluar mizorisht, ndërkohë që në kryq trupi i tij u çua nga heshta e një ushtari, me qëllim që të konfirmohej vdekja e tij²⁷. Në asnjë çast gjatë heqjes dhe varrimit të trupit të tij asnjë nga njerëzit që u morën me të nuk vunë re as shenjë në të vogël të jetës. Megjithatë, teoria e vilanosjes na kërkon të besojmë se në varrin e akullt Jezui doli nga koma, hoqi rrobat e varrit, të përdredhura rreth trupit, të lyera me material ngjitës, përforcues balsamosjeje që peshonte 34 kg²⁸, shtyu gurin e madh që qëndronte para varrit, mundi një roje të armatosur të ushtarëve romakë, u kthye në qytet krejt i zhveshur (ose kishte rrëmbyer ndonjë nga rrobat e varrit) dhe pastaj kishte bindur shokët e tij se nuk kishte patur një përvojë afër vdekjes, por se në të vërtetë kishte vdekur, pastaj e kishte mundur vdekjen përgjithmonë. Nuk ka dyshim që edhe një skeptik i vendosur si shkollari gjerman i shek. XIX David Strauss e hodhi poshtë teorinë e vilanosjes si “të pamundur”!²⁹

Të gjithë vizitorët e parë shkuan në varrin e gabuar. Kjo ide u sugjerua për herë të parë më 1907-n, por duhet të jetë shuar sapo lindi. Dy nga këta vizitorë jo vetëm që kishin qenë të pranishëm në varrim, por kishin vënë re madje “se si trupi i tij u vendos në të”³⁰, dhe, sido që të ishte puna, a do ta harronte se ku ishte varri pronari që më parë e kishte zgjedhur atë për vete?

Trupin e vodhën një ose disa persona të panjohur. Ky skenar nuk ka evidenca, mundësi ose motiv. Ashtu si sër Norman Anderson, dikur drejtor i Institutit të Studimeve Ligjore të Përparuara në Universitetin e Londrës, thotë në mënyrë ironike: “Një jude i asaj kohe vështirë se mund të dyshohej për vjedhje trupash për kërkime anatomike”³¹.

Autoritetet romake vodhën trupin. Është e qartë se ata do të kishin patur rastin më të mirë, por jo motiv të kuptueshëm. I gjithë qëllimi i tyre në vendosjen e një roje të armatosur ishte ta mbanin trupin aty ku ishte.

Autoritetet judeje lëvizën trupin. Ata kishin të njëjtin interes me autoritetet romake për ta mbajtur trupin të sigurt për katër ditë (duke kaluar edhe “ditën e tretë”, kur Jezui kishte profetizuar se do të ngrihej përsëri), por përse kujdestaria e tyre të mendohej si më e sigurt se ajo e romakëve, e cila ishte mbështetur nga forca e armatosur? Kur ndjekësit e Jezuit filluan të predikonin se ai ishte i gjallë, përsëri ata u arrestuan, u rrahën me kamzhik, u burgosën dhe u vranë, të gjitha këto të panevojshme nëse autoritetet judeje kishin trupin. Ashtu si vëren teologu skocez i shek. XIX profesor Andrew Fairbairn: “Heshtja e judenjve është po aq domethënëse sa edhe i foluri i të krishterëve”³².

Dishepujt e Jezuit hoqën trupin. Kjo histori qarkullonte në atë kohë, por na thuhet se u shpik qëllimisht prej autoriteteve judeje për të diskretituar dishepujt. Përveç kësaj, si do të kishin qenë në gjendje ca ndjekës të tmerruar të mposhtnin rojet romake? Përse do të rrezikonin jetët e tyre duke prishur vulën zyrtare të guvernatorit? Përse të lëviznin një trup të njërit prej tyre që e mbanin në ruajtje? Përse nuk ka asnjë të dhënë që ata u akuzuan për vjedhje të varrit? Përse të rrezikonin jetët e tyre duke predikuar se e kishin parë të gjallë Jezuin, kur e kishin fshehur diku trupin e tij? Ata mund ta kishin rrezikuar jetën për diçka që e imagjinonin, por jo për diçka që e kishin shpikur.

Charles Colson, një prej këshilltarëve të presidentit të Shteteve të Bashkuara Richard Nixon, në kohën e skandalit të Watergate, që i dha fund presidencës së tij në vitet 1970, tregon se si, brenda një muaji, tre prej atyre të përfshirë në vjedhjen famëkeqe kishin shkuar në Departamentin e Drejtësisë për të ndryshuar dëshminë e qeverisë. Duke komentuar mbi këtë, kohë më vonë, Colson shkruante: “Në përvojën time me Watergate pashë paaftësinë e njerëzve me pushtet dhe profesionistë shumë të motivuar të mbanin një komplot të mbështetur mbi një gënjeshtëri... Megjithatë, ndjekësit e Krishtit pohuan deri në vdekjen e tyre të tmerrshme nga ekzekutimi se e kishin parë në të vërtetë Jezu Krishtin të ngritur prej së vdekurish. Nuk kishte komplot... Gratë e burrat nuk heqin dorë nga rehatia, sigurisht as nga jeta e tyre, për atë që e dinë se është gënjeshtëri”³³.

Sër Norman Anderson pohon se shndërrimi i dishepujve prej frikacakë në guximtarë është “prova e tërthortë më e fuqishme për ringjalljen”³⁴.

Ka edhe më shumë...

Por mund të shkojmë përtej provave të tërthorta. Ka gjashtë dëshmi të shkruara të pavarura, tri prej të cilave nga dëshmitarë okularë, që Jezui u shfaq i gjallë pasi trupi i tij i vdekur kishte qenë në varr për tri ditë. Këto regjistrojnë njëmbëdhjetë shfaqje të shkëputura nga njëra-tjetrës gjatë një periudhe prej dyzet ditësh³⁵ me mbi 500 njerëz të pranishëm në një rast të veçantë³⁶. Skeptikët sugjerojnë se këto raporte mund të mos merren në konsideratë duke u menduar si halucinacione, por shfaqjet nuk përputhen me asnjë ligj të njohur që kanë të bëjnë me temën. Nuk ka prova që ndonjë prej dëshmitarëve okularë ishte nevrastenik apo psikotik dhe Jezui rrallë u shfaq në vende ku ai dhe ndjekësit e tij kishin kaluar kohë së bashku. Për më tepër, ringjallja ishte gjëja e fundit që ndjekësit e tij prisnin. Ata ishin tërësisht të demoralizuar dhe shumë të sigurt se Jezui kishte vdekur dhe ishte varrosur. Ringjallja e tij ishte për ta më shumë si një tronditje, sesa përmbushje dëshire; disa nuk e besuan kur u thanë për herë të parë³⁷ dhe të tjerët u alarmuan³⁸. Pasi konsideroi gjithë çështjet e përfshira, kirurgu i shquar Arthur Rendle Short arriti në përfundimin: “Shfaqjet pas ringjalljes thyejnë çdo ligj të njohur të të parit”³⁹.

Që prej 2,000 vjetësh, ata që pohojnë se janë të krishterë formojnë grupin më të madh fetar që bota ka njohur ndonjëherë, prandaj origjina e tij duhet të gjendet jo në stilin e vet të adhurimit, as në ndonjë pozitë të veçantë në çështjet sociale, as në një linjë të re prej filozofie morale, po në një ngjarje të vetme: *ringjalljen e Jezuit prej së vdekurish*. Ashtu si thotë autori amerikan D. James Kennedy: “Kanioni i Madh nuk u shkaktua nga një indian që tërhiqte një shkop, kështu dhe kisha e krishterë nuk u krijua nga një mit”⁴⁰.

Të tjerë kanë shtuar prapashkrime më formale. Juristi dhe humanisti gjerman i shek. XVII Hugo Grotius, i cili u bë i njohur si “babai i ligjit ndërkombëtar”, mbrojti fuqishëm faktin historik të ringjalljes së Jezuit në librin e tij *“The Truth of the Christian Religion”* (“E vërteta për fenë

e krishterë”). Në shek. XVIII, Lord Lyndhurst pati njëra pas tjetrës këto detyra: Zëvendësprokuror i Përgjithshëm, Prokuror i Përgjithshëm, Mjeshtër i Regjistrave dhe Kancelar i Madh i Anglisë. Kur vdiq më 1863-shin, një nekrologji e “*The Times*” thoshte për të: “Nuk kishte njeri më të lirë nga nocionet e korrupsionit apo që të vepronte në mënyrë më të pavarur nga ndikimi më i ulët”. Vlerësimi i Lord Lyndhurst për tregimin e ringjalljes ishte si vijon: “Unë e di shumë mirë se çfarë është prova; prandaj po ju them, një provë e tillë si ajo e ringjalljes ende nuk është shkatërruar”⁴¹. Dr. Simon Greenleaf, profesor “Dane” i ligjit në Universitetin e Harvardit është konsideruar “autori i vetëm më i madh mbi provat në të gjithë literaturën mbi procedurat ligjore”⁴². Një herë ai shkroi se, nëse dëshmia e dëshmitarëve për ringjalljen e Jezuit do të shqyrtohej “sikur të ishte në një gjyq, në anën e grupit kundërshtar, me dëshmitarët që do t’i nënshtroheshin një hetimi të hollësishëm e të rreptë”, rezultati, “në mënyrë të besueshme, do të jetë një bindje e padyshimtë për integritetin, aftësinë dhe të vërtetën e tyre”⁴³. Lord Caldecote, kryetar i Gjykatës së Lartë të Anglisë, tha se për ringjalljen mund të ngrihet një “çështje e parezistueshme” “thjesht nga prova e plotë”⁴⁴. Lord Darling, i cili gjithashtu shërbeu si kryetar i Gjykatës së Lartë të Anglisë, doli në përfundimin: “Ekziston një provë e tillë e parezistueshme, pozitive dhe negative, saqë asnjë juri inteligjente në botë mund të mos arrijë të shpallë vendimin se ringjallja është histori e vërtetë”⁴⁵.

Rrjedhime

Ka rrjedhime me pasoja të mëdha, si pozitive ashtu dhe negative.

Nëse Krishti nuk u ringjall

Nëse Krishti nuk u ringjall prej së vdekurish, ai vetë ose ishte i mashtruar, ose i pandershëm (përderisa tha se do të ringjallej), dhe dishepujt e hershëm ishin një llum mashtruesish blasfemues. Për më tepër, të gjithë martirët e krishterë gjatë shekujve (dhe ka patur me miliona prej tyre) kanë derdhur gjakun për diçka që nuk ndodhi kurrë; reformatorët e krishterë të shoqërisë u motivuan nga një pako gënjeshttrash; çdo

ndërtesë kishe e krishterë është një monument miti; çdo shërbesë e mbajtur në to është një farsë e pakuptimtë; dhe dita e Pashkës kujton një ngjarje të pandodhur.

Por nëse u ringjall...

Rrjedhimet pozitive janë edhe më të mëdha. Jezui pohoi qartësisht se Perëndia është Krijuesi i gjithë realitetit⁴⁶. Ai nënvizoi veçanërisht kredon kryesore se Perëndia është sovran në mënyrë unike dhe që s'ka të tjerë si ai mbi gjithë krijimin e tij⁴⁷. Ai vishte plotësisht integritetin dhe autoritetin hyjnor të Dhiatës së Vjetër⁴⁸.

Ai konfirmoi vërtetësinë historike të ngjarjeve të regjistruara atje, duke përfshirë edhe ato që shpesh vihen në pikëpyetje nga skeptikët⁴⁹. Ai nënvizoi autoritetin e dhënë nga Perëndia të profetëve të Dhiatës së Vjetër⁵⁰. Ai në mënyrë unike pohoi se ishte përmbushja e gjithë profecive rreth një Mesie që do të vinte⁵¹. Ai në mënyrë të përsëritshme mësonte se çdo person që ka jetuar do të japë llogari moralisht dhe frymërisht te Perëndia në ditën e një gjykimi të fundit⁵².

Kjo na ndihmon të sqarojmë një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, se çdo diskutim rreth integritetit, saktësisë, pagabueshmërisë apo autoritetit të Biblës lidhet drejtpërdrejt me ringjalljen e Jezuit prej të vdekurish. Ringjallja e tij konfirmon të qenit hyjni; të qenit hyjni garanton të vërtetën e mësimit të tij; dhe mësimi i tij vërteton se Shkrimi është “fjala e gjallë dhe e përjetshme e Perëndisë”⁵³. Lidhja është e qartë.

Pohimi i T. H. Huxley se besimi nuk është më në kontakt me fakte, të çfarëdo lloji, është më keq se “diçka që i ka dalë lezeti”, dhe që Richard Dawkins të pohojë se shkenca është e lirë nga “vesi” i besimit, do të thotë të zëvendësojë realitetin me retorikën. Shkenca e vërtetë dhe feja e vërtetë biblike përfshijnë si besimin ashtu edhe faktet, dhe nuk janë kundërshtarë, por aleatë, duke u kombinuar për të na dhënë një pikturë të vërtetë të realitetit.

Fizikani britanik William Henry Bragg ishte kryeanëtar i një skuadre unike kur, më 1915-n, ai dhe i biri William Lawrence Bragg fituan çmimin “Nobel” në fizikë për punën e tyre vendimtare në kristalografinë e rrezeve X. Në një leksion në Institutin Mbretëror në Londër, katër vjet

më pas, ai pohoi: “Ndonjëherë njerëzit pyesin nëse feja dhe shkenca janë kundër njëra-tjetrës. Ato janë në po atë kuptim që janë përballë njëri-tjetrit gishti i madh i dorës dhe gishtërinjtë e tjerë të dorës sime. Është një kundërshti me anë të së cilës çdo gjë mund të kapet dhe kuptohet”.

Albert Anjshtajni përdorte një metaforë tjetër të gjallë për të thënë të njëjtën gjë: “Nuk mund të ekzistojë një konflikt legjitim ndërmjet shkencës dhe fesë. Shkenca pa fenë është sakate; feja pa shkencën është e verbër”⁵⁴.

6.

Kokëkunguj përtacë?

Kur dërgoi përshëndetje për 100-vjetorin e Shoqatës së Shtypit Racional, Peter Atkins bëri një dallim mes asaj që ai e quante një kërkim racional (shkencor) dhe joracional (fetar) për të vërtetën dhe pohonte se ky i fundit i çonte të mashtruarit të “zhyteshin në rehatinë e rreme të pritshmërive dhe vetëmashtrimin e shtirur të maskuar si një kuptim”¹. Në një artikull për revistën “*Free Inquiry*”, ai vazhdonte me temën e tij: “Shkenca e respekton fuqinë e intelektit njerëzor; feja ia ul... shkenca po përparon me sukses drejt njohurisë së plotë, duke i lënë fetë të ngelin pas. ... Feja është spekulim i të paditurve, i përshtatur mirë për të dhjamosur trurin”². Gjatë një debati në Oksford, në vitin 1998, të cilit i jemi referuar më parë në këtë libër, ai e quajti fenë “jashtë mode e qesharake” dhe pohoi se “nuk ishte e mundur të besojë në perëndi dhe të ishte një shkencëtar i vërtetë”³. Nga kjo nuk është e vështirë të kuptojmë se nga vjen ai, dhe në një recension të “*Darwin’s Black Box*” (“Kutia e Zezë e Darvinit”) ai e thelloi sulmin e tij duke e quajtur Perëndinë “ky trillim jokompetent i imagjinatave të varfëruara”⁴.

Këto janë akuza të rënda, prandaj, nëse Atkins ka të drejtë, e vetmja mënyrë kuptimplotë për të kërkuar të vërtetën është të hedhim poshtë çdo ide rreth Perëndisë dhe të përqendrohemi në një propozim të nxjerrë nga racionalizmi shkencor, *por a ka të drejtë ai?* Shenja e parë se nuk ka të drejtë vjen kur krahasojmë rezultatet e dy pyetësorëve të shkencëtarëve të marra në Shtetet e Bashkuara gjatë një kohëzgjatjeje

prej tetëdhjetë vjetësh. E para u bë më 1914-n nga akademiku amerikan James Leuba dhe tregonte që rreth 40% e atyre që u intervistuan thanë se besonin në Perëndinë⁵. I dyti, i përshtatur për të qenë i ngjashëm me propozimin e Leuba-s, u drejtua nga “Nature”, më 1996-n, dhe dha pothuajse rezultate identike⁶. Duke komentuar vëzhgimin e vitit 1996, Peter Atkins ende i mbahej pohimit të vet thelbësor: “Është e qartë se ti mund të jesh një shkencëtar dhe të kesh besime fetare. Por nuk mendoj se mund të jesh një shkencëtar i vërtetë në kuptimin e thellë të fjalës”⁷.

Kjo duket se ndryshon me faktin që studimi i marrëdhënies midis shkencës dhe teologjisë është një prej fushave akademike me rritje të shpejtë në botë, me organizata shkencëtarësh të përkushtuar për t'i besuar Perëndisë që po lulëzojnë në shkallë të paparë. Në Shtetet e Bashkuara, Dega Shkencore Amerikane ka rreth 2,500 anëtarë nga pjesa më e madhe e pesëdhjetë shteteve të kombit dhe nga dyzet vende të tjera. Gjithashtu, me bazë në Shtetet e Bashkuara, Shoqata e Kërkimit të Krijimit, që i përkushtohet një pikëpamjeje biblike, ka një anëtarësi ndërkombëtare prej rreth 1,750 personash, ku të gjithë anëtarët votues kanë të paktën një gradë të fituar pasuniversitare në një fushë të njohur të shkencës. Në Britani, mbi 5,000 doktorë janë anëtarë të Bashkësisë së Krishterë Mjekësore, e cila ka 1,000 anëtarë studentë dhe lidhje aktive me disa organizata të ngjashme kudo në botë. Gjithashtu, në Britani, Të Krishterët në Shkencë ka mbi 600 anëtarë, duke përfshirë disa shkencëtarë të njohur me përvojë. Mbi 150 shkencëtarë me doktoratura dhe 300 shkencëtarë të tjerë me grada master janë anëtarë të Shoqatës Koreane të Kërkimit të Krijimit, qëllimi i së cilës është “ta shohë shkencën t'i kthehet pozitës Perëndilavdëruese që meriton”. Të radhis organizatat e shumta të ngjashme që po lulëzojnë në të pesë kontinentet, anëtarët e të cilave janë besimtarë të përkushtuar në fusha të specializuara, që nga astronomia deri te zoologjia, do të zinte shumë hapësirë në një libër të kësaj përmase, por vetëm numrat e tyre dhe cilësia duket se janë provë *prima facie* kundër pohimit të Peter Atkins se është e pamundur të jesh “një shkencëtar i mirëfilltë” (ose “shkencëtar i vërtetë”) dhe të besosh te Perëndia.

Historia thotë...

Pohimi i tij nuk përputhet me asnjë shqyrtim të ndershëm të ngritjes së shkencës moderne. Edhe pse termi “shkencëtar” nuk përdorej deri më 1834-ën, koncepte si argumenti nga skicimi (që do të thotë se universi tregon shenja të skicimit, prandaj duhet të ketë një Skicues) vijnë që prej mijëra vjetësh më parë. Bibla cakton disa parime shumë të qarta këtu. Për të cituar vetëm një shembull, një shkrimtar i Dhiatës së Vjetër i drejtohet Perëndisë në këtë mënyrë:

Së lashti, ti ke vendosur tokën,
dhe qiejt janë vepër e duarve të tua;
ata do të zhduken, por ti do të mbetesh;
do të konsumohen të gjithë si një rrobe;
ti do t'i ndërrosh si një rrobe dhe ata do të ndryshohen.
Por ti je gjithnjë po ai, dhe vitet e tua
nuk do të kenë kurrë fund⁸.

Shkenca, ashtu siç e njohim tani, filloi të ekzistonte në shekujt XVI e XVII, dhe ndodhi në një kulturë ku në qendër ishte Perëndia, e shtyrë nga bindja biblike se natyra ka një krijues hyjnor dhe të përjetshëm që varet plotësisht prej tij. Kjo ishte krejtësisht e ndryshme nga një pikëpamje pagane, me llojet e veta ekzotike të hyjnive, duke përfshirë diellin, hënën dhe yjet, të cilët vetë ishin pjesë e universit material. Ashtu si Reijer Hooykaas, profesor i Historisë së Shkencës në Universitetin e Utrecht, vuri në dukje, tabloja biblike na tregon që “... në kundërshtim të plotë me fenë pagane, natyra nuk është një hyjni për t’u patur frikë dhe për t’u adhuruar, por një vepër e Perëndisë për t’u admiruar, studiuar dhe për t’u marrë në kontroll”⁹.

“U. S. News & World Reprot” e quante dr. John Baumgardner “ekspertin më të shkëlqyer në botë në skicimin e modeleve të kompjuterave për konveksion gjeofizik”¹⁰. Modeli i tij kompjuterik tridimensional për brendësinë e Tokës njihet si modeli kompjuterik më i aftë në llojin e tij në botë, prandaj NASA e sheh atë si shkencë pararojë në këtë fushë. Në një intervistë të dhënë më 1997-n, dr. Baumgardner tha: “Unë besoj se shkenca, ashtu siç e besojmë tani, është prodhim

i pikëpamjes së krishterë. Shkenca u zhvillua dhe besoj se mund të zhvillohej vetëm në botën e krishterë. Për shembull, në pikëpamjen budiste apo hinduiste ky realitet fizik konsiderohet pak a shumë si një iluzion dhe që nuk paraqet realitet absolut. Sigurisht, të krishterët nuk e konsiderojnë këtë botë si të përjetshme, por megjithatë është reale. Shkenca rodhi nga mënyra se si të krishterët e kuptonin Perëndinë dhe se si të krishterët e kuptonin botën natyrore”¹¹.

Bindje të tilla furnizuan lëshimin eksploziv të shkencës moderne. Kur Shoqëria Mbretërore, e cila pohon se është shoqëria më e vjetër që mësohet se ekziston ende, filloi si e tillë në vitin 1660, themeluesit e saj ia dedikuan punën e tyre “lavdisë së Perëndisë”. Manifesti i Shoqatës Britanike për Përparimin e Shkencës, i hartuar më 1865-n dhe i firmosur prej 617 shkencëtarësh, duke përfshirë shumë me diploma të shquara, shprehën besim të qartë në të vërtetën dhe autoritetin e Biblës dhe harmoninë e saj me shkencat natyrore. Këto janë dy ilustrime të shquara të botëkuptimit që mbizotëronin shtytjen e mendimit shkencor në atë kohë. Ashtu si thotë autori amerikan Henry Morris: “Historianët dhe filozofët më të mprehtë të shkencës kanë dalluar se vetë ekzistenca e shkencës moderne e kishte origjinën në një kulturë të paktën formalisht të përkushtuar ndaj një baze biblike dhe në një kohë në histori të shënuar nga një kthim i madh në besimin biblik”¹².

Holli i famës

Mbi tre shekuj e gjysmë që nga ajo kohë, shkencëtarë të panumërt, në gjithë disiplinat shkencore, i janë përkushtuar një botëkuptimi që shikon një univers që shkon sipas një rendi të caktuar që i bindet ligjeve të varura të vendosur nga një Krijues transhendent, i cili e ka zbuluar veten në faqet e Biblës.

Shumë nga këta njerëz kanë dhënë kontribute jashtëzakonisht të mëdha dhe ndonjëherë përcaktuese në disiplinat e tyre të veçanta. Emrat dhe numrat në vetvete nuk janë ndonjë kriter për të vërtetën dhe as nuk duhet të mbështetemi në një grumbull nderimesh për të vërtetuar një çështje, por ka shembuj të mjaftueshëm për ta rrëzuar pohimin se feja ia ul fuqinë intelektit. Shkenca ka parë kaq shumë

pionierë që kishin druajtje ndaj Perëndisë, saqë problemi nuk është të fillosh, por kur të ndalosh. Ajo që do të pasojë është kryesisht një vëzhgim historik, por statusi i shkencëtarëve të pëfshirë dhe cilësia e përhershme e punës së tyre janë jashtë diskutimit. Të marra së bashku, prova e bën të qartë si kristali se fillesat e mendimit shkencor u siguruan nga njerëz të besimit, të cilët kishin një drejtim mendimi që shumë njerëz të përfshirë tani në shkencë e kanë humbur. Ne do të flasim për dymbëdhjetë prej këtyre gjigandëve si përfaqësues për të gjithë.

Edhe pse tani është më shumë i njohur për pikturat e tij madhështore, (edhe pse la mbrapa vetëm një dorë veprash të përfunduara), gjeniu italian *Leonardo da Vinci* (1452-1519) ishte gjithashtu “një shkencëtar eksperimental shumë para formulimit të të ashtuquajturës metodë shkencore”¹³. Ai la prova të veprës prodhimtare në lëndë sa të ndryshme, aq edhe dinamike: anatomi, fizikë, optikë, biologji, fiziologji, hidraulikë, gjeometri, arkitekturë, mekanikë dhe aeronautikë. Vepra e Da Vincit ishte më e përparuara në kohën kur ai jetoi. Megjithatë, paralelisht me këtë larmi të mahnitshme talenti, ishte besimi i tij i përkushtuar në Perëndinë dhe në Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e botës, të shprehur fuqishëm në “*Darka e fundit*”, vepra e tij më e njohur e artit.

Ashtu siç e pamë në kapitullin 3, filozofi, shkencëtari dhe politikani *Francis Bacon* (1561-1626) dha një kontribut të pamasë në shkencë me zhvillimin e metodës induktive, duke i vënë theksin rëndësisë së vëzhgimit dhe eksperimentit. Bacon nuk pa as edhe konfliktin më të vogël ndërmjet Biblës dhe shkencës natyrore: “Para nesh ndodhen dy libra për t’u studiuar, që të na parandalojnë të biem në gabim; i pari, vëllimi i Shkrimit, i cili zbulon vullnetin e Perëndisë; pastaj vëllimi i Krijesave, i cili shpreh fuqinë e tij”¹⁴. Kjo bindje e shoqëroi atë gjatë gjithë karrierës së tij të jashtëzakonshme, dhe aty nga fundi i jetës së tij ai shkroi: “Asnjë të mos mendojë ose të pohojë se dikush mund të kërkojë aq larg, ose të ketë studiuar shumë mirë në librin e fjalës së Perëndisë apo në librin e veprave të Perëndisë”¹⁵. Duke parë zhvillimet e mëvonshme, është ironike që Çarls Darwin i riprodhoi këto fjalë në fletëlidhësen e “Origjinës”!

Shkencëtari gjerman *Johannes Kepler* (1571-1630) bëri punë të rëndësishme në optikë, zbuloi dy poliedra të reja të rregullta (figura të ngurta me shumë faqe të njëjta), dha provën e parë se si punonte

logaritmi, llogaritit tabelat e sakta astronomike që ndihmuan për të themeluar astronominë heliocentrike dhe dha kontributin e vet në zbulimin e mëpasëm të kalkulusit. Ai kujtohet më shumë për zbulimin e tri ligjeve të lëvizjes së planetëve që tani mbajnë emrin e tij. Për pasojë, i quajtur “astrofizikani i parë teorik” dhe që tani pranohet universalisht si babai i astronomisë fizike, Kepler e pa gjithë veprën e tij si përmbushje të detyrës së tij të krishterë. Është e famshme thënia e tij se ai vetëm “sa po mendonte mendimet e Perëndisë pas tij”, dhe një herë u lut: “Unë të falënderoj ty, Krijues e Perëndi, që më ke dhënë këtë gëzim në krijimin tënd dhe ngazëllohem në veprat e duarve të tua”. Një herë tjetër shkroi: “Përderisa ne astronomët jemi priftërinjtë e Perëndisë më të lartë në lidhje me librat e natyrës, na shkon për shtat që të jemi të kujdesshëm, jo për lavdinë e mendjeve tona, por, përkundrazi, mbi gjithçka tjetër, për lavdinë e Perëndisë”¹⁶.

Matematikani, filozofi dhe shkencëtari francez *Blaise Pascal* (1623-1662) me të drejtë mund të quhet gjeni. Në moshën 12-vjeçare ai vërtetoi vetë disa nga teoremat e Euklidit. Kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, libri i tij mbi seksionet konike u pranua si përparimi më i madh në gjeometri që nga kohët e grekëve të lashtë dhe, tre vjet më vonë, ai shpiku një makinë llogaritëse. Më vonë, ai punoi në fushat e mekanikës atmosferike dhe fluide, hidrostatikë dhe matematikë. Përfundimet që u arritën së bashku me matematikanin e shquar francez *Pierre de Fermat* formuan bazën e sigurimit modern dhe teorisë së probabilitetit, dhe në një lulëzim përfundimtar ai ishte i pari në ngritjen e një sistemi transportues publik për Parisin!

Sikur kjo të mos mjaftonte, shkrimet e tij mbi tema të tjera ishin kaq të njohura, saqë thuhej se “e kishin ngritur prozën franceze në lartësi të reja të formës dhe fuqisë”¹⁷. Në të gjithë këtë, besimi i krishterë i Pascal-it ishte pasioni i tij mbizotërues, që e bënte atë të shkruante: “Jo vetëm që e njohim Perëndinë vetëm përmes Jezu Krishtit, por ne as që e njohim veten veçse nëpërmjet Jezu Krishtit”¹⁸. Si qëllim të vetëm të jetës dhe punës së tij ai shihte të dhënit lavdi Perëndisë. Pak para se të vdiste, ai u lut: “Bëj që të mund t’i nënshtrohem vullnetit tënd kështu si jam, që, i sëmurë si jam, të mund të të lartësoj ty në vuajtjen time”¹⁹.

Kimisti irlandez *Robert Boyle* (1627-1691) ishte fëmija i katërmëdhjetë dhe i fundit i *Richard Boyle*, konti i *Cork*, për të cilin thuhej

se ishte njeriu më i pasur i ishujve britanikë. I arsimuar në Angli, Francë dhe Zvicër, Boyle fitoi një reputacion të shkëlqyer për punën e tij në mekanikë, mjekësi dhe hidrodinamikë, por kimia ishte interesi i tij kryesor, prandaj saktësia e tij në përkufizimin e elementeve kimike dhe reaksioneve kimike ishte një hap i rëndësishëm në ndarjen e shkencës së kimit nga alkimia, pararendësi i saj mesjetar.

Ai dha një kontribut të madh në zhvillimin e mendimit kimik modern, trashëgimia e tij e mirënjohur Ligji i Boyle, i cili përcaktonte marrëdhënien ndërmjet presionit, temperaturës dhe vëllimit të një mase gazi. Mbi të gjitha, Boyle ishte një i krishterë i përkushtuar. Ai ishte kaq i interesuar për të njohur dhe kuptuar Biblën, sa që në një vit të vetëm mësoi në mënyrë autodidakte katër gjuhë, në mënyrë që ta ndihmonin për ta bërë këtë. Ai përkushtoi kohë, energji dhe një sasi të konsiderueshme parash, për ta patur Biblën të përkthyer dhe për ta shpërndarë në irlandisht, turqisht dhe në disa gjuhë vendase amerikane. Duke mos menduar se mësimi i Biblës përplasej me zbulimet shkencore, ai pohonte vazhdimisht “e vërteta e historisë së Shkrimit”²⁰ dhe, një herë, shkroi se “kontradiktat në dukje ndërmjet Hyjnisë dhe filozofisë së vërtetë” ishin të pakta “dhe se kontradikta të vërteta as që nuk kishte”²¹. Krah të shkruarit të mbi dyzet librave që e bënë shkencën të njohur, ai kishte si synim të përfundonte një vepër madhore që kundërshtonte ateizmin, por vdiq para se dorëshkrimi të përfundonte. I përshkruar në gurin e varrit si “ati i kimit” dhe një prej themeluesve të Shoqërisë Mbretërore, Boyle nuk pa ndonjë kontradiktë ndërmjet shkencës dhe besimit të tij të krishterë. Në mesazhin e fundit drejtuar shoqërisë, ai i nxiti bashkëshkencëtarët e tij: “Mos harroni t’i jepni lavdi atij që ishte autor i natyrës”²².

Një prej bashkëkohësve të Boyle ishte natyralisti, filozofi dhe teologu *John Ray* (1627-1705). I diplomuar në Kembrixh, Ray u bë ekspert në gjuhë, matematikë e shkenca natyrore dhe ishte autoriteti më i lartë në kohën e tij si në botanikë ashtu edhe në zoologji. Krah eksperimenteve që bëri në embriologji dhe fiziologjinë e bimëve (ai ishte i pari që vërtetoi se druri i një peme të gjallë përçon ujë), ai botoi vepra sistematike mbi bimët, zogjtë, gjitarët, peshqit dhe insektet, klasifikimi i bimëve i të cilit u bë i pari që i ndante bimët me lule në njëthelbore dhe dythelbore. I përshkruar në *Fjalorin e Biografisë*

Kombëtare si “ati i historisë natyrore angleze”, Ray u caktua si prift i Kishës së Anglisë dhe po ashtu u pranua zyrtarisht në Shoqërinë Mbretërore në njohje të veprës së tij të shquar shkencore. Ai nuk pa asnjë përplasje ndërmjet të dy pozicioneve. Nga fundi i jetës shkroi dy vepra të mëdha teologjike “*The Wisdom of God Manifested in the Works of Creation*” (“Urtësia e Perëndisë e manifestuar në veprën e krijimit”) dhe “*Three Physico-Theological Discourses*” (“Tri bisedime fiziko-teologjike”). E para, e përkthyer në disa gjuhë të huaja dhe e ribotuar për mbi pesëdhjetë vjet, i qartësonte bindjet e tij: “Nuk ka për një njeri të lirë preokupim më të vlefshëm dhe më të kënaqshëm sesa të mendojë për veprat e bukura të natyrës dhe të nderojë urtësinë dhe mirësinë e pafundme të Perëndisë”²³.

Matematikani dhe filozofi anglez sër *Isak Njuton* (Isaak Newton) (1642-1727) ishte një kolos i shkencës, i cili kapërceu shekujt XVII e XVIII dhe që përgjithësisht njihet si një prej shkencëtarëve më të mëdhenj që ka jetuar ndonjëherë. Ai njihet më shumë për zbulimin e ligjit të rëndesës universale (që supozohet se është frymëzuar nga rënia e një molle), por, gjithashtu, ai formuloi tri ligjet e lëvizjes, të cilat ishin bazë për mekanikën klasike, zhvilloi teorinë e grimcës për përhapjen e dritës, ndërtoi teleskopin e parë reflektues, dha leksione mbi optikën, botoi një ligj të termodinamikës, që tani njihet si “Ligji i Ftohjes së Njutonit”, dhe ka meritë bashkë me matematikanin gjerman *Gottfried Leibnitz* për zhvillimin e kalkulusit diferencial, që tani është një mjet bazë shkencor. Si student i devotshëm i Biblës, ai tha: “Ne e quajmë Shkrimin e Perëndisë si filozofinë më sublime. Unë gjej më shumë shenja të sigurta të vërtetësisë në Bibël, sesa në ndonjë histori profane çfarëdo”²⁴. Në veprën e tij më të madhe “*Philosophiae Naturalis Principa Mathematica*” e shkruar për të bindur njerëzit “për besimin e një Hyjnie”, ai tha: “Pa asnjë dyshim, kjo botë... nuk mund të ngrihej nga asgjë, përveç vullnetit të lirë të Perëndisë”²⁵.

Shkencëtari suedez *Carolus Linneaus* (1707-1778), i stërvitur për shërbesën e krishterë, vazhdimisht ishte i tërhequr në drejtime të tjera. Ai studioi mjekësi në Universitetet e Lund dhe Uppsala, por, edhe pse e praktikoi mjekësinë për disa vjet, dhe që së fundi u bë profesor i mjekësisë në Uppsala, ai nuk mund t’i shpëtonte një interesi konsumues në botanikë. Dëshira e tij më e madhe ishte të jepte një

sistem klasifikimi të detajuar për bimët dhe kafshët, prandaj shkoi deri në largësi të jashtëzakonshme për ta hartuar atë. Edhe pse synimi i tij për të klasifikuar çdo specie të gjallë në gjithë botën ishte në mënyrë të dukshme përtej tij, arritjet ishin të tilla, sa që ai është bërë i njohur si “ati i taksonomisë biologjike”. Shoqëria Linnean e Londrës, e themeluar në nder të tij, u bë pika qendrore e të mbledhurit të natyralistëve të shquar të shekullit XIX, dhe sistemi i tij i klasifikimit është ende në përdorim standart sot. Lineaus ishte një besimtar i vendosur në krijimin e veçantë e në qëndrueshmërinë e specieve dhe veprat e tij gëlojnë nga referencat për Perëndinë. Një herë ai shkroi: “Dikush shtanget plotësisht nga burimshmëria e pabesueshme e Krijuesit... Ndoqa gjurmët e tij në fushën e natyrës dhe pashë kudo një fuqi dhe urtësi të përjetshme, një përsosmëri të papërshkrueshme”²⁶.

Duke vazhduar më tej me...

Kimisti dhe fizikani anglez *Michael Faraday* (1791-1867), një shkencëtar tjetër me prodhimtari të lartë, na çon në shekullin XIX. Edhe pse duket se ka pasur pak ose aspak arsimim formal, ai ishte një lexues i uritur i literaturës shkencore dhe në fund do të zbulonte induksionin elektromagnetik (i cili hapi rrugën për prodhimin dhe përdorimin industrial të elektricitetit), efektin magneto-optikues diamagnetizmin dhe teorinë e fushës. Si shkencëtar i eksperimental më kryesor i kohës së tij, prezantoi gjithashtu konceptin e vijave magnetike të forcës, shpiku dinamon dhe formuloi ligjin e dytë të elektrolizës. I zgjedhur në Shoqërinë Mbretërore dhe së fundi i vlerësuar me medalje Royal dhe Rumford, Faraday qëndron si gjigand në fushën e tij, prandaj sot dy njësi bazë, një në elektrolizë (faradei) dhe një në elektrostatikë (farad) kanë marrë emrin në nderim të tij. Ai kishte sens humori. Sipas legjendës, ai u përpoq t’ia shpjegonte një prej shpikjeve të tij kryeministrit ose ministrit të financave. Kur e pyetën “Por për çfarë shërben kjo?”, thuhet se Faraday u përgjigj: “Zotëri, ka të ngjarë që shumë shpejt ju do të vini një taksë për të!”. Edhe pse një forcë lartësuese në fushat ku ai ishte ekspert, besimi i fortë i krishterë i Faraday reflektohej në përvetësimin e tij, prandaj ai nuk pranoi as të merrte titullin kalorës, as të ishte president i Shoqërisë Mbretërore, duke ndier se këto ishin

nderime të papërshtatshme për një ndjekës të Krishtit. Ai predikonte rregullisht në kishën e tij dhe i jepej me gjithë zemër bazës së besimit e cila përfshinte pohimin: “Bibla, vetëm ajo, me asgjë që i shtohet, as që i merret prej njeriut, është udhëheqësi i vetëm dhe i mjaftueshëm për çdo individ, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë”²⁷. Thuhet se kur iu përgjigj dikujt që e pyeti në shtratin e vdekjes se cilat ishin spekulimet e tij, Faraday dëshmoi për besimin e tij në Perëndinë duke iu përgjigjur: “Spekulime? Nuk kam. Unë mbështetem në gjëra të sigurta”.

I pari prej shembujve tanë që u lind në shekullin XIX ishte fizikani anglez *James Joule* (1818-1889).

I sëmure me një çrregullim të shtyllës kurrizore që kur ishte i vogël, ai u arsimua në shtëpi deri në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, edhe pse për tre vjet pas asaj ai dhe vëllai i tij më i madh mësuan kimi, fizikë, metodën shkencore dhe matematikë nga kimisti i shquar anglez John Dalton, themeluesin e teorisë atomike moderne. Joule ishte i mahnitur nga marrëdhënia ndërmjet nxehtësisë, elektricitetit dhe punës mekanike dhe, më 1839-n, ai i prezantoi një gazetë Shoqërisë Mbretërore, “Mbi prodhimin e nxehtësisë nga elektriciteti voltaik”. Vepra e tij nuk u prit ngrohtë nga shoqëria dhe kudo, kryesisht sepse shkencëtarët nuk donin të pranonin saktësinë ekstreme të matjeve të tij. Dy përjashtime të shquara ndaj këtij skepticizmi ishin William Thomson (shih më poshtë) dhe Michael Faraday. Me inkurajimin e tyre, Joule i prezantoi një gazetë tjetër Shoqërisë Mbretërore më 1849-n, “Mbi ekuivalentin mekanik të nxehtësisë”. Shoqëria jo vetëm që e botoi gazetën, por e zgjodhi atë anëtar dhe më vonë e nderoi me Medaljen Copley, nderimin e vet më të vjetër dhe më të lartë. Ai u zgjodh dy herë President i Shoqatës Britanike për Përparimin e Shkencës.

Arritjet e Joule janë të shquara. Ai dha kontribut domethënës për të unifikuar seksionet e copëtuara të fizikës, ishte i pari që llogariti shpejtësinë e molekulave të gazit, ishte një prej shkencëtarëve të parë që kuptoi nevojën për një njësi standarte të elektricitetit, tregoi si të llogarisje nxehtësinë e prodhuar nga një korrent elektrik që lëviz nëpër një tel (që tani njihet si ligji i Joule), dhe me Thomson-in zbuloi se gazet humbasin nxehtësi kur përhapen në një vakum, një gjetje që çoi drejtpërdrejt në shpikjen e frigoriferit. Megjithatë, trashëgimia e tij më e madhe shkencore ishte kur demonstroi vlefshmërinë e

parimit të konservimit të energjisë. Kjo formoi bazën e Ligjit të Parë të Termodinamikës, që pohon se energjia as nuk mund të krijohet, as nuk mund të shkatërrohet, edhe pse mund të ndryshojë nga një formë në tjetrën, dhe përshkruhet si “një prej përgjithësimeve më të rëndësishme në historinë e shkencës”²⁸. Joule e bëri të qartë se oreksi i tij për njohuri shkencore hapej nga besimi i tij: “Pas njohurisë dhe bindjes ndaj vullnetit të Perëndisë, synimi tjetër duhet të jetë: të dimë diçka nga atributet e tij të urtësisë, fuqisë dhe mirësisë, ashtu si janë dëshmuar nga vepra e duarve të tij. Është e dukshme se një njohje me ligjet natyrore do të thotë jo më pak se një njohje me mendjen e Perëndisë, të shprehura në veprën e duarve të tij”²⁹. Diku tjetër, ai shkroi: “Fenomeni i natyrës, nëse është mekanik, kimik apo jetësor, varet pothuajse tërësisht nga një ndryshim i vazhdueshëm... në një tjetër. Kështu ndodh që mbahet rregulli në univers. Asgjë nuk del nga vendi i vet, asgjë nuk humbet asnjëherë, por e gjithë makineria, e ndërlikuar siç është, punon mirë dhe në harmoni... e gjitha që sundohet nga vullneti Sovran i Perëndisë”³⁰.

I lindur në Irlandën e Veriut, fizikani matematikan *William Thomson* (1824-1907) ishte një njeri me arritje befasuese. Ai u regjistrua në Universitetin Glasgow kur ishte vetëm dhjetë vjeç dhe dy vjet më vonë fitoi një çmim për përkthimin e “*Dialogje*” të Lucianit nga latinishtja. Në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, tashmë një gjeni adoleshent, ai shkoi në Kembrixh, ku u diplomua katër vjet më vonë. Ndërsa ishte ende atje, ai tregoi një interes të gjallë në letërsinë klasike, muzikë dhe letërsi, fitoi çmimin “*Silver Sculls*” (Lopatat e Argjenda) në vozitje me barka njëshe dhe ishte anëtar i ekuipazhit fitues në garën vjetore me varka midis Oksfordit dhe Kembrixhit. Pasi studioi teknika kërkuese në Francë, ai dha leksione në Kembrixh për një kohë të shkurtër, duke u bërë anëtar i Peterhouse, para se të zgjidhej profesor i Filozofisë Natyrore në Universitetin Glasgow. Ishte vetëm njëzet e dy vjeç dhe kishte botuar tashmë pesëdhjetë gazeta matematikore kryesisht në frëngjisht.

Ai e kombinonte të dhënit leksion me kërkim aktiv në një laborator që kishte ngritur në një qilar dhe interesat e tij ishin nxehtësia, elektriciteti dhe magnetizmi. Ai themeloi atë që tani njihet si shkalla Kelvin e temperaturës absolute, me emrin që është marrë nga titulli

Baroni Kelvin i Largs, që qeveria i dha atij në vitin 1892. Përfundimi i tij se “elektriciteti duhet të kuptohet jo si një aksident, por si një esencë e materies”, e çoi bashkëkohësin e tij James Clerk Maxwell (shih më poshtë) të zhvillonte teorinë e elektromagnetizmit. Thomson mbeti në postin e tij për pesëdhjetë e tre vjet, pastaj, pa u vonuar, u regjistrua si student kërkues, duke u bërë kështu jo vetëm një prej më të rinjve, por gjithashtu edhe një prej studentëve më të vjetër në historinë e universitetit.

Thomson kishte një rol kryesor në zhvillimin e Ligjit të Dytë të Termodinamikës, e teorisë dinamike të nxehtësisë dhe analizës racionale të elektromagnetizmit dhe bëri punë të rëndësishme në hidrodinamikë. Ai gjithashtu fitoi famë të madhe për skicimin dhe zhvillimin e galvanometrit pasqyrë, i përdorur në transmisionet pa shkëputje, të parët të suksesshëm, me anë të një kablli nënujor të shtrirë ndërmjet Irlandës dhe Newfoundland.

Më 1866, iu dha titulli kalorës. Ai botoi 661 gazeta mbi tema shkencore dhe kishte patentë për shtatëdhjetë shpikje. Me njëzet e një doktorata të fituara, thuhet se kishte merituar më shumë tituj se ndonjë tjetër në Komënuelthin Britanik. Ai u bë pjesë e Shoqërisë Britanike më 1851-shin, fitoi Medaljen Mbretërore më 1856-n, Medaljen Copley më 1883-shin dhe ishte presidenti i saj nga viti 1889 deri në vitin 1895. Ai gjithashtu shërbeu si president i Shoqatës Britanike për Përparimin e Shkencës dhe tri herë si president i Shoqërisë Mbretërore të Edinburgut.

Në gjithtë punën e tij teorike dhe praktike, Thomson mbeti një i krishterë i bindur dhe i hapur. Ai besonte se lidhja logjike mes natyrës dhe Shkrimit mund të përcaktohej me “siguri shkencore e të matur”³¹ dhe e shihte Perëndinë si “ai që mban e ruan krijimin e tij përmes ushtrimit të vullnetit të tij”³². Edhe pse Çarls Darvin e quajti atë “një spektër të urryer”, bindjet e tij mbetën të qarta: “Rreth nesh qëndrojnë prova të forta inteligjence dhe dizenjimi në mënyrë të papërmbajtshme”; “Unë besoj se, sa më shumë me kujdes të studiohet shkenca, aq më larg na çon nga ndonjë gjë të krahasueshme me ateizmin”; “Ideja ateistike është kaq shumë pa kuptim, saqë nuk mund ta shpreh me fjalë”³³.

I fundit në katalogun e gjigantëve pionierë është shkencëtari skocez *James Clerk Maxwell* (1831-1879), që tani njihet përgjithësisht si

ati i fizikës moderne. I arsimuar në shtëpi në vitet e para, ai shkoi në Universitetin e Edinburgut kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, edhe pse më vonë ai u transferua në Kembrixh. Ai ishte gjeni studioz dhe punonte deri natën vonë. Thuhet se, kur mbërriti në Kembrixh dhe i thanë se do të kishte një shërbesë të detyruar në kishë në orën gjashtë mbasdite, ai fërkoj mjekrën në mënyrë të mendueshme dhe u përgjigj: “Eh, mendoj se mund të qëndroj zgjuar aq vonë”! Më vonë, ai ishte caktuar për të qenë profesor në Kolegjin Marischal, Aberdeen, dhe Kolegjin Kings në Londër, para se të kthehej në Kembrixh si profesori i parë Cavendish i fizikës më 1871-shin. Pothuajse menjëherë ai u ul të planifikonte dhe të skiconte Laboratorin Cavendish të Fizikës, i cili tani ka një reputacion global si laborator i shkëlqyer.

Maxwell dha një kontribut të madh në termodinamikën klasike dhe statistikore, fizikë dhe matematikë. Puna e tij u përdor në mënyrë domethënëse në zbulime të mëvonshme, si teoria e relativitetit dhe teoria e kuantit; dhe duket se të gjithë bien dakord se e gjithë elektronika moderne mbështetet në ekuacionet matematikore të përpunuara nga Maxwell. Ai përcaktoi natyrën e gazrave, shprehu të gjitha ligjet themelore të dritës, elektricitetit dhe magnetizmit, siguroi mjetet për të krijuar epokën teknologjike, nga radio te radari dhe nga televizori te celulari, dhe bëri fotografinë e parë me ngjyra. Albert Anjstajni tha se Maxwell kishte prezantuar një epokë të re shkencore dhe se teoria e tij elektromagnetike ishte “më e thella dhe më frytdhënësja që fizika kishte përjetuar që nga koha e Njutonit”³⁴. Besimi i Maxwell-it në Perëndinë qëndron pas gjithë punës së tij; një herë ai shkroi: “Kam parë në sistemet më filozofike, po nuk kam parë ndonjë që do të punonte pa një Perëndi”³⁵. Ai shquhej për lutjet e shprehura në çast, nga të cilat të paktën njëra prej tyre është ruajtur: “Na mëso të studiojmë veprat e duarve të tua, që të mund ta vëmë tokën në përdorimin tonë dhe të forcojmë arsyen tonë për të të shërbyer ty”³⁶.

Duke mos dashur të mendoni se kemi gërmuar shumë për të gjetur këto dymbëdhjetë shembuj, ata nuk janë veçse një numër i vogël i një “holli fame” shumë më të madh. Më poshtë, do flasim shkurt për një dymbëdhjetë tjetër:

- Georgias Agricola, i njohur si ati i metalurgjisë.

- Johannes Baptista van Helmont, themeluesi i kimisë pneumatike.
- Francesko Grimaldi, i cili zbuloi përthyerjen e dritës.
- Antonie van Leeuwenhoek, e cila ishte e para që zbuloi bakteriet.
- Neils Steno, themeluesi i gjeologjisë moderne.
- John Dalton, themeluesi i teorisë atomike moderne.
- Louis Pasteur, themeluesi i fiziokimisë.
- Samuel Morse, shpikësi i telegrafit elektrik.
- John Herschel, një prej astronomëve më të mëdhenj ndonjëherë.
- Joseph Lister, i cili revolucionarizoi kirurgjinë antiseptike.
- Alexander Fleming, i cili zbuloi penicilinën.
- Mathew Maury, themeluesi i oqeanografisë moderne.

Secili prej njëzet e katër njerëzve të radhitur në këto faqet e fundit ishte një shkencëtar i shquar, i cili besonte se i gjithë universi është vepra krijuese e Perëndisë, se Bibla është Fjala e Perëndisë dhe se nuk kishte asnjë kontraditë ndërmjet njohurisë së tij shkencore dhe bindjeve të krishtera që kishin qenë të shqyrtuara me kujdes dhe se mund të pohoheshin në mënyrë të besueshme. Atëherë, çfarë mund të bëjmë me pohimin e Peter Atkins se shkenca dhe besimi te Perëndia nuk shkojnë krah për krah? A sugjeron ai se asnjë prej këtyre njerëzve të shquar nuk e përmbushin kriterin e tij për të qenë “një shkencëtar i vërtetë”? E vetmja alternativë duket se është pohimi se, edhe pse shkenca e tyre ishte e shkëlqyer, ata humbën kontaktin me realitetin në mënyrë të mistershme sapo iu kthyen fesë. As pohimi i tij se feja është “spekulim i të paditurve, i përshtatur mirë për të dhjamosur trurin”, nuk gjen ndonjë besueshmëri në këto dëshmi. Fjalorët e përkufizojnë fjalën “dhjamor” si “i shëndoshë”, “me dhjam” ose “i përdorur për ruajtjen e dhjavit”. Duke qenë se çështja nuk ka të bëjë me përmasën, e vetmja e dhënë tjetër që kemi është fraza “spekulim i të paditurve”, që duket se i referohet të menduarit përtac ose të pakujdesshëm. A po thotë ai vërtet se këta gjigantë ishin kokëdhjamur përtacë? Duke i dhënë Atkins gjithë lejen që fjalët e tij do të lejojnë, pohimet e tij duket se rrjedhin më shumë prej retorikës paragjykuese sesa nga arsyetimi

parimor. Për Richard Dawkins, ta quash besimin “bestytini që të budallalleps”³⁷ është të jesh në kundërshtim me provën.

Përditësim

I fundit i këtyre njëzet e katër gjigantëve vdiq në mes të shekullit XX, por pozicioni sot, në mënyrë esenciale, nuk është i ndryshëm. Në gjithë botën ka shkencëtarë të shquar të cilët janë njerëz të Perëndisë ashtu si edhe njerëz të shkencës. Dy mendimtarë modernë kanë shkruar edhe më tej: “Një numër domethënës shkencëtarësh, historianë të shkencës dhe filozofë të shkencës shohin më shumë prova shkencore tani për një krijues dhe dizenjues, se sa ishte e mundur pesëdhjetë vjet më parë. Në dritën e kësaj prove, është e rreme dhe naive të pohosh se shkenca moderne ka besuar në të paarsyeshmen mbinatyrore”³⁸. Do të lejojmë dy shkencëtarë të shquar, në disiplina shumë të ndryshme, që të flasin për gjithë ata.

Raymond Jones është një shkencëtar bujqësor i njohur. Anëtar i Institutit Australian të Shkencës Bujqësore, Akademisë Australiane të Shkencës dhe Inxhinierisë Teknologjike dhe Shoqërisë Tropical Grasslands të Australisë, ai ka botuar rreth 140 gazeta kërkimi dhe është nderuar me çmimin “Urrbrae” dhe medaljen e artë “CSIRO” për shkëlqim në fushën e kërkimeve.

Fama e Jones lidhet veçanërisht me zgjidhjen që i dha një problemi të pazakontë dhe të kushtueshëm. Pema si shkurre *Leucaena* është një bishtajë e ushqyeshme që mbetet e përshtatshme për kullotje edhe në stinë të thatë, por përmban një helm që i sëmuri kafshët australiane. Jones zbuloi se kjo nuk ndodhte në vende si Havai dhe Indonezi, prandaj sugjeroi se, ndoshta, ato kishin bakterie të ndryshme në plëndës, një “stomak” i veçantë ku bëhej paratretja e ushqimit të kafshëve. Shkencëtarë të tjerë u tallën me këtë ide, por, kur lëngu nga plëndësi i dhive nga Indonezia u transferua te të tjerët nga Australia, u deshën vetëm dy ditë për ta vërtetuar teorinë e tij. Së fundi, mikrobe nga dhinë e izoluar në Havai dolën se ishin të reja për shkencën dhe u quajtën *Synergistes jonesii* në nder të tij. Zbulimi i tij vlen miliona dollarë në vit për Australinë, prandaj kursimet po rriten që nga ai vit.

Në vitet e tij të para Jones ishte një evolucionist i vendosur, por, ndërsa ishte në universitet, besimi i tij u trondit nga fakti që nuk mund të gjente provë për shumicën e formave të ndërmjetme që duhet të ekzistojnë nëse evolucioni ishte i vërtetë. I pyetur në një intervistë nëse evolucioni kishte vlerë të madhe praktike, Jones u përgjigj: “Gjatë përvojës sime nuk e kam parë kurrë këtë. Shumë shkencëtarë mund të spekulojnë në gazetatat e tyre se si një rezultat i caktuar lidhet me evolucionin, por nuk mendoj që ajo është forca shtytëse që bën të mundur zbulimet apo që luan shumë rol në punën e pjesës më të madhe të shkencëtarëve. A të ndihmon në kërkim të paturit e një paradigme evolucionare? Nuk mendoj. Në fakt, të besosh më shumë në një Perëndi të plotfuqishëm, sesa në rastësi, përtej çdo gjëje, mund të të japë më shumë shtysë në punën tënde shkencore. Të jep vetëbesim se diçka do të gjendet kur të kërkosh, sepse mbrapa gjithë asaj është një mendje më e madhe se e jotja”³⁹.

Francis Collins u trajnua si kimist fizik, pastaj shkoi në shkollë mjekësore dhe u bë mjek. Ekspert në gjenetikën e sëmundjeve njerëzore, ai ishte pjesë e skuadrës që identifikuan gjenet me të meta në fibrozën cistike, sëmundjen e Huntingtonit dhe neurofibromatozën. Tani ai është drejtor i Laboratorit Kombëtar për Kërkimin e Gjenomit Njerëzor në Amerikë, që luan rolin udhëheqës në Projektin e Gjenomit Njerëzor, ndoshta projekti më i rëndësishëm biologjik sot. Ai thotë se, rreth të njëzetave, ishte “një ateist i padurueshëm”, por në moshën njëzeteshtatëvjeçare ai u bë i krishterë i bindur dhe i përkushtuar, kryesisht përmes shkrimeve të C. S. Lewis.

Gjatë një interviste, Collins tha: “Mendoj se është diçka domethënëse që kemi një dialog kuptimplotë mes njerëzve të besimit dhe njerëzve të përfshirë në shkencë, prandaj do të ishte bukur nëse disa prej tyre të ishin të njëjtët njerëz. Nuk shoh ndonjë arsye që të mos ndodhë kjo. Në fakt, si shkencëtar, aspektet fetare të jetës sime besoj se i japin kuptim shtesë asaj që unë bëj në shkencë”. Kur e pyetën për të thënë diçka më tepër, ai u përgjigj: “Si gjenetist, jam në situatën, sidomos me revolucionin që po ndodh në gjenetikë, që po vëzhgoj gjëra të reja gjithmonë. Duke drejtuar projektin e gjenomit, vështirë se kalon një javë ku nuk zbulohet ndonjë gjen që luan rol kritik në të kuptuarit e një sëmundjeje që deri tani ka qenë plotësisht e errët. Kjo është

një përvojë e shënuar, veçanërisht nëse ke rastin të jesh pjesë e çastit të zbulimit, të cilin e kam patur në disa raste. Për mua, si njeri që besoj, ai çast zbulimi ka një dimension më tepër. Është të vlerësosh diçka, të kuptosh diçka, të dish diçka që deri atë çast asnjë njeri nuk e ka ditur, por Perëndia e dinte. Ka një kompleksitet dhe elegancë në natyrën e biologjisë, veçanërisht kur bëhet fjalë për kapacitetin informacionbartës të ADN-së, që është disi e mahnitshme. Ka një sens në të cilin ato çaste zbulimi bëhen gjithashtu çaste adhurimi, çaste vlerësimi të kompleksiteteve dhe bukurisë së biologjisë, të botës, të jetës, prandaj edhe një vlerësim për Perëndinë si Krijues”⁴⁰. Diku tjetër, ai shkroi: “Nga të gjitha zgjedhjet, ateizmi kërkon besimin më të madh, sepse kërkon që magazina e kufizuar e njohurisë njerëzore të jetë e mjaftueshme për të përjashtuar mundësinë e ekzistencës së Perëndisë”⁴¹.

Fjalët e fundit të këtij kapitulli ia lëmë Colin Russell, profesor i Shkencës dhe Teknologjisë në Universitetin Open: “Të portretizosh doktrinat e krishtera dhe ato shkencore si vendosmërisht në konflikt, jo vetëm që nuk është e saktë historikisht, por është, në të vërtetë, një karikaturë kaq e madhe, saqë ajo që duhet të shpjegohet është se si ky pohim mund të ketë arritur ndonjë shkallë respektueshmërie...”⁴²

7.

Përtej shkencës

Profesor David Horrobin, i cili vdiq më 2003-shin, është përshkruar si “një prej mendjeve më origjinale të brezit të tij”¹. Me dy tituj në mjekësi dhe një doktoratë në neuroshkencë, ai dha mjekësi në kolegjin Magdalen në Oksford, atëherë ishte profesor i Fiziologjisë Mjekësore në Universitetin e Nairobit në Kenia para se të kthehej në Mbretërinë e Bashkuar, për t’u bërë Lektor i jashtëm në Fiziologjinë Mjekësore në Universitetin e Newcastle. Tre vjet më vonë, ai u bë profesor i Mjekësisë në Universitetin e Montrealit. Më 1979, ngriti një kompani farmaceutike që do të bënte zbulime historike brenda dy teknologjive (lipideve dhe terapisë fotodinamike) në fushën e kancerit, dermatologjisë dhe diabetit. Tetëmbëdhjetë vjet më vonë, në mënyrë që të përqendrohej në kërkimin në psikiatri, ai dhe gruaja e tij ngritën një kompani tjetër që bënte ilaçe për çrregullime psikiatrike dhe neurodegeneruese si: sëmundja e Huntington, depresioni dhe skizofrenia. Si autor ose botues i shumë librave dhe kontribues në më shumë se 800 botime, me të drejtë mund ta quajmë David Horrobin një shkencëtar me të vërtetë të shquar. Shfaqja e tij këtu vjen nga një libër që shkroi më 1969-n, titulli i të cilit ishte “*Shkenca është Perëndi*”.

Në vështrim të parë, ky titull duket se i përgjigjet pyetjes “A e ka hequr qafe shkenca Perëndinë” me një “Po” të fortë, por, ashtu si do ta tregojnë citimet e fundit, Horrobin mori një rrjedhë shumë të ndryshme:

Shkenca është perëndia moderne... shkencëtarët e shekullit të njëzetë... bëjnë pohimet më të egra për perëndinë e tyre... dhe njerëzit e thjeshtë e të hutuar të shekullit të njëzetë kanë një besim të papërpunuar në zotin e tyre, të cilin nuk vrasin mendjen ta vënë në pikëpyetje më nga afër².

Përfundimisht, psikologu, psikiatri, sociologu, secili duhet të rrëfejë se puna e tij duhet të ketë si hyrje “Unë besoj”, dhe jo “Kam provuar në mënyrë shkencore”³.

Duke mos thënë se shkenca ka pushtuar Perëndinë, Horrobin po nënvizonte mesazhin e shkencëtarit amerikan Anthony Standen në librin e tij më të shitur “Science is a Sacred Cow” (“Shkenca është një Lopë e Shenjtë”), i botuar në vitin 1950. Në terma të thjeshta, ai po thoshte se njeriu modern në mënyrë të gabuar e ka ngritur shkencën nga një disiplinë në një hyjni, autoriteti i së cilës është absolut dhe para të cilit të gjitha pohimet e tjera për të vërtetën duhet të nënshtrohen”.

Një përmbledhje

Këtu futemi ne. Dr. Roy Pecoock, Drejtor Menaxhues i Thermodyne dhe Profesor Vizitues i Aerospace në Universitetin e Pizës në Itali, thotë që, menjëherë pasi u bë i krishterë, ai doli në përfundimin se “... ndarja e madhe mes besimit të krishterë dhe njohurisë shkencore është një mirazh i nxitur nga pak njerëz të zhurmshëm”⁴. Mund të ndodhë kështu, por “njerëzit e zhurmshëm” janë ata të cilët i dëgjojnë më shumë. Çështja e origjinave siguron një shembull të mirë.

Në librin e tij “*Testing Darwinism*” (“Të vërtetosh Darwinizmin”), Phillip Johnson i referohet dramës “*Inherit the Wind*” (“Trashëgo erën”), një trajtim fantastiko-shkencor i të famshmit “Scopes Trial” (“Gjykimi i synimeve”), më 1925-n, në të cilën një mësues i ri u akuzua se kishte shkelur një ligj që ndalonte mësimdhënien e evolucionit në shkollat e Tennessee. Drama në mënyrë të zgjuar ka sukses që ta bëjë çështjen për mbrojtjen të duket përsosmërisht e arsyeshme, por prokurori bën një ngatërresë me fjalimin e tij të fundit, saqë drejtori i programit e heq atë dhe e zëvendëson transmetimin e drejtpërdrejtë me muzikë

të incizuar nga studioja e Çikagos. Johnson i mbahet mendimit se, ndërsa drama nuk krijoi një steriotip të debatit publik mbi këtë çështje, "... e paraqiste atë në një histori të fuqishme që ngelet në mendjet e gazetarëve, shkencëtarëve dhe intelektualëve përgjithësisht"⁵. Pastaj ai vë në dukje se ata që kanë pushtet për të fikur ose hapur mikrofonin, vendosin për atë që bota do të dëgjojë në përgjithësi: "Kur konflikti krijim-evolucion ritransmetohet në kohën tonë të mbizotëruar nga media, zotëruesit e mikrofonit të medias janë ata që duhet të vendosin se kush luan rolin e heronjve dhe atë të maskarenjve"⁶. Ndërsa historia e tanishme "zyrtare" flet për një univers që ekziston dhe zhvillohet me anë të një njëpasshmërie të vazhdueshme ngjarjesh të pamenduara, ata që mbështesin idenë se një Perëndi transhendent është krijuesi dhe mbajtësi i të gjithë atij, shpesh të tjerët i lënë mënjane ose i tallin.

Shkenca tani ka një profil kaq të lartë (dhe një regjistrim të shkëlqyer), saqë në debate publike shpesh tallen me fenë ose e lënë jashtë diskutimit, duke reflektuar pohimin e Peter Atkins se shkenca mund të shpjegojë çdo gjë. Ky përjashtim "fantastik" që i bëhet fesë ndizet nga Richard Dawkins, i cili e quan një sistem besimi biblik "të turpshëm, të neveritshëm dhe të vonuar"⁷. Megjithatë, në kapitullin 2 folëm për dallimin midis shkencës dhe *shkencizmit* dhe treguam se i dyti nuk mund të mbështetet logjikisht, sepse, vetëm po të braktisë vetë rregullat me anë të të cilave justifikon ekzistencën e vet, mund të pohojë se Perëndia nuk ekziston.

Kur shqyrtuam shkencën e vërtetë në kapitullin 3, gjetëm se shprehja "Shkenca thotë..." nuk mund të shoqërohet me "Fakti është...". Përshkrimi shkencor i një njësie apo ngjarjeje nuk është e vetmja e vlefshme; pohime shkencore shpesh janë modifikuar ose zëvendësuar; dhe shkencëtarë me merita të njëjta shpesh përplasen në lidhje me ide apo teori të rëndësishme. Madje, në mënyrë edhe më domethënëse, pamë që fusha të mëdha njohurie janë përtej arritjes së shkencës, duke i bërë synimet e saj më të shkurtra se pohimet e saj. Me gjithë arritjet e saj të shkëlqyera, shkenca nuk është në gjendje të na thotë përse filloi të ekzistonte universi, përse ka ligje natyrore të qëndrueshme dhe të varura, përse konstantet thelbësore fizike janë kaq mirë të akorduara, sa të mbështesin jetën inteligjente në planetin tonë, përse jemi persona dhe jo thjesht objekte të gjalla, ose përse mendja

funksionon kështu. Shkenca nuk është në gjendje të na japë një cilësi të brendshme të jetës, apo të përkufizimit a shpjegimit të parimeve etike. Nuk është në gjendje të na tregojë ndonjë gjë rreth qëllimit të jetës apo për fatin tonë pas vdekjes. Këto janë të meta konkrete. Të kapesht vetëm pas ndonjëres prej tyre, pyetje që kanë të bëjnë me kuptimin dhe vlerën janë jashtë kufizimeve të shkencës, megjithatë, pa një koncept të kuptimit, si mund të justifikohet shkenca? Për më tepër, shkenca nuk është në gjendje të vërtetojë se Perëndia nuk ekziston, së pari sepse është frymëror dhe jo material, së dyti sepse me përkufizim është përtej të të kuptuarit të mendjeve të kufizuara dhe së treti sepse është e pamundur të vërtetosh një negative universale.

Në kapitullin 4 u përqendruam në teorinë e makroevolucionit, e cila për shumë njerëz është kthyer në armën e zgjedhjes për të sulmuar Perëndinë. I nxitur në mënyrë këmbëngulëse në qarqet arsimore dhe në media, ideja është bërë kaq e pranishme, saqë sër Julian Huxley e quajti atë “ideja më e fuqishme dhe më e përhapura që është ngritur ndonjëherë mbi tokë”⁸. Megjithatë, në një kapitull të vetëm ishim në gjendje të tregonim që ajo nuk arrinte të vërtetohej. Nuk ka prova të forta të formave jetësore të ndërmjetme ndërmjet grupimeve kryesore: *homo sapiens*, katërkëmbësh majmunë, zogj, zvarranikë, amfibë, peshq me shtyllë kurrizore, jovertebrorë metazoan dhe organizma njëqelizore mikroskopike. Pavarësisht nga përpjekjet herkuliane për t’i gjetur ato, lidhjet munguese mungojnë të gjitha! Nuk ka as edhe një copë prove objektive që të tregojë se jeta lindi në planetin tonë si rezultat i një përplasjeje aksidentale elementesh inerte në një lloj supe kimike.

Duke u mbështetur në “teorinë sintetike” se në një pjesë të caktuar kohe mutacionet mund të shtronin rrugën për përzgjedhje natyrore për të krijuar rende të reja kafshësh, ka dalë po aq e kotë, sidomos që me zbulimin e ADN-së, me “ngarkesën” e vet të mahnitshme të informacionit gjenetik. Përderisa nuk ka ndonjë ligj natyror ose proces fizik me anë të të cilit informacioni mund të prodhohet ose të rritet, makroevolucioni ngec që në pikënisje. Ashtu si shprehet John Baumgardner: “Nëse ka patur ndonjëherë në historinë e njerëzimit provë të qartë për krijimin, provë për një superinteligjencë mbrapa asaj që shohim sot, është kodi gjenetik. Struktura informacioni në

mënyrë të habitshme komplekse, të koduara në ADN, formojnë planet gjenetike për çdo organizëm të gjallë. Evolucionistët nuk kanë asnjë të dhënë se si këto struktura mund të lindnin nga procese natyrore, aq më pak se si vetë kodi mund të vinte në ekzistencë”⁹.

Biofizikani izraelit dr. Lee Spetner, i cili dha mësim në Informatikë dhe Teori Komunikimi në Universitetin Johns Hopkins, është po aq i prerë: “Neodarvinistët duan që ne të besojmë se ndryshime të mëdha evolucionare mund të vijnë prej një serie ngjarjesh të vogla, nëse ka aq sa duhet. Por, nëse këto ngjarje të gjitha humbasin informacionin, ato nuk mund të jenë hapa në llojin e evolucionit që [teoria neodarviniane] mendon të shpjegojë, pavarësisht se sa mutacione ka atje. Kushdo që beson se makroevolucioni mund të bëhet me anë të mutacioneve që humbasin informacion, është si tregtari që humbi pak para në çdo shitje, por që mendoi t’i kompensonte ato që humbi”¹⁰.

Ideja “informacioni nëpërmjet rastësisë” shpërbëhet sapo e prekim. Nëse informacioni në kodin gjenetik njerëzor është diçka që u evolua si rezultat i një sasive të paimagjinueshme dëmtimi gjenetik, përse duhet të ketë ndonjë kuptim për ne? Nëse truri na tregon se është thjesht prodhim i veprimeve dhe reaksioneve të verbra kimike, si mund ta dimë se edhe vetë ky mesazh është e vërteta?

Kapitulli 5 zbuloi se shkencëtarë të vërtetë janë njerëz të besimit, domosdoshmërisht të përkushtuar në besimin në ekzistencën e tyre, në realitetin objektiv dhe të pavarur të universit, njëtrajtësinë e natyrës, integritetin e vetë ndjesive të tyre, ligjin e shkakut dhe të efektit dhe ekzistencën e realitetit të padukshëm. Gjithashtu tregoi se të gjitha këto supozime përshtaten përsosmërisht në një botëkuptim biblik, me Perëndinë në qendër. Së fundi, tregoi se në vend që të ishte një përzierje e mjegullt idesh fetare, krishterimi është i rrënjësuar mirë në histori të verifikueshme.

Kjo gjetë mbështetje në kapitullin 6, në të cilin dëgjuam disa prej shkencëtarëve të mëdhenj në histori, që mbështetnin se nuk kishte dyzim midis njohurisë së tyre shkencore dhe besimit në Perëndinë. Sot, mijëra shkencëtarë të tjerë, shumë prej tyre me diploma të shquara, japin të njëjtën dëshmi, diçka që m’u bë e qartë në mënyrë të dukshme kur predikova në një shërbesë, një mëngjes të diele të zakonshme, ku bashkësia prej 300 vetave përfshinte mbi tridhjetë shkencëtarë

me doktoratura të fituara në disiplina që varionin nga mjekësia te mikrobiologjia dhe nga farmacia deri te fizika.

Nga asgjë tek asgjëkundi?

Shkenca pa Perëndi jo vetëm ka të metat fatale që kemi riparë këtu, po ajo ngarkohet gjithashtu edhe me bagazh shkurajimi.

Më 1995, Peter Atkins shkroi një artikull që u botua në *“Independent”* me titullin: “Një vend i shkretë për të kërkuar përgjigje” dhe nëntitull: “Kuptimi i jetës në universin tonë është më shumë dëshpërues sesa hutues”. Artikulli përfundonte kështu: “Nga erdhi? Nga asgjëja. Ku po shkon? Në harresë. Si do të shkojë atje? Me anë të prishjes së paqëllimtë në kaos. Po qëllimi kozmik? Jua lë juve që të nxirrni vetë përfundimet”¹¹.

Bertrand Russell mbushi skenarin e zyrtarë që ofron materializmi: “E shkurtër dhe pa fuqi është jeta e njeriut; mbi të dhe mbi gjithë racën e tij bie fundi i ngadaltë dhe i sigurt, i pamëshirshëm dhe i errët. I verbër ndaj së mirës dhe së keqes, pa menduar shkatërrimin, materia e gjithëfuqishme rrokulliset në rrugën e vet të pamëshirshme; për njeriun, i mallkuar sot të humbasë të dashurit e vet, që nesër vetë të kalojë përmes portave të errësirës”¹².

Duke parë mbrapa në një karrierë të shkëlqyer, Robert Altman, drejtor filmi, ua tregoi përfundimet e tij lexuesve të *“Observer”*: “Sikur të mos kisha jetuar asnjëherë, sikur sperma që goditi vezën të mos qëllonte në shenjë, nuk do të kishte bërë asnjë ndryshim”¹³.

Në *“Selfish Gene”* (“Gjeni egoist”), Richard Dawkins mbron idenë se në esencë “... ne jemi makina që mbijetojmë, robotë të programuar verbërisht për të ruajtur molekulat egoiste të njohura si gjene”¹⁴. Gjithmonë kam menduar se kjo ide duhet të jetë pikëlluese për ata që nuk kanë fëmijë, dhe ateisti Steve Pinker, profesor i Filozofisë në Institutin e Teknologjisë në Massachusetts, i përgjigjet kësaj me humor të thellë: “Në vitet e mia të riprodhimit, deri tani, jam pa fëmijë, duke i shkapërdërdhur rezervat e mia biologjike duke lexuar dhe shkruar, duke bërë kërkime, duke ndihmuar miq e studentë dhe duke vrapuar në rrathë, duke shpërfillur urdhrin solemn për të shpërndarë gjenet e mia. Me standartet e Darvinit jam një gabim i tmerrshëm, një

dështak për t'u ardhur keq... Por jam i lumtur që jam kështu; nëse gjenet e mia nuk e pëlqejnë këtë, mund të hidhen në liqen”¹⁵. Richard Dawkins thotë se botuesi i një përkthimi në gjuhë të huaj që i është bërë librit ishte kaq i tronditur nga mesazhi i tij i ftohtë dhe i errët, sa që nuk mund të flinte për tri netë¹⁶. Kredoja e ateizmit është e qartë dhe e ashpër: filluam si rastësi, jetojmë si një farsë dhe përfundojmë si pleh.

Ka një alternativë...

Lajmi i mirë

Ideja se shkenca e ka hequr qafe Perëndinë është folklor i shek. XIX, i maskuar si fakt i shek. XXI. Predikuesi bashkëkohor britanik Peter Lewis ka të drejtë kur mbështet idenë se “zbulimi shkencor fton besimin e sfidon mosbesimin dhe jo e kundërta”¹⁷. Dhe Perëndia as nuk po luan kukafshehti me ne. Në mënyrën e tij tipike tekanjoze, regjisori amerikan Woody Allen u ankua: “Sikur Perëndia të më fliste vetëm një herë. Sikur vetëm sa të kollitej. Sikur vetëm sa të shihja një mrekulli. Sikur të mund të shihja ferrën që digjet apo defin që ndahet. Ose që xhaxhai im Sasha të paguante llogarinë”¹⁸. Diku tjetër, ai ëndërronte: “Sikur Perëndia të më jepte ndonjë shenjë të qartë! Si për shembull, të më jepte një depozitë të madhe në emrin tim në një bankë zviceriane”¹⁹. Dikush mund të qeshë me mendjemprehtësinë e Allen-it, por në këtë çështje jashtëzakonisht serioze ai humbet pikën që Perëndia na ka folur dhe na është shfaqur në të paktën tri mënyra dramatike.

I. Perëndia e ka shfaqur veten në krijim

Ashtu siç e kemi parë, shkenca ateistike nuk ka shpjegim për ekzistencën e universit, ndërsa Bibla deklaron: “Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij”²⁰. Kjo na tregon jo vetëm që Perëndia është i dallueshëm nga gjithë krijimi, por se krijimi është një tregues i mahnitshëm për ekzistencën e tij. Duke komentuar mbi këtë, Kirsten Birkett shkruan: “E dhëna për krijimin në Zanafillën 1 thekson me anë të strukturës letrare të renditur mirë dhe me fjalë të

zgjedhura me kujdes se Perëndia krijoi botën si një vend të rregullt dhe racional. Bota nuk është kaotike apo e rastësishme. Është e organizuar dhe e kuptueshme, sepse ajo ia detyron ekzistencën dhe formën e vet fjalës racionale krijuese të një Krijuesi të gjithëzgjuar... doktrina e krijimit që përmban Bibla jo vetëm përputhet me përpjekjen shkencore, por siguron baza konceptuale për të... Vetë coha e krijimit të Perëndisë siguron një arsye themelore për sipërmarrjen shkencore”²¹.

Kjo reflekton këmbënguljen e vetë Biblës, që në mrekullitë e botës natyrore Perëndia ka shfaqur “pushtetin e tij të përjetshëm dhe natyrën hyjnore”²². Dr. Arthur Compton, një fitues i çmimit “Nobel” në fizikë, shprehu shumë qartë bindjet e tij: “Për mua, besimi fillon me të kuptuarin që një inteligjencë shumë e lartë solli në ekzistencë universin dhe krijoi njeriun. Nuk është e vështirë për mua të kem këtë besim, sepse është e pakundërshtueshme që aty ku ka një plan ka inteligjencë. Një univers i rregullt e i shpalosur i dëshmon të vërtetës së pohimit më madhështor që është shqiptuar ndonjëherë: ‘Në fillim Perëndia’”²³.

2. Perëndia e ka shfaqur veten në Bibël

E kam shqyrtuar me detaje këtë në një libër tjetër²⁴. Pavarësisht nga 2,000 vjet hetimi, përndjekjeje, kritike, cinizmi, Bibla mbetet e paprekur dhe e pagërvishur. Herë pas here skeptikët kanë vënë në pikëpyetje saktësinë e saj historike, po kërkimet e mëtejshme kanë vërtetuar se e kanë patur gabim; as edhe një prej njëqind profecive të saj nuk ka treguar se është e rreme; ajo cakton standartet më të larta morale që njeriu njeh dhe, edhe pse të shkruara nga mbi dyzet autorë gjatë një periudhe prej 1,500 vitesh, uniteti i saj mahnitës nuk ka të ngjashëm në çfarëdo lloj letërsie. Sër Isaac Newton nuk po e tepronte kur e quajti atë “një shkëmb nga i cili gjithë çekiçët e kritikës nuk kanë copëtuar as një fragment të vetëm”. Shumë thjesht, për Biblën nuk ka shpjegim njerëzor. Në çfarëdo mënyre që mund ta vëmë në provë, ajo jeton sipas pohimit të vet se është “fjala e gjallë dhe e përjetshme e Perëndisë”²⁵.

Bibla jo vetëm që na tregon për ekzistencën e Perëndisë, por zbulon gjithashtu shumë prej attributeve të tij. Ai është *në mënyrë transhendente*

vetekzistues, “Perëndia i përjetshëm”²⁶, i cili është “nga përjetësia në përjetësi”²⁷, mbi dhe përtej kohës, hapësirës e gjithë realitetit. Ai është i *pandryshueshëm*; ai “nuk ka ndërrim dhe hije ndryshimi”²⁸ dhe as nuk merr formë apo manipulohet nga rrethanat apo përvoja. Ai është në mënyrë aktive i *gjithëpushtetshëm* dhe “vepron të gjitha sipas këshillës së vullnetit të tij”²⁹. Ai është i *gjithëdijshtëm*, “i përsosur në njohuri”³⁰, prandaj nuk i duhet të mësojë, zbulojë apo të kujtojë diçka. Ai është tërësisht i shenjtë; ai nuk mund “të shikojë të keqen”³¹ dhe “... në të nuk ka kurrfarë errësire”³². Me fjalët e teologut amerikan të shekullit XIX James Boyce, shenjtëria e Perëndisë është “shuma e gjithë shkëlqesisë dhe kombinimi i gjithë attributeve të cilat ndërtojnë përsosmërinë e karakterit”³³.

Së fundi, “Perëndia është *dashuri*”³⁴. Dashuria rrjedh nga vetë esenca e tij dhe thellësia e gjerësia e saj janë plotësisht përtej të kuptuarit tonë të kufizuar njerëzor. Kjo nuk do të thotë se ai është një “prekje e lehtë” apo ndonjë lloj plakushi qiellor i pasur që me butësi hedh mirësinë e tij mbi të madh e të vogël, duke qenë indiferent ndaj besimeve dhe sjelljeve të tyre. Edhe pse Bibla flet për “dashamirësinë e tij”³⁵ dhe “dashurinë e tij të mrekullueshme”³⁶, ajo tregon gjithashtu se kjo dashuri përqendrohet në qëllimin e tij që t’i sjellë njerëzit në një marrëdhënie të përjetshme me të.

Madalyn Murray O’Hair, themeluese dhe presidente e Ateistëve Amerikanë, hapi një proces gjyqësor i cili, më 1963-shin, bëri që Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të ndalonte lutjen e organizuar në shkollat publike. E quajtur “gruaja më e urreyer në Amerikë”, ajo dhe dy fëmijët e saj u zhdukën (bashkë me 500,000 dollarë të fondeve të Ateistëve Amerikanë) dhe gjashtë vjet më vonë trupi i saj i vdekur dhe pa gjymtyrë u gjend në një fermë të largët në Teksas. Ajo nderohej për sulmet e saj të hidhura dhe të ashpra ndaj krishterimit, foli për “çmendurinë e të besuarit në Perëndinë” dhe tha: “Nuk ka asnjë provë përfundimtare [që Jezui] ka ekzistuar ndonjëherë”³⁷. Megjithatë, në ditarin e saj ajo shkruante në mënyrë të përsëritshme: “Dikush, diku, më duaj!”³⁸. Është një ironi tragjike që ajo bëri karrierë nga të hedhurit poshtë në mënyrë arrogante atë, dashuria e të cilit është kaq “e gjerë, e gjatë, e lartë dhe e thellë”, saqë “kalon çdo njohuri”³⁹.

3. Perëndia e ka shfaqur veten në Jezu Krishtin

Në kapitullin 3, pamë që “Perëndia është frymë” dhe Bibla thotë në mënyrë specifike se “asnjë nuk e ka parë Perëndinë”⁴⁰. Megjithatë, thotë gjithashtu se Jezu Krishti “e ka bërë atë të njohur”⁴¹. Shprehja “e ka bërë atë të njohur” mbështetet në foljen greke “*exegéomai*”, që do të thotë “të nxjerrësh në pah”. Në personin e Jezuit kemi një zbulim të kuptueshëm të natyrës dhe karakterit të Perëndisë. Sipas fjalëve të mrekullueshme të Biblës, “tek ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë”⁴². Ai ishte plotësisht njeri, sikur të mos ishte Perëndi, dhe po aq plotësisht Perëndi, sikur të mos ishte njeri. Richard Bube e shpreh kështu: “Perëndia i ka marrë atributet e qenies së tij, dashurinë, mëshirën, shenjtërinë, drejtësinë e pushtetin e tij, dhe i ka përkthyer ato në një formë që njerëzit mund t’i kuptojnë, t’i besojnë dhe t’u përgjigjen atyre... Kulmi i zbulimit që Perëndia i bën vetes është personi i Jezu Krishtit. Në të, përfundimtarja dhe e pakushtëzueshmja shkrihen me të përkohshmen dhe të kushtëzuarën, në atë mënyrë që një qenie njerëzore mund të përgjigjet me personalitetin e vet”⁴³.

Shkencëtari i shquar i hapësirës së Robert Boyd ka qenë dikur profesor i astronomisë në Institutin Mbretëror dhe ishte gjithashtu profesor i fizikës në Universitetin e Londrës. Anëtar i Shoqërisë Mbretërore, nuk ishte vetëm shkencëtar i klasit botëror, por, gjithashtu, edhe një i krishterë ndikues në mënyrë të heshtur. Kur vdiq në vitin 2004, një nekrologji në “*Daily Telegraph*” e nderoi në këtë mënyrë: “Gjatë gjithë jetës së tij ai ishte një njeri besimi fetar të fortë, që ishte tërësisht racional dhe i përkushtuar; ai nuk pa mospërputhshmëri ndërmjet kërkimit të ndershëm të të vërtetës shkencore dhe pohimeve të ungjillit të krishterë”⁴⁴.

Kur ishte drejtor i Laboratorit Hapësinor Mullard në Holmbury St Mary në Surrey, ai shkroi një poemë për një artikull krishtlindjesh për revistën e kishës së tij. Ai thotë se e shkroi “që fshati ta dijë se kreu i laboratorit misterioz në majë të kodrës nuk ishte aspak si shkencëtari “i çmendur” sipas traditës, por një dishepull mirënjohës dhe i mbështetur në Krishtin, ashtu siç ishin shumë nga kolegët e tij”. Ky version i shkurtuar⁴⁵ përfshin një prezantim të fuqishëm të faktit që në lindjen e

Jezu Krishtit, rreth 2,000 vjet më parë, Perëndia “u bë mish dhe” për pak kohë “banoi në mesin tonë”⁴⁶:

“Në fillim”, para gjithë botëve,
ose yjeve flakëruese apo galaksive rrotulluese,
para atij “shpërthimi të madh”, nëse ishte i tillë,
apo tkurrije të mëparshme: herët, shumë herët,
përtej gjithë kohës apo hapësirës së bashkëlidhur
dhe gjithçkaje që është dhe gjithçkaje që ka patur ndonjëherë,
dhe gjithçkaje që do të jetë; Burim i të gjithës,
“Në fillim ishte Fjala” e Perëndisë.

Kush është ky Perëndi dhe a mund të njihet ky Perëndi
brenda kufijve të një kafke njerëzore,
një litër e gjysmë truri të vdekshëm,
neuronet ndërlidhëse të të cilit duhet të varen
nga kimia apo fizika në fund të fundit,
për gjithçka që njeriu mund të dijë ose të kuptojë?
A mundet njeriu të njohë Perëndinë që rri në fron përjetësisht
gjatë gjithë hapësirës dhe përtej saj?

Misteri i qenies, ende i pazgjidhur
nga gjithë shkenca dhe filozofia jonë,
më mbush me mrekulli që më lë pa frymë, dhe Perëndia,
nga i cili e gjithë kjo rrjedh vazhdimisht,
kërkon adhurimin tim, dhe adhurimin do ta ketë.
Por dashuria e mishëruar tërheq shpirtin tim
në admirim të përlulur të një Foshnjeje;
“Në këtë u tregua dashuria e Perëndisë”.

Jezui përsëri vjen tek ata që kërkojnë Perëndinë
dhe përsëri përgjigjet si bëri dhe më parë,
“Kam qenë me ju për shumë kohë, si mund të thoni
“Nuk e njoh Perëndinë, oh, më tregoni sot Perëndinë!”?
Kur më keni takuar, keni parë Perëndinë e përjetshëm,
e keni takuar atë si Atë po ashtu, si ai që kujdeset,

do dhe digjet për njerëzit si unë vetë.

Unë jam mesazhi i Krishtlindjes. Perëndia ka ardhur”.

Shpëtimtari

Megjithatë, Bibla e bën të qartë se, ashtu si na dha në mish dhe formë njerëzore një zbulim të natyrës së tij, Perëndia kishte një arsye tjetër të veçantë që erdhi në botë në këtë formë: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme”⁴⁷. Diku tjetër, na thuhet se Jezui “erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët”⁴⁸. Ai nuk erdhi si burrë shteti, politikan, filozof, këshilltar financash, psikiatër apo doktor, por në mënyrë që të na shpëtonte nga pasojat e tmerrshme të mohimit që i bëjmë brenda vetes Perëndisë dhe rrugëve të tij.

Jezui erdhi me një mision shpëtimi që i kushtoi jetën e vet. Bibla thotë se “... të gjithë kanë mëkatuar dhe kanë rënë nga lavdia e Perëndisë”⁴⁹ dhe se “... paga e mëkatit është vdekja”⁵⁰. Mëkati na ndan nga Perëndia jo vetëm në këtë jetë, por edhe në jetën që do të vijë: “Asgjë e papastër nuk do të hyjë [në parajsë]”⁵¹. Kjo do të thotë se, po të ngelemi në duart tona, jemi fajtorë, të humbur dhe të pashpresë, megjithatë “Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, ndërsa ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne”⁵². Në vdekjen e tij tronditëse me kryqëzim, Jezui i pamëkat mori vendin e mëkatarëve, duke dhënë aq llogari për mëkatet e tyre, sikur të ishte përgjegjës për to. Perëndia është aq i shenjtë, sa nuk mund të përshkruhet me fjalë dhe nuk mund të lërë asnjë mëkat të pandëshkuar, kështu që, kur Jezui mori vendin e mëkatarëve, ai duhej të vuante plotësisht dënimin që meritonin mëkatet e tyre. Në kryq Jezui iu ekspozua gjithë zemërimit të Perëndisë kundër mëkatarëve që përfaqësonte dhe mëkateve që kishin kryer.

I vetmi person tërësisht i pafajshëm në gjithë historinë njerëzore mori mbi vete dënimin me vdekje fizike e shpirtërore që meriton mëkati dhe që e kërkon Perëndia. Asgjë nuk u mbajt; dhe kur vuante dënimin për mëkatet e të tjerëve, Jezui përjetonte një ndjesi ndarjeje kaq të tmerrshme nga Ati i tij, saqë thirri: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”⁵³. Mund të mos jemi asnjëherë në gjendje të

kuptojmë se çfarë kuptimi kishte e gjithë kjo; ne përballemi me “një mister të cilin asnjë pikturë apo skulpturë me fytyrë të shtrembëruar mund ta tregojë”⁵⁴. Ajo që dimë ne është se në vdekjen e Birit të tij, Perëndia “tregon dashurinë e tij për ne”. Një prej të krishterëve të hershëm shkroi për “Birin e Perëndisë, që më deshi dhe dha veten e vet për mua”⁵⁵; një tjetër pohoi: “Sepse edhe Krishti ka vuajtur një herë për mëkatet, i drejti për të padrejtët, për të na çuar te Perëndia”⁵⁶; ndërsa një tjetër shtoi: “Nga kjo e kemi njohur dashurinë: ai e dha jetën e vet për ne”⁵⁷.

Por dita më rrëqethëse në historinë njerëzore u pasua shpejt nga më e lavdishmja, kur ringjallja e Jezuit prej së vdekurish në mënyrë të pagabueshme konfirmoi se sakrifica e tij kishte arritur qëllimin e saj. Ashtu siç e pamë në kapitullin 5, të pranosh se Jezui u ringjall së vdekurish, nuk është një kërcim në errësirë. Mbështetet në një masë të palëvizshme të provave të pakundërshtueshme, ato që Bibla i quan “shumë prova bindëse”⁵⁸. Ky është thelbi i ungjillit të krishterë; është lajmi më i mirë që ndonjë ka dëgjuar ndonjëherë.

Të besosh e të besosh

Kur u flas dëgjuesve për natyrën e besimit të krishterë, shpesh kam përdorur formulën vijuese. Duke u marrë veçanërisht me atë që besimi i krishterë përfshin, kam thënë diçka të tillë: “Unë besoj në një banjo të ftohtë para se të ha mëngjes çdo ditë. Nuk nënkuptoj vetëm në kulmin e verës, por gjatë gjithë vitit, edhe kur temperatura është nën zero dhe akulli varet në ulluqe. Besoj se nuk ka mënyrë më të mirë për të filluar ditën, sesa duke u çuar me gjallëri nga krevati, të hapësh ujin e ftohtë dhe të kërcesh drejt e në të. Kjo ka bërë që gjithmonë dëgjuesit të dridhen, e ndjekur kjo nga një shpërthim i papritur të qeshure kur sapo kam shtuar: “Por nuk e kam bërë asnjëherë një të tillë!”.

Pikërisht në këtë pikë kemi arritur në libër dhe, për ta çuar deri në fund, do t’i shkruaj këto pak faqe të fundit në vetën e dytë njëjës. Askund nuk jam përpjekur të *vërtetoj* se Perëndia ekziston, sepse është e pamundur të vërtetosh një gjë të tillë në mënyrë deduktive. Përkundrazi, jam përpjekur të tregoj se prova, duke përfshirë edhe zbulimet më të fundit shkencore, çon në atë drejtim dhe se miliona

njerëz gjatë mijëra vitesh (duke përfshirë shkencëtarë të panumërt me diploma të shquara) janë bindur se kështu është. Ndërsa je duke e përfunduar këtë libër, ndoshta edhe ti mund të jesh bërë pjesë e tyre. Mund ta kesh lexuar faqen e parë si ateist, agnostik apo skeptik. Tani ke arritur të kuptosh forcën e provës së mbledhur dhe të pranosh se “... ka vetëm një Perëndi, Ati nga i cili janë të gjitha gjërat...”⁵⁹.

Deri këtu mirë, por kjo nuk mjafton për besimin që Bibla kërkon nga ne. Të besosh se Perëndia është e qartë se nuk mund të nënkuptojë më pak se të pranosh në mënyrë intelektuale të vërtetën premisë; Bibla e bën të qartë se “... ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është...”⁶⁰. Por një shkrimtar tjetër i Dhiatës së Re e bën njësoj të qartë se të pranosh ekzistencën e Perëndisë nuk është e mjaftueshme: “Ti beson se ka vetëm një Perëndi. Mirë bën; edhe demonët besojnë dhe dridhen”⁶¹. Bibla na jep shembuj të qartë për këtë. Kur dy njerëz të pushtuar nga djalli takuan Jezuin, ata thirrën: “Ç’është mes nesh dhe ty, Jezu, Biri i Perëndisë?”⁶². Në një rast tjetër, një frymë e keqe që kishte pushtuar dikë thirri: “Ç’ka midis nesh dhe teje, o Jezu Nazareas? A erdhe të na shkatërrosh? Unë e di kush je: I shenjt i Perëndisë”⁶³. Këto shpërthime e nënvizojnë theksueshëm çështjen. Besimi që përbëhet vetëm nga të pranuarit mendtor të fakteve të caktuara e lë personin në fjalë vetëm duke ditur të vërtetën, por pa u ndryshuar nga ajo. Në kontrast të drejtpërdrejtë, besimi biblik e bën një të krishterë të thotë: “Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, *kemi paqe me Perëndinë* nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë”⁶⁴.

Çelësi për të kuptuar ndryshimin ndërmjet “besimit me kokë” dhe “besimit me zemër” është të kuptosh se “besimi me zemër” do të thotë t’i përgjigjesh një personi të gjallë, jo një premise logjike. C. S. Lewis e prek këtë pikë kur thotë: “Të besosh se Perëndia, të paktën ky Perëndi, ekziston, është të besosh se ti si person tani qëndron në praninë e Perëndisë si Person... Nuk je më përballë një argumenti që kërkon pranimin tënd, por me një Person i cili kërkon sigurinë tënde”⁶⁵.

Ka një kuptim në të cilin Perëndia është përtej njohjes sonë, dhe ne sigurisht që nuk mund ta njohim atë kurrë vetëm përmes fuqive tona të arsytimit. Perëndia nuk është pjesë e krijimit të tij dhe ai nuk njihet në mënyrën që ne njohim gjërat që ai ka bërë. Besimi biblik në Perëndinë është në mënyrë të rëndësishme i ndryshëm nga besimi

në një hipotezë shkencore. Edhe sikur të bëjmë një piring me prova që të çojnë në ekzistencën e Perëndisë, jemi larg nga përjetimi i një marrëdhënieje personale me të, ashtu sikur mund të dimë shumë *rreth* njerëzve të tjerë, pa i njohur ata në të vërtetë. Colin Humpherys, profesor i Shkencave Materiale në Universitetin e Kembrixhit, e shpreh kështu: “E vërteta shkencore është kryesisht objektive (p.sh., stilolapsi me të cilin po shkruaj ka një masë të caktuar e cila mund të matet dhe mbi të cilën bien dakort shkencëtarët nga e gjithë bota). E vërteta e krishterë është si objektive ashtu edhe subjektive, dhe pjesa subjektive është e rëndësishme. Shumë aspekte të realitetit mund të njihen vetëm nëpërmjet përfshirjes personale në të, për shembull dashuria e një njeriu për një tjetër. E vërteta e krishterë, që Perëndia e përkushtoi veten ndaj nesh përmes Jezuit, mund të bëhet e njohur vetëm nëse ne përkushtohemi ndaj tij⁶⁶.”

Mund ta çojmë këtë më tej dhe të themi se të kërkesha prova para se të besosh në Perëndinë (në stilin e Woody Allen), është të jesh i dënuar dhe jo i rekomanduar. Është shenjë e arrogancës njerëzore, e përzier me faktin që një pjesë e jona kërkon që shkenca të jetë në konflikt me Perëndinë. Kirsten Birkett e përcakton me saktësi këtë problem: “Ne të gjithë do të donim të bënim pa Perëndinë, po të ishte e mundur. Duam që përgjigjet e shkencës të jenë aq të mira, sa të luftojnë me përgjigjet e Perëndisë apo t’i nxjerrin nga përdorimi... Që të duhet të besosh se Perëndia është i vetmi që jep përgjigjet përfundimtare është disi poshtëruese. Nuk përshtatet mirë me krenarinë tonë si qenie njerëzore⁶⁷.” Natyra jonë e rënë frymërore përfshin një rezistencë të brendshme morale ndaj Perëndisë, një refuzim për të pranuar nevojën që kemi për të dhe, pa pranuar atë nevojë, do të mbetemi “pa shpresë dhe pa Perëndinë në botë⁶⁸.”

Bibla thotë se vetëm zbulimi që Perëndia i bën vetes në krijim mjafton të na lëjë “pa justifikim⁶⁹” po të mohojmë ekzistencën e tij. Po të flasim në mënyrë strikte, askush nuk është ateist. Të gjitha qeniet njerëzore me arsye kanë programuar në kushtetutat e tyre një vetëdije të brendshme për hyjni, një njohuri deri diku të të menduarit të tyre se Perëndia ekziston. Fizikani gjerman i shek. XVIII G. C. Lichtenberg shkoi deri atje sa të thoshte: “Besimi në Perëndinë është një instikt aq natyror te njeriu, sa është të ecurit në dy këmbë⁷⁰”; edhe ekzistencialisti

francez Jean-Paul Sartre (Zhan Pol Sartri) pranoi: “Çdo gjë brenda meje kërkon Perëndinë”⁷¹. Romancieri kanadez Douglas Coupland u bë i njohur me librin e tij “*Generation X: Tales of an Accelerated Culture*” (“Brezi X: përralla të një kulture të përshpejtuar”), i botuar më 1991, në të cilin ai identifikohet me ata që kishin lindur në vitet 1960 e 1970 dhe të cilët kishin braktisur përkushtimin, idealizmin dhe fenë. Por në një libër tjetër më vonë, “*Life After God*” (“Jeta pas Perëndisë”), ai shkroi: “E fshehta ime është se kam nevojë për Perëndinë, se jam i sëmurë dhe se nuk mund të vazhdoj më vetëm”⁷². Të gjithë ne kemi të njëjtën “të fshehtë” me Coupland, por nga natyra e shtypim këtë instikt, e shtrembërojmë mesazhin e tij dhe e mashtrojmë veten në mënyrë fatale. Si rezultat, ka një kuptim në të cilin në të njëjtën kohë edhe e njohim, edhe nuk njohim Perëndinë. Besimi i vërtetë dhe biblik është zgjidhja e kësaj dileme.

Pika e kthimit

Me terma biblike, të besosh në Perëndinë përfshin të *kthehesh e të besosh*, dhe aspekti i dytë është i pamundur pa të parin. Fjala e Biblës për *kthim* është “pendesë”, e cila kërkon revolucion në zemër, mendje e vullnet, dhe Perëndia “i urdhëron të gjithë njerëzit kudo që të pendohen”⁷³. Do të thotë t’i japësh fund rebelimit tënd kundër Perëndisë dhe të braktisësh pavarësinë tënde me veten në qendër. Do të thotë të pranosh se Perëndia ka pretendimin kryesor në jetën tënde dhe të pranosh se synimi yt kryesor duhet të jetë që t’i sjellësh lavdi atij përmes bindjes tënde me gjithë zemër. Do të thotë të vendosësh zemrën tënde në të jetuarit e asaj jete që reflekton pastërtinë, dashurinë dhe hirin e tij.

Ashtu siç e kemi parë tashmë, kur Bibla flet për të besuarit, do të thotë diçka shumë më tepër se pranim i ftohtë i fakteve. Do të thotë të besosh. Perëndia premton faljen e mëkateve, jetë të përvetshme dhe praninë e fuqinë e tij që t’ju bëjë të mundur ta jetoni jetën me Perëndinë në qendër të saj, por duhet të ketë një përgjigje me gjithë zemër ndaj Jezu Krishtit. Ai “mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të tij i afrohen Perëndisë”⁷⁴, por duhet të vish, duke pranuar nevojën tënde për një Shpëtimtar nga fuqia dhe dënimi i mëkatit tënd dhe ta

lësh veten tek ai, duke i besuar atij të bëjë për ty diçka që është përtej arritjes jo vetëm të shkencës, por të sinqeritetit, respektueshmërisë apo fesë. Një shkencëtar i klasit botëror na jep tablonë e duhur. Duke shkruar për natyrën e besimit në një Perëndi person, fizikani gjerman Werner Heisenberg, të cilit iu dha çmimi “Nobel” për fizikë më 1927-n pohoi: “Nëse kam besim, do të thotë se kam vendosur të bëj diçka dhe jam gati të lë kokën për të”⁷⁵.

Kjo është tamam ajo që përfshin të bërit i krishterë i vërtetë: të lësh gjithë besimin që ke në njohurinë, meritat e arritjet e tua dhe të lidhësh fatin tënd në Jezun Krishtin, duke i besuar atij si Shpëtimtarit tënd dhe duke iu nënshtruar si Zotit tënd. Të bësh këtë nuk do të thotë të heqësh dorë apo të braktisësh arsyen apo parimet shkencore, por të shkosh përtej tyre dhe të bashkohesh me miliona të tjerë, të cilët, gjatë mijëra vjetëve, kanë zbuluar se Perëndia ka qenë i vërtetë ndaj fjalës së tij dhe kërkimi i të cilëve për të vërtetë më të madhe sesa shkenca mund të zbulojë ndonjëherë, i ka çuar ata në një marrëdhënie jetëndryshuese me Krijuesin e tyre. Premtimi i Biblës nuk mund të ishte më i qartë:

...në rast se e kërkon [urtësinë] si argjendin dhe
fillon të rrëmosh si për një thesar të fshehur,
atëherë do të ndjesh frikën e Zotit dhe
ke për të gjetur kuptimin e Perëndisë.⁷⁶

Shtojcë

Historia e çuditshme e Shkencës së Krishterë

Shkenca e Krishterë (ose Kisha e Krishtit Shkencëtar, që t'i japim emrin e plotë) është një organizatë disi “e qetë”, që rrallë shfaqet nëpër tituj gazetash dhe që njihet nga pjesa më e madhe e njerëzve me anë të Dhomave të Leximit me pamje disi të zhveshur. Edhe pse nuk ka patur një anëtarësi të madhe, ka një profil goxha të dallueshëm dhe ia vlen të hedhim një vështrim, sidomos për shkak të pohimit të dukshëm që bën emri i tij për të lidhur shkencën me krishterimin.

Phineas Parkhurst Quimby (1802-1866) jetoi në verilindje të Shteteve të Bashkuara dhe në mënyra të ndryshme ai është përshkruar si orëbërës mjeshtër e shpikës dhe “një kovaç jofetar dhe i paditur”¹. Kur ishte rreth të tridhjetave, ai u tërhoq nga hipnoza dhe shpejt u bë hipnotizues ekspert, duke zhvilluar një filozofi së cilës i referohej me emra të ndryshëm, duke përfshirë edhe “Shkenca e Jetës dhe e Lumturisë”. Teknikat e tij shëruese pa ilaçe mbështeteshin në teorinë se sëmundja shkaktohej nga arsytimi i gabuar dhe se e vërteta ishte ilaçi për të gjithë sëmundjen. Shpejt vendosi një reputacion që po rritej gjithnjë e më tepër si shërues, por ka të ngjarë që nuk do të siguronte më shumë se një shënim në histori, po të mos ishte këshilluar nga një pacient i veçantë më 1862-shin.

Mary Ann Morse Baker, e lindur në Bow, New Hampshire, në vitin 1821, ishte fëmija i gjashtë dhe më i vogli i prindërve fermerë që i druheshin Perëndisë. Shumë e ndjeshme, shumë fetare dhe studente e devotshme e Biblës, ajo sëmurej në mënyrë kronike që nga fëmijëria e në vazhdim me paraliza, histeri, kriza dhe spazma. Kur kishte mbushur dyzet vjeç, sa kishte filluar të merrej me hipnozën, vetësugjestionim dhe qartëpamje, ajo shkoi në Portland, Maine, për t'u këshilluar me Phienas Quimby.

Quimby e bindi atë se sëmundja dhe lëngata mund të shëroheshin përmes mendimeve pozitive dhe qëndrimeve të shëndetshme (me fjalë të tjera, duke ndryshuar besimet e dikujt rreth natyrës së sëmundjes). Edhe pse disa prej simptomave të saj do të përsëriteshin, ajo jo vetëm këmbënguli që Quimby e kishte shëruar plotësisht, por fitoi një varësi psikike tek ai, madje edhe duke pretenduar se vizitohej prej fantazmës së tij.²

Pak javë pas vdekjes së Quimby-it, Mary Patterson (siç quhej në atë kohë) u sëmur keq, sepse ra në një trotuar të ngrirë. E gjymtuar dhe me dhimbje të forta, ajo iu kthye Biblës për të gjetur ngushëllim dhe pak ditë më pas u ndikua thellësisht nga leximi i historisë së shërimit që Jezui i bëri një të paralizuari.³ Edhe pse dëshmia mjekësore e mohon atë, versioni “zyrtar” i ngjarjeve thotë se zbuloi se ishte shëruar në mënyrë të mrekullueshme⁴. Ajo u ul menjëherë të bashkonte interpretimin e saj për mësimin e Biblës me atë të Phineas Quimby dhe më pas pohoi: “Në vitin 1866 zbulova shkencën e Krishtit ose ligjet hyjnore të Jetës, të të Vërtetës e të Dashurisë dhe e quajta zbulimin tim *Shkenca e Krishterë*”⁵.

Ajo filloi të drejtonte sesione shëruese dhe t'u mësonte studentëve të interesuar teknikat e saj shëruese dhe filozofi shpirtërore (me një çmim tepër të lartë, prej 300 \$ për një kurs me 12 mësimet). Ajo githashtu filloi të shkruante për këtë temë dhe, më 1875-n, nxori librin që bëri bujë “*Science and Health with Key to the Scriptures*” (“Shkenca dhe shëndeti me çelës të Shkrimit”). Ndërsa i referohej “gabimeve të dukshme” në Bibël, ajo nuk ngurroi të tregonte për origjinën dhe integritetin e punës së saj, e cila, tha ajo, “i bënte jehonë harmonive të qiellit në metafizikë hyjnore”. Nuk është e habitshme që ajo pohonte: “Nuk mund të jem tepër modeste në vlerësimin tim të metodës së

Shkencës së Krishterë”⁶. Jo të gjithë ishin dakord. Këshilltari i saj letrar, James Henry Wiggins, u tmerrua me atë që zbuloi: “Gabimet ortografike ishin të tmerrshme, por këto nuk ishin gjërat që më tronditën... Kishte pasazhe që kundërshtonin plotësisht dhe tërësisht gjëra që ishin shkruar para tyre dhe të shpërndara ngado kishte referenca të gabuara në lidhje me çështje historike dhe filozofike”. Ai vendosi që e vetmja mënyrë për t’u marrë me detyrën e tij ishte “të filloja në faqen e parë dhe ta rishkruaja të gjithën”⁷, një koment me të drejtë shkatërrues i një libri që thuhej se ishte diktuar nga Perëndia!

Në këtë kohë burri i parë i Mary Baker, George Glover, kishte vdekur, ishte divorcuar nga i dyti, Daniel Patterson, për arsye braktisjeje (ai e la atë për shkak të “krizave” të saj) dhe ishte martuar me Asa Gilbert Eddy (duke thënë se ishte dyzet vjeçe, edhe pse në atë kohë ishte pesëdhjetë e gjashtë). Tani ajo kishte të drejtën ta quante veten Mary Ann Morse Baker Glover Patterson Eddy, por zgjodhi të njihej thjesht si Mary Baker Eddy kur, më 1879-n, ajo themeloi kishën e parë të Shkencës së Krishterë në Boston, Massachusetts (e riquajtuar Kisha e Parë e Krishtit Shkencëtar trembëdhjetë vjet më vonë). Më 1881, ajo hapi Kolegjin Metafizik Massachusetts në Boston (u mbyll dhe u rihap më 1889-n) dhe më 1883-shin ajo u bë themeluesja dhe kryeredaktorja e revistës “*The Christian Science Journal*”. Ajo themeloi një kompani botuese në vitin 1898 dhe, më 1908-n, dy vjet para vdekjes së saj, ajo themeloi gazetën e përditshme të respektuar “*The Christian Science Monitor*”, e cila ka fituar gjashtë herë çmimin prestigjioz Pulitzer.

Edhe pse besonte dhe u mësonte të tjerëve se vuajtja dhe vdekja ishin iluzione të mendjes, asaj nuk iu nda asnjëherë shëndeti i lig, herë pas herë kishte nevojë për injeksione morfine dhe mbante syze e protezë dhëmbësh. Ajo vdiq më 1910-n, duke lënë një pronë me vlerë prej 3,000,000 dollarësh. Më 1995-n ajo u vu pas vdekjes, në Hollin e Famës Kombëtare për Gratë, si e vetmja grua amerikane që themeloi një fe mbarëbotërore, e cila në kulmin e vet në vitet ’30 kishte një anëtarësi prej 300,000 anëtarësh.

Shkenca e Krishterë nuk është një kishë agresive dhe që të kthen në një fe të re; profili i saj publik zakonisht kufizohet te Dhomat e Leximit. Emri që u është dhënë këtyre vendeve të takimeve është domethënës, sepse kisha nuk ka predikues apo predikime. Përkundrazi, pa dhënë

ndonjë shpjegim apo interpretim, Lexuesit e Parë dhe të Dytë janë të detyruar të lexojnë pasazhe nga Bibla dhe “*Shkenca e Shëndeti*”.

Pyetja më e rëndësishme për të bërë këtu është nëse Bibla dhe Shkenca e Krishterë përputhen. Mënyra më e thjeshtë për ta zbuluar është të krahasosh mësimin e tyre mbi çështje kryesore. Ja nëntë shembuj.

- *Autoriteti i Shkrimit*. Bibla pohon se është “fjala e gjallë dhe e përjetshme e Perëndisë”⁸. Shkenca e Krishterë thotë se ajo ka mijëra gabime dhe se “*Shkenca dhe Shëndeti*” është “libri i parë” që “nuk është prishur nga hipotezat njerëzore”⁹.
- *Natyra e Perëndisë*. Bibla thotë se Perëndia është i gjallë dhe person, krijuesi dhe sunduesi i gjithë realitetit jashtë vetes së tij: “Zoti e ka vendosur fronin e tij në qiejt dhe mbretërimi i tij sundon mbi të gjithë, Zoti e ka vendosur fronin e tij në qiejt dhe mbretërimi i tij sundon mbi gjithçka”¹⁰. Shkenca e Krishterë thotë se Perëndia është “një parim hyjnor e i pakufizuar”¹¹, dhe nxit idenë panteistike se “Perëndia është i gjithi në gjithçka”¹² e “identik me natyrën”¹³.
- *Perëndia si tri-un*. Bibla mëson se Perëndia ekziston si tri persona, Ati¹⁴, Biri¹⁵ dhe Fryma e Shenjtë¹⁶. Shkenca e Krishterë thotë: “Teoria e tre personave në një Perëndi (që domethënë një Trinitet person ose tri-un) sugjeron politeizëm”¹⁷ dhe e ripërkufizon Trinitetin si jetë, e vërtetë dhe dashuri.
- *Hyjnia e Jezu Krishtit*. Bibla mëson se Jezui është “Perëndia i vërtetë”¹⁸. Shkenca e Krishterë thotë se fjalët “Jezu” dhe “Krisht” nuk i referohen të njëjtit person, se Jezui ishte vetëm njeri dhe se Krishti është “ideja hyjnore”¹⁹.
- *Hyjnia e Frymës së Shenjtë*. Bibla e identifikon qartë Frymën e Shenjtë si hyjnore²⁰. Shkenca e Krishterë e përkufizon atë thjesht si “Shkenca e krishterimit”²¹.
- *Bota materiale*. Bibla mëson se, ndërsa “Perëndia është Frymë”²², ai krijoi universin material dhe çdo gjë në të²³. Shkenca e Krishterë thotë se nuk ka realitet tjetër përveç Mendjes e Frymës, dhe se “...materia është ... jo e vërtetë”²⁴.

- *E keqja, sëmundja dhe vdekja.* Bibla mëson se mëkati e sëmundja janë realitete të përditshme²⁵ dhe se, si rezultat i mëkatit, "... njeriu duhet të vdesë"²⁶. Shkenca e Krishterë thotë "Njeriu nuk është i aftë për mëkat, sëmundje dhe vdekje"²⁷, se të treja janë "gjendje të mendjes — iluzione"²⁸ dhe se "... i vetmi realitet i mëkatit, sëmundjes dhe vdekjes është fakti i tmerrshëm se jorealitetet i duken të vërteta besimit njerëzor të gabuar"²⁹. Në praktikë, kjo do të thotë se Shkenca e Krishterë nuk e nxit "shërimin me anë të besimit", por më tepër idenë se dikush nuk është aspak i sëmurë në të vërtetë.
- *Vdekja dhe ringjallja e Jezuit.* Bibla thotë se Jezui vdiq në kryq për të paguar dënimin për mëkatin njerëzor, u ngrit së vdekurish tri ditë më vonë dhe është përjetësisht i gjallë³⁰. Shkenca e Krishterë thotë: "Në shkencë, Krishti nuk vdiq asnjëherë"³¹, dhe se e la varrin duke e ditur se kështu do të ndodhte.
- *Parajsa dhe ferri.* Bibla mëson ekzistencën si të parajsës³², ashtu edhe të ferrit³³. Shkenca e Krishterë e quan qiellin "një gjendje të mendjes"³⁴ dhe ferrin "besim vdekatar, agoni vetimponuese"³⁵ rezultat i fajit të mëkatit të imagjinuar.

Shumë shembuj të tjerë mund të jepeshin dhe në shumë detaje për të treguar se, duke këmbëngulur se Shkenca dhe Shëndeti ishte e vetmja mënyrë në të cilën mund të kuptohej si duhej, Mary Baker Eddy mohoi autoritetin dhe integritetin e Biblës. Një lloj drithi i përdorur për të ngrënë mëngjes në Amerikë është shënuar nën emrin e "Grape Nuts" (Arra rrushi), edhe pse nuk përmban as rrush e as arra. Shkenca e Krishterë ka një emër po aq kureshtar; nuk është as e krishterë dhe as shkencor.

Shënime

Hyrje

1. Edgar Adrews, *“God, Science and Evolution”*, Evangelical Press, p.i.

Kapitulli 1 — Akordimi i pyetjes

1. Cituar nga N. McCulloch, *“Barriers to Belie”*, Darton, Longman & Todd, f. 82.
2. J. P. Moreland, *“Scaling the Secular City”*, Baker Book House, f. 199-200.
3. *Oxford Dictionary of English*, botimi i dytë, Oxford University Press, 2003, f. 1,580.
4. *“Soul of Britain”*, BBC2, 11 qershor 2000.
5. Ciuar nga Walter R. Hearn, *“Being a Christian in Science”*, InterVarsit Press, f. 47 (theksimi i shtuar nga autori).
6. *Oxford Dictionary of English*, f. 1 487.
7. John Houghton, *“The Search for God”*, Lion Publishing, f. 143.
8. John B. Noss, *“Man’s Religions”*, Macmillan Co., f. 88.
9. Shiko Patrick Johnstone, *“Operation World”*, STL Books/WEC Publications, f. 216.
10. Noss, *“Man’s Religions”*, f. 88.
11. Josh McDowell dhe Don Stewart, *“Concise Guide to Today’s Religions”*, Scriptures Press, f. 375.
12. 1 Pjetrit 1:23.
13. Hebrenjve 11:3.
14. Psalmi 90:2.

15. Shiko p.sh. Mateu 28:19.
16. Shiko Psalmi 18: 30.
17. Shiko Malakia 3:6.
18. Psalmi 103:8.
19. Psalmi 103:19.
20. Efesianëve 1:11.
21. Veprat 17:31.
22. Shiko Romakëve 1:1-4.
23. 1 Gjonit 5:20.
24. Shiko Gjoni 5:24.
25. Bertrand Russell, "*Why I am not a Christian*", Watts & Co., f. 9.
26. "*Daily Telegraph*", 28 maj 1996.
27. Stephen Gaukroger, "*It Makes Sense*", Scripture Union, f. 33.
29. 2 Timoteut 3:16.

Kapitulli 2 — Shkencizmi: perëndia i paperëndishëm

1. Houghton, "*The Search for God*", f. 13-14 (Unë kam ndryshuar rendin në të cilin Houghton i radhit këto katër qëndrime).
2. "*Independent*", 15 mars 2002.
3. Cituar nga John Currid, "*Building a Christian Worldview*", botuar nga W. Andrew Hoffercker, Presbyterian & Reformed Publishing Company, vëllimi 1, f. 151.
4. Donald M. MacKay, The "*Clockwork Image: A Christian Perspective on Science*", Inter-Varsity Fellowship, f. 15-16.
5. Carl Sagan, "The Shores of the Cosmic Ocean", "*Cosmos*", Ballantine Books, f. 4.
6. Phillip Johnson, "*Reason in the Balance*", InterVarsity Press, f. 7-8.
7. Kirsten Birkett, "*Unnatural Enemies*", St Matthias Press, f. 38.
8. David Tyler, "*Evangelical Times*", shkurt 2001.
9. Johnson, "*Reason in the Balance*", f. 8.
10. Shiko Stephen M. Barr, "Retelling the Story of Science", në "*First Things*" 131 (mars 2003), f. 16-25.
11. "*Times Higher Educational Supplement*", 18 tetor 2001 (theksimi i shtuar nga autori).
12. "*Independent*", 1 korrik 1989.
13. "*Omni*", 12 (4), janar 1990, f. 60-61.
14. Cituar në "*Daily Telegraph*", 20 mars 2003.

15. "Heart of the Matter", BBC 1, 29 shtator 1996.
16. Cituar në "Daily Telegraph", 20 mars 2003.
17. "Daily Telegraph", 20 mars 2003.
18. Shiko Barr, "First Things", f. 16-25.
19. Richard Lewontin "Billions and billions of demons" në "The New York Review", 9 janar 1997, f. 31 (theksimi i shtuar nga autori).
20. Richard Dawkins, "A Devil's Chaplain: Reflections on Hope, Lies, Science and Love", Houghton Mifflin Company, f. 37.
21. Birkett, "Unnatural Enemies", f. 40.
22. Shiko Barr, "First Things", f. 1-25 (theksimi i shtuar nga autori).
23. Kjo pjesë është marrë nga John Blanchard "Does God Believe in Atheists?" Evangelical Press, f. 149-51.
24. David Cook, "Blind Alley Beliefs", Pickering & Inglis f. 35.
25. "Daily Telegraph", 13 prill 1996.
26. Peter Medawar "Advice to a Young Scientist" Harper and Row f. 31.
27. Donald MacKay "Where Science and Faith Meet", Inter-Varsity Fellowship f. 15-16.
28. Peter Atkins "The Creation", W. H. Freeman & Co., f. 36-7.
29. "Daily Telegraph", 31 gusht 1992.
30. "Sunday Telegraph", 1 korrik 1997.
31. Rodney D. Holder "Nothing but Atoms and Molecules?", Monarch Publications, f. 21.
32. Cituar nga Holder, "Nothing but Atoms and Molecules?", f. 133-4.
33. Shiko Karl Popper, "Objective Knowledge: An Evolutionary Approach", Oxford University Press, f. 223-4.
34. Peter Atkins "Creation Revisited", Penguin, f. 23.
35. Martin Robinson, "The Faith of the Unbeliever", Monarch Books, f. 78.
36. Moreland, "Scaling the Secular City", f. 197.
37. Bryan Appleyard, "Understanding the Present", Picador, f. 2.
38. Gjoni 18:37.

Kapitulli 3 — Kontroll realiteti: shkenca dhe caqet e saj

1. Cituar nga Robert G. Clouse "Francis Bacon", në "New International Dictionary of the Christian Church", botuar nga J. D. Douglas, Paternoster Press, f. 95.
2. Appleyard, "Understanding the Present", f. 3-4.
3. Julian Huxley, "Uniqueness of Man", f. 280.

4. "Ibid.", f. 282.
5. Malcolm A. Jeeves and R. J. Berry, "Science, Life and Christian Belief", Baker Books, f. 49.
6. Edmund Leach, "The Listener", 16 nëntor 1967.
7. Përshtatur nga Gaukroger, "It Makes Sense", f. 67.
8. "Daily Telegraph", 12 tetor 1993.
9. "Sunday Times", 10 shkurt 2002.
10. Carl Sagan "Velikovsky's Challenge to Science", kasetë magnetofoni 186-74, prodhuar nga Shoqata Amerikane për Përparimin e Shkencës.
11. "Daily Telegraph", 13 shtator 1995.
12. Karl Popper, "The Logic of Scientific Discovery", Unwin Hyman Ltd., f. 278 (theksimi i shtuar nga autori).
13. Cituar nga Werner Gitt, "Did God Use Evolution?", Christliche, f. 10 (theksimi i shtuar nga autori).
14. Del Ratzsch, "Science and its Limits", InterVarsity Press, f. 59.
15. "Sunday Telegraph", 28 shkurt 1999.
16. Cituar nga Michael Poole, "A Guide to Science and Belief", Lion Publishing, f. 32.
17. "Soul of Britain", BBC2, 11 qershor 1999.
18. "Daily Telegraph Science Extra", 11 shtator 1999.
19. "Daily Telegraph", 13 shtator 1995.
20. "Ibid."
21. Edward Tryon, cituar në "Science Digest", qershor 1984, f. 101.
22. Andrews, "God, Science and Evolution", f. 35 (theksimi i shtuar nga autori).
23. Atkins, "Creation Revisited", f. 143.
24. David Darling, "New Scientist" (2047) F. 49.
25. Poole, "A Guide to Science and Belief", f. 72.
26. Stephen Hawking, "Black Holes and Baby Universes", Bantam Books, f. 90.
27. Keith Ward, "God, Chance and Necessity", Oneworld Publications, f. 108-109.
28. Andrews, "God, Science and Evolution", f. 36.
29. Cituar nga Ward, "God, Chance and Necessity", f. 34.
30. J. L. Mackie, "The Miracle of Theism", Clarendon Press, f. 141.
31. Shiko George Smoot dhe Keay Davidson, "Wrinkles in Time", Avon Books, f. 110-12, 293.

32. "Ibid.", f. 110.
33. Stephen Hawking, "A Brief History of Time", Bantam Books, f. 134 (theksimi i shtuar nga autori).
34. Cituar nga Hohn Polkinghorne, "One World", SPCK, f. 58.
35. John Blanchard, "Does God Believe in Atheists?", Evangelical Press, f. 241-81.
36. John Gribbin dhe Martin Rees, "Cosmic Coincidences", Bantam Books, f. 247.
37. Cituar nga David Wilkinson, "God, the Big Bang and Stephen Hawking", Monarch Publications, f. 108.
38. Hawking, "A Brief History of Time", f. 140 (theksimi i shtuar nga autori).
39. "Sunday Telegraph", 18 shkurt 2001.
40. "Ibid." (theksimi i shtuar nga autori).
41. Cituar nga Russell Stennard, "Doing Away with God", Marshall Pickering, f. 80.
42. Richard Dawkins, "The Selfish Gene", Oxford University Press, f. xi.
43. Fred Hoyle, "The Nature of the Universe", Penguin Books, f. 120-21.
44. Letër drejtuar Senatit kanadez, botuar në *New York Review of Books*, 10 qershor 1999.
45. Michael Ruse, "Darwinism Defended", Addison Wesley, f. 108.
46. Francis Schaeffer, "The God Who is There", Hodder & Stoughton, f. 88.
47. Atkins, "The Creation", f. 36-7.
48. E. Squires, "Conscious Mind in the Physical World", Adam Hilger, f. 24.
49. Shiko Barr, "First Things", f. 16-25.
50. J. B. S. Haldane, "Possible World", Chatto de windus, f. 209.
51. "Sunday Times Magazine", 11 shkurt 1996.
52. "Sunday Telegraph", 17 prill 1996 (theksimi i shtuar nga autori).
53. Shiko Barr, "First Things", f. 16-25 (theksimi i shtuar nga autori).
54. Houghton, "The Search for God", f. 213-14 (theksimi i shtuar nga autori).
